AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në**

**"Infermieri e Përgjithshme"**

**ofruar nga**

**Universiteti "Fan S . Noli" Korçë**


**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Dr. Blerina Duka**

**Dr. Evis Allushi**


**Korrik /2025**

**TABELA PËRMBLEDHËSE E TË DHËNAVE TË PROGRAMIT TË STUDIMIT**

**Bachelor në "Infermieri e Përgjithshme"**

| | | |
|---|---|---|
| 1 | IAL aplikues: | Universiteti "Fan S . Noli" Korçë |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane, Departamenti i Infermierisë. |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Bachelor në "Infermieri e Përgjithshme" |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | VKM Nr. 369, datë 10.07.1995 |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | - |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | Urdhër Nr. 39, datë 15.03.2022 |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | - |
| 8 | Cikli i studimit: | Cikli i parë |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 3 vite akademike |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 180 ECTS |
| 11 | Forma e studimit: | Me kohë të plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | Shqip |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | - |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | Niveli 6 |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | 16 PAE/ 25 PAK v.a. 2022-2023<br>18 PAE/ 24 PAK v.a. 2023-2024<br>18 PAE/ 28 PAK v.a. 2024-2025 |
| 18 | Numri i studentëve: | 77 Studentë v.a 2022-2023<br>76 Studentë v.a 2023-2024<br>75 Studentë v.a 2024-2025 |
| 19 | Komente / të tjera: | - |

**PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Programi i studimit Bachelor në "Infermieri" i ofruar nga Universiteti "Fan S. Noli" i Korçës është program i degës "Infermieri", i cili ka filluar të ofrohet në institucionet publike dhe jopublike të arsimit të lartë në Shqipëri.
Ky program studimi është hartuar si një program i ciklit të parë (Bachelor) dhe është në përputhje me sistemin europian të transferimit të krediteve, si dhe me Ligjin për Arsimin e Lartë. Bazuar në Ligjin Nr. 8461, datë 25.09.1999, "Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë" (i ndryshuar), dhe me vendim të Senatit të Universitetit "Fan S. Noli" të Korçës, ky program është miratuar edhe nga Drejtoria e Arsimit të Lartë dhe të Njohjes së Diplomave. Ky program është krijuar pas miratimit të vendimit të Këshillit të Ministrave numër 369, datë 10.07.1995, i cili ka aprovuar hapjen e Kursit të Lartë të Infermierisë në Korçë, i cili kishte një afat studimi 3,5 vjet. Ky kurs ka kaluar nën administratën e Universitetit të Korçës dhe është përfshirë në strukturën akademike të tij, me të njëjtin afat studimi.
Programi ka pësuar ndryshime të vazhdueshme, për t'u përputhur me aktet ligjore dhe nënligjore të ndryshme gjatë viteve. Aktualisht, programi i studimit Bachelor në Infermieri zhvillohet me një kohëzgjatje prej 3 vitesh (6 semestra) dhe përmban 180 kredite (ECTS), të ndara në 60 kredite për çdo vit akademik.
Programi i studimit "Infermieri" në Universitetin "Fan S. Noli" ka një strukturë të mirëpërcaktuar akademike, e cila përmban 180 kredite ECTS të shpërndara në tre vite studimi. Ai është ndërtuar mbi një bazë të fortë shkencore dhe didaktike, duke synuar zhvillimin e kompetencave profesionale në fushën e Infermierisë dhe kujdesit shëndetësor. Duke u bazuar në vlerësimin e brendshëm, programi duket se ndjek një qasje të qartë drejt formimit të studentëve në përputhje me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare, përfshirë Deklaratën e Bolonjës. Megjithatë, një vlerësim i jashtëm thekson nevojën për një analizë më të thelluar të ndikimit të programit në punësimin e të diplomuarve dhe përshtatshmërinë e tij me kërkesat në rritje të tregut të punës. *(Shtojca 2.5.3 RREGULLORE E PROGRAMIT TË STUDIMIT INFERMIERI 2024-2025.pdf)*

Metodat e mësimdhënies dhe të të nxënit, sipas vlerësimit të brendshëm, janë ndërtuar mbi parime moderne dhe nxisin eksplorimin e dijes dhe aplikimin praktik të njohurive. Aktivizimi i studentëve përmes diskutimeve dhe praktikave është një aspekt pozitiv, por një vlerësim i jashtëm do të sugjeronte një thellim më të madh të metodave interaktive dhe simulimeve klinike. Përdorimi më i gjerë i teknologjisë në mësimdhënie, si dhe integrimi i platformave digjitale për zhvillimin e aftësive praktike, do të ndihmonin në përgatitjen më të mirë të studentëve për sfidat e fushës shëndetësore.
Sa i përket infrastrukturës didaktike, programi siguron një mjedis të përshtatshëm për zhvillimin e procesit mësimor, duke përfshirë laboratorë dhe ambiente të përshtatshme për studime dhe kërkime shkencore. Vlerësimi i brendshëm e nënvizon këtë aspekt si një pikë të fortë, por një analizë e jashtme sugjeron që një vlerësim më i detajuar mbi kapacitetet laboratorike dhe

pajisjet mësimore do të ishte i nevojshëm për të identifikuar mundësitë për përmirësime të mëtejshme. *(Shtojca 4.6 Tabelë përmbledhëse e kapaciteteve infrastrukturore dhe laboratorike .pdf,dhe shtojca 2.5.1 Rregullore e programit të studimit Infermieri 2024-2025.pdf)*
Një aspekt tjetër që vlerësohet pozitivisht është përfshirja aktive e studentëve në procesin akademik dhe jashtëkurrikular. Ky angazhim ndihmon në zhvillimin e aftësive profesionale dhe ndërgjegjësimin mbi rëndësinë e cilësisë në shërbimet shëndetësore. Megjithatë, një vlerësim i jashtëm do të rekomandonte fuqizimin e bashkëpunimeve me institucionet shëndetësore, duke mundësuar më shumë mundësi për praktika profesionale dhe integrimin e studentëve në situata reale klinike. Një analizë më e hollësishme mbi ndikimin e programit në zhvillimin profesional të të diplomuarve dhe suksesin e tyre në tregun e punës do të ishte e dobishme për të përmirësuar më tej cilësinë dhe efektivitetin e tij. *(Shtojca 2.10 dhe Marrëveshjet e bashkepunimit në mbështetje të praktikave klinike dhe profesionale.pdf dhe 2.10.1 Marrëveshjet e bashkepunimit në mbështetje të praktikave klinike dhe profesionale. pdf)*

Programi i studimit "Infermieri" në Universitetin "Fan S. Noli" përmban elementë të rëndësishëm të cilësisë akademike dhe formimit profesional, duke iu përgjigjur standardeve të vendosura në arsimin e lartë. Vlerësimi i brendshëm konfirmon përkushtimin për përmirësimin e vazhdueshëm, por një vlerësim i jashtëm sugjeron që për të siguruar një zhvillim edhe më të qëndrueshëm, duhet të forcohet komponenti praktik, të përmirësohet infrastruktura dhe të rritet bashkëpunimi me sektorin shëndetësor për të garantuar një përgatitje sa më të plotë të studentëve për tregun e punës.
Programi bachelor Infermieri, ofrohet në nivel njësie kryesore dhe përgjegjës për mbarëvajtjen, organizimin dhe cilësinë e tij është vetë fakulteti ndërsa njësitë bazë dhe strukturat e tjera japin kontributin respektiv në realizimin e procesit akademik, shkencor dhe administrativ në funksion të programit të studimit. *(Shtojca 2.5.1,2.5.2, 2.5.3 Rregullore e programit të studimit Infermieri 2022-2023, 2023-2024, 2024-2025 pdf).*
Universiteti "Fan S. Noli", Korçë përbëhet nga 4 fakultete:

1- Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë
- Departamenti i Edukimit
- Departamenti i Gjuhës dhe Letërsisë
- Departamenti i Gjuhëve të Huaja
- Departamenti i Histori dhe Gjeografisë

*2- Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane*
- Departamenti Biologji-Kimisë
- *Departamenti i Infermierisë*
- Departamenti i Informatikës
- Departamenti i Matematikës dhe Fizikës
- Departamenti i Shkencave Sociale

3- Fakulteti i Ekonomisë
- Departamenti i Financë-Kontabilitetit
- Departamenti i Marketing-Turizmit

- Departamenti i Menaxhimit
4- Fakulteti i Bujqësisë
- Departamenti i Agrobiznesit
- Departamenti i Agronomisë
- Departamenti i Agroushqimit

*(Shtojca 1.2 Rregullorja e UNIKO, kreu 2, neni 5).*

## PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Raporti i vlerësimit të jashtëm, është dokument i hartuar në kuadër të akreditimit të programit të studimit Bachelor "Infermieri", i ofruar nga Universiteti "Fan S . Noli" Korçë. Ky raport përmbledh procedurën e realizimit të këtij procesi, vlerësimin përkundrejt standardeve dhe kritereve për programin e studimit, pjesë e Kodit të Cilësisë, gjetjet konstatimet dhe vlerësimin për çdo fushë, vlerësimin e përgjithshëm për përmbushjen e standardeve dhe kritereve respektive.

Vlerësimi i jashtëm është fokusuar në 6 fusha vlerësimi:

- **I.** Ofrimi i programit të studimit;
- **II.** Organizimi, drejtimi dhe administrimi i programit të studimit;
- **III.** Mësimdhënia, Mësimnxënia, Vlerësimi dhe Kompetencat;
- **IV.** Burimet njerëzore financiare infrastruktura logjistika për realizimin e programit të studimit;
- **V.** Studentët dhe mbështetja e tyre;
- **VI.** Sigurimi i cilësisë në programin e studimit.

Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar në 4 nivele:

- Standardet nuk përmbushen;
- Standardet përmbushen pjesërisht;
- Standardet përmbushen kryesisht;
- Standardet përmbushen plotësisht.

Në mbështetje të hartimit të raportit dhe gjykimeve të arritura janë shqyrtuar një sërë dokumentash dhe informacionesh të vëna në dispozicion nga Institucioni në faza të ndryshme të vlerësimit, nga ASCAL si dhe informacione të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. Procesi i vlerësimit është koordinuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit AMS. Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është i përbërë nga Dr. Blerina Duka dhe Dr. Evis Allushi.

Koordinator Teknik i ASCAL për këtë proces vlerësimi është Msc. Rajna Lila. Bazuar në afatet e përcaktuara dhe në procedurën e vlerësimit, procesi u realizua në disa faza:

- Vlerësimi i brendshëm ku Institucioni ka dorëzuar Dosjen e Vetëvlerësimit, ku përfshihet Raporti i Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacioni mbështetës (DVV). Gjatë kësaj fazë janë kërkuar nga ASCAL saktësime dhe plotësime në dokumentacionin e dërguar.
- Shqyrtimi i raportit dhe dokumentacionit, përgatitja e materialeve për vizitën në institucion. Gjatë kësaj faze janë kryer takime dhe diskutime nga ana e GVJ, janë hartuar draftet paraprake, është propozuar agjenda e vlerësimeve dhe lista e pyetjeve të mundshme sipas takimeve respektive.
- Vizita në Universitetin "Fan S . Noli" Korçë është zhvilluar në datat 17.03.2025-18.03.2025. Në institucion janë kryer disa takime të rëndësishme me aktorë dhe faktorë të institucionit në funksion të programit të studimit.
- Hartimi i raportit paraprak dhe finalizimi i tij.

Grupi i vlerësimit të jashtëm, në këtë raport është përpjekur të pasqyrojë me korrektësi e profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet programi i studimit. GVJ jep vlerësim pozitiv të arritjeve të bëra nga Universiteti "Fan S . Noli" Korçë në ofrimin e një programi të mire të Bachelor në "Infermieri". Gjithashtu, jep disa sugjerime/rekomandime, të cilat vlerësohet se do të ndihmojnë stafin akademik dhe administrativ për të arritur objektivat e tyre, të krahasueshëm me nivelet ndërkombëtare per gjeneratat e ardhshme të Infermierive.

GVJ vlerëson maksimalisht angazhimin e institucionit, Grupit të Vlerësimit të Brendshëm dhe personelin akademik për gadishmërinë e treguar në dhënien e informacioneve të kërkuara në funksion të procesit gjatë vizititës në institucion.

**Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Infermieri e Përgjithshme"**

## I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

| **Standardi I.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Programet e studimit që ofrohen nga Universiteti "F. S . Noli" Korçë nuk bien ndesh me interesat kombëtare. Universitetin "Fan S . Noli" Korçë vepron në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015 si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore. Misioni i tij (Statuti i "*Fan S. Noli"*, neni 3) synon arsimimin e lartë gjithëpërfshirës të studentëve vendas e të huaj, studimet dhe kualifikimet e mëtejshme në fushën e mjekësisë dhe ka për qëllim zhvillimin e arsimit, edukimit dhe kërkimit shkencor në fushën e mjekësisë. Ky mision orientohet drejt krijimit, zhvillimit dhe transmetimit të dijeve në aftësi dhe kompetencca të studentëve, të nevojshëm këto për tu bërë ekspert të denjë të fushës së mjekësisë.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 1.1 Statuti i universitetit 'Fan S. Noli".pdf*<br>*Shtojca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë*<br>*Shtojca 2.5.1 Rregullore e programit të studimit Infermieri 2022-2023.pdf.*<br>*Shtojca 2.5.2 Rregullore e programit të studimit Infermieri 2023-2024.pdf.*<br>*Shtojca 2.5.3 Rregullore e programit të studimit Infermieri 2024-2025.pdf.*<br>*Shtojca 1.3; Plani Strategjik i zhvillimit të Universitetit F. S. Noli 2022-2027*<br>*Shtojca 4.14; Ligji i Arsimit të Lartë 80/2015* |
| **Kriteri 2**. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | Programi i studimit Bachelor në "Infermieri e Përgjithshme" ofrohet nga FSHNH.<br>Universiteti "Fan S. Noli" ka si mision të ofrojë shërbime në përputhje me objektivat misionin e vet .<br>Një nga objektivat kryesor të "Fan S. Noli" është mësimdhënia, |

| | |
|---|---|
| | kurrikulat dhe mësimnxënia me në qendër formimin e studentëve (profesionistëve të ardhshëm në Infermieri). Kjo arrihet përmes formimit të specialistëve në fushën e shëndetësisë. Ky program formon profesionistë Infermieri me formim të përgjithshëm, në përputhje me misionin madhor të Universitetit "Fan S . Noli", që është të rrisë standartet e shëndetit komunitar nëpërmjet mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe komunikimit. Universiteti "F. S. Noli" në përmbushje të misionit dhe vizionit të tij (neni 2 dhe 3) dhe njëkohësisht aktivitetit të gjithanshëm në fushën e shkencave mjekësore teknike ka organizuar një program studimi i cili plotëson të gjithë spektrin e nevojave që kanë qendrat spitalore, qendrat shëndetësore publike e private në vend duke përfshirë në to personel të specializuar në fushën e Infermierisë. Në përfundim të studimeve Bachelor në "Infermier i Përgjithshëm", studentëve u jepet mundësia për:<br>- Vijimin e studimeve në nivel Master Profesional ose Master Shkencor në fushën e infermierisë, brenda ose jashtë vendit;<br>- Punësim si infermierë të përgjithshëm në institucione shëndetësore, në Shqipëri apo jashtë saj.<br>Ky program është ndërtuar mbi tre shtylla kryesore:<br>- Njohuritë bazë teorike në fushën mjekësore dhe shkencore, të fokusuara në profesionin e Infermierisë.<br>- Njohuritë bazë praktike të profesionit të Infermierisë.<br>- Njohuritë bazë procedurale të profesionit të Infermierisë.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 1.1 Statuti i universitetit 'Fan S. Noli".pdf*<br>*Shtojca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë*<br>*Shtojca 2.5.1 Rregullore e programit të studimit Infermieri 2022-2023.pdf.*<br>*Shtojca 2.5.2 Rregullore e programit të studimit Infermieri 2023-2024.pdf.*<br>*Shtojca 2.5.3 Rregullore e programit të studimit Infermieri 2024-2025.pdf.*<br>*Shtojca 1.3; Plani Strategjik i zhvillimit të Universitetit F. S. Noli 2022-2027*<br>*Shtojca 4.14; Ligji i Arsimit të Lartë 80/2015* |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të | Programi i studimit Bachelor në "Infermieri e Përgjithshme" në Universitetin "F. S. Noli" Korçë është hartuar në përputhje me Planin Strategjik 2022-2027, Statutin dhe Rregulloren e institucionit. Ai synon të përgatisë specialistë të aftë për t'iu |

| | |
|---|---|
| Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij. | përgjigjur nevojave të sistemit shëndetësor, duke reflektuar zhvillimet më të fundit në fushën e infermierisë.<br>Ky program është në linjë me objektivat e universitetit, duke përfshirë sigurimin e cilësisë, zhvillimin e kërkimit shkencor dhe ndërkombëtarizimin. Ai është përditësuar sipas kërkesave të tregut dhe standardeve bashkëkohore, duke u fokusuar në edukimin dhe aftësimin e vazhdueshëm të infermierëve për një shërbim shëndetësor cilësor brenda dhe jashtë vendit.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 1.1 Statuti i universitetit 'Fan S. Noli".pdf*<br>*Shtojca 2.5.1 Rregullore e programit të studimit Infermieri 2022-2023.pdf.*<br>*Shtojca 2.5.2 Rregullore e programit të studimit Infermieri 2023-2024.pdf.*<br>*Shtojca 2.5.3 Rregullore e programit të studimit Infermieri 2024-2025.pdf.*<br>*Shtojca 1.3 Plani strategjik i zhvillimit të uniko.pdf.*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e organlzimit & veprimtarisë mësimore kërkimore.pdf.*<br>*Shtojca 2.3 Rregullore e njësise bazë departamenti i infermierisë;.pdf.* |
| **Kriteri 4.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | **Universiteti "Fan S. Noli" Korçë** është një institucion i arsimit të lartë publik, i krijuar me Vendim nr. 5, datë 07.01.1992 të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, mbi bazën e Institutit të Lartë Bujqësor (ILB), i themeluar në vitin 1971. Emri "Fan S. Noli" iu dha me vendim të Këshillit të Ministrave në vitin 1994. Ky institucion është i akredituar me Vendim Nr. 02, datë 27.01.2023.<br>Veprimtaria e universitetit mbështetet në nenin 57, pika 7 dhe nenin 58 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Ligjin Nr. 80/2015, datë 22.07.2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe në parimet dhe standardet e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë (HEAL). Gjithashtu, veprimtaria e tij rregullohet nga Statuti i Universitetit dhe aktet ligjore e nënligjore të miratuara në kuadër të procesit të Bolonjës.<br>Dega e Infermierisë u krijua në tetor 1994 nën vartësinë e Ministrisë së Shëndetësisë me një numër prej 65 studentësh. Në vitin 1995, me Vendimin e Ministrisë së Arsimit Nr. 369, datë 10.07.1995, kaloi nën varësinë e Universitetit "Fan S. Noli" dhe u |

| | |
|---|---|
| | organizua me një kohëzgjatje prej 3.5 vitesh. Në vitin akademik 2004-2005, programi u përshtat me Procesin e Bolonjës duke kaluar në një strukturë prej 3 vitesh akademike me 180 kredite ECTS. Në të njëjtën kohë, Dega e Infermierisë u riformua si Departamenti i Infermierisë, pjesë e Fakultetit të Shkencave Natyrore dhe Humane (FSHNH).<br>Organet përgjegjëse për hapjen dhe zhvillimin e Programit të Studimit Bachelor në Infermieri janë Departamenti i Infermierisë, Rektorati i Universitetit "Fan S. Noli", Senati Akademik i Universitetit dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit. Programi është i strukturuar sipas standardeve akademike dhe synon përgatitjen e specialistëve të fushës për të ofruar shërbime cilësore në sistemin shëndetësor vendas dhe ndërkombëtar.<br>Departamenti i Infermierisë ndodhet në godinën B të FSHNH dhe ofron mjedise të përshtatshme për zhvillimin e mësimdhënies dhe praktikave profesionale. Studentët e programit kanë në dispozicion sallat e leksioneve dhe laboratorët e Departamentit, të pajisur me infrastrukturën e nevojshme për realizimin e praktikave. Universiteti "Fan S. Noli" garanton cilësinë e programit në përputhje me Kodin dhe standardet e cilësisë.<br><br>Raporti i stafit akademik në FSHNH për vitin akademik:<br>- 2022-2023 është 48 PAE, 66 PAK , 3 personel ndihmës, **gjithsej 117**<br>- 2023-2024 është 49 PAE, 62 PAK , 3 personel ndihmës, **gjithsej 114**<br>- 2024-2025 është 51 PAE, 66 PAK , 3 personel ndihmës, **gjithsej 120**.<br>Raporti i stafit akademik në FSHNH për vitin akademik 2024-2025 është 51 PAE, 66 PAK, 3 personel ndihmës, gjithsej 120.<br>*Totali i stafit akademik:*<br>Nga viti 2022-2023 në 2023-2024: Numri total i PAE u rrit me 2, ndërsa PAK u ul me 1.<br>Nga viti 2023-2024 në 2024-2025: Numri total i PAE u rrit me 1, ndërsa PAK u rrit me 4.<br>Në përgjithësi, struktura e stafit mbetet relativisht e qëndrueshme, me disa luhatje të vogla në numrin e PAE dhe PAK.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 1.1 Statuti i universitetit 'Fan S. Noli" Neni 3 dhe 5 .pdf*<br>*Shtojca 2.5.1 Rregullore e programit të studimit Infermieri 2022-* |

| | |
|---|---|
| | *2023 pika 6 pdf.*<br>*Shtojca 2.5.2 Rregullore e programit të studimit Infermieri 2023-2024 pika 6 pdf.*<br>*Shtojca 2.5.3 Rregullo0re e programit të studimit Infermieri 2024-2025 pika 6 pdf.*<br>*Shtojca 1.3 Plani strategjik i zhvillimit të uniko.pdf.*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e organlzimit & veprimtarisë mësimore kërkimore.pdf.*<br>*Vizita në ambientet e Universitetit "Fan S. Noli" në Korçë.*<br>*Shtojca 2.15; Shkresa për hapjen e FSHNH*<br>*Shtojca 2.1.1; Çertifikatë dhe vendim akreditimi institucional i UK*<br>*Shtojca 2.1; Dokumentacioni i licençimit të programit të studimit*<br>*Shtojca 4.6; Tabelë përmbledhëse e kapaciteteve infrastrukturore dhe laboratorike*<br>*Shtojca 5; Tabela Përmbledhëse për aneks RVB* |
| **Kriteri 5.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | Programi i studimit Bachelor në "Infermieri e Përgjithshme" ofrohet nga Departamenti i Infermierisë në Fakultetin e Shkencave Natyrore dhe Humane (FSHNH) të Universitetit "Fan S. Noli" (UK). Ky program është në përputhje me fushën akademike dhe kërkimore të njësisë bazë, duke siguruar formimin e duhur profesional dhe shkencor në fushën e Infermierisë.<br>Programi synon të pajisë studentët me njohuri të thelluara teorike dhe praktike, si dhe t'i përgatisë ata për kërkim shkencor dhe vijimin e mëtejshëm të kualifikimeve në kujdesin shëndetësor. Ai është i kodifikuar sipas udhëzimeve kombëtare dhe ndërkombëtare, duke mbajtur kodin **63BA0913S.**<br>Departamenti i Infermierisë, përveç programit Bachelor në "Infermieri e Përgjithshme", ofron edhe programet e studimit Bachelor në "Mami" dhe Master Profesional në "Infermieristikë", duke mbuluar një gamë të gjerë formimi profesional në fushën e kujdesit shëndetësor.<br>Institucioni zbaton me përpikmëri çdo udhëzim dhe akt nënligjor të publikuar, duke siguruar përputhshmërinë e programit me standardet akademike dhe kërkimore të FSHNH.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë*<br>*Shtojca 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH*<br>*Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri"* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *2022-2023*<br>*Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2023-2024*<br>*Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2024-2025*<br>*Shtojca 3.7; Raporti Vjetor i NJSBC FSHNH*<br>*Shtojca 2.5.5 Kodi i programit Infermieri.pdf.*<br>*Shtojca 3.7; Raporti Vjetor i NJSBC FSHNH* | | | |
| **Konkluzione** | *Programet e studimit që ofrohen nga Universiteti F. S. Noli nuk bien ndesh me interestat kombëtare. Programi i studimit Bachelor në "Infermieri e Përgjithshme" është hartuar dhe ofrohet nga Universiteti F. S. Noli, ku ka si mision të ofrojë shërbime në përputhje me misionin e vet si dhe të ofroj programe studimi në të tre ciklet e studimit. Bachelor në "Infermieri e Përgjithshme" ofrohet në përputhje me strategjinë e FSHNH..*<br>*Universiteti i Korçës është krijuar me vendim **nr. 5, datë 07.01.1992** të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, dhe* i akredituar me **Vendim Nr. 02, datë 27. 01. 2023.** *Pjesa më e madhe e personelit janë me tituj dhe grada dhe kjo është një pikë e fortë e këtij universiteti. Programi i studimit është në përputhje më fushën akademike dhe kërkimore të Njësisë Bazë.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi I.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të | Universiteti "Fan S. Noli" ka një strukturë të qartë akademike dhe administrative, e cila siguron funksionimin e duhur të programeve të studimit, përfshirë atë të Bachelor në "Infermieri e Përgjithshme". Në Statutin dhe Rregulloren e institucionit përcaktohen qartë njësitë akademike dhe administrative, të cilat bashkëpunojnë për mbarëvajtjen e programit të studimit. Secila njësi ka rolin dhe përgjegjësitë e saj të përcaktuara, duke mundësuar një organizim efikas dhe të strukturuar.<br>Në funksion të ofrimit të këtij programi, njësitë e universitetit bashkëpunojnë ngushtë mes tyre, duke ndarë detyrat dhe duke |

| | |
|---|---|
| punës së tyre. | marrë përgjegjësitë përkatëse. Kjo siguron një proces akademik dhe administrativ të qëndrueshëm, ku institucionit i jepet mundësia të realizojë analiza të vazhdueshme mbi performancën e tij. Kontrolli i rregullt institucional, organizimi i takimeve dhe diskutimeve, si dhe kryerja e analizave periodike ndihmojnë në vlerësimin e vazhdueshëm të punës dhe në përmirësimin e cilësisë së ofrimit të programit.<br>Gjithashtu, Rregullorja e FSHNH, si dhe rregulloret e njësive specifike, përcaktojnë qartë marrëdhëniet dhe detyrat ndërmjet njësive për të garantuar një bashkëpunim të frytshëm dhe një menaxhim efikas të programit të studimit. Institucioni i kushton rëndësi të veçantë monitorimit dhe vlerësimit të brendshëm, duke analizuar dhe përmirësuar vazhdimisht proceset akademike dhe administrative. Në këtë mënyrë, universiteti siguron përmbushjen e standardeve akademike dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së arsimit në programin Bachelor në "Infermieri e Përgjithshme".<br><br>**Evidencat:**<br>*Shtojca 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë*<br>*Shtojca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë*<br>*Shtojca 2.3; Rregullore e njësisë bazë "Departamenti i Infermierisë";*<br>*Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2022-2023*<br>*Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2023-2024*<br>*Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2024-2025*<br>*Shtojca 1.19; Rregullore e Këshillit të Etikës UK*<br>*Shtojca 1.5; Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional*<br>*Shtojca 2.10 Marrëveshjet e bashkepunimit në mbështetje të praktikave klinike dhe profesionale.pdf.*<br>*Shtojca 2.10.1 Marrëveshjet e bashkepunimit në mbështetje të praktikave klinike dhe profesionale.pdf.*<br>*Shtojca 1.19; Rregullore e Këshillit të Etikës UK*<br>*Shtojca 1.5; Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional* |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit | Universiteti "Fan S. Noli" ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucione homologe brenda dhe jashtë vendit, si dhe me |

| | |
|---|---|
| mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | institucione spitalore dhe të kujdesit shëndetësor parësor, me qëllim realizimin e objektivave të procesit mësimor dhe formues të programit të studimit. Përmes këtyre marrëveshjeve, institucioni siguron praktikën klinike dhe profesionale të studentëve, realizimin e temave të diplomave, mobilitetin e stafit akademik dhe studentëve, trajnime profesionale, pjesëmarrje në projekte dhe organizimin e konferencave të përbashkëta.<br>Në kuadër të këtij bashkëpunimi, UK ka lidhur marrëveshje me institucione si Qendra e Kujdesit Paliativ Mary Potter, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor Korçë, Spitali Rajonal Korçë dhe Kryqi i Kuq Shqiptar, Dega Korçë. Këto partneritete mundësojnë integrimin praktik të studentëve dhe zhvillimin e tyre profesional, duke ndihmuar në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor. Aktivitetet dhe rezultatet e këtyre bashkëpunimeve pasqyrohen në analizën vjetore institucionale, duke vlerësuar ndikimin dhe efektivitetin e tyre në formimin e studentëve dhe në zhvillimin e programit të studimit.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 5; Tabela Përmbledhëse për aneks RVB*<br>*Shtojca 2.4.1; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2021-2022.*<br>*Shtojca 2.4.2; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2022-2023.*<br>*Shtojca 2.4.3 Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2023-2024.*<br>*Shtojca 2.13.1; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2021-2022*<br>*Shtojca 2.13.2; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2022-2023*<br>*Shtojca 2.13.3; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2023-2024*<br>*Shtojca 2.10; Marrëveshjet e bashkëpunimit në mbështetje të praktikave klinike dhe profesionale.*<br>*Shtojca 3.5 Mobilitete kombetare & nderkombetare te stafit akademik (erasmus+).pdf.*<br>*Shtojca 2.10.2 Listë përmbledhese e marrëveshjeve institucionale.pdf.*<br>*Shtojca 2.10.1 Marrëveshjet e bashkepunimit në mbështetje të praktikave klinike dhe profesionale.pdf.*<br>*Shtojca 2.10 Marrëveshjet e bashkepunimit në mbështetje të* |

| | |
|---|---|
| | *praktikave klinike dhe profesionale.pdf.* |
| **Kriteri 3.** Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj. | Programi Bachelor në "Infermieri e Përgjithshme" i Universitetit të Korçës ofron një bazë të fortë në kujdesin shëndetësor, duke përgatitur studentët për ndërhyrje terapeutike, rehabilituese dhe parandaluese. Gjithashtu, programi përfshin metodologji të kërkimit shkencor dhe menaxhim shëndetësor, duke siguruar një përgatitje të plotë për sfidat e profesionit.<br>Një komponent kyç i programit është praktika klinike, e cila realizohet nën mbikëqyrjen e profesionistëve të kualifikuar për të garantuar cilësinë dhe zhvillimin e aftësive profesionale. Institucioni ka vendosur marrëveshje bashkëpunimi me:<br>• Shërbimin Spitalor Rajonal Korçë<br>• Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Korçë (përfshirë Shërbimin Parësor dhe Qendrën e Shëndetit Mendor)<br>• Kryqin e Kuq, Dega Korçë<br>• Qendrën e Kujdesit Paliativ Korçë<br>Përfshirja e një numri të konsiderueshëm mjekësh dhe infermierësh si Personel Akademik Klinik (PAK) siguron mbikëqyrjen efektive të praktikave dhe rrit aftësimin profesional të studentëve.<br>Rregullorja e programit përcakton kushtet dhe kriteret për realizimin e praktikës klinike, ndërsa sylabuset e detajuara ofrojnë një kornizë të qartë për përmbajtjen dhe objektivat e praktikës. Këto elementë kontribuojnë në përgatitjen e plotë të studentëve për tregun e punës dhe zhvillimin e tyre profesional.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 2.10.2 Listë përmbledhese e marrëveshjeve institucionale.pdf.*<br>*Shtojca 2.10.1 Marrëveshjet e bashkepunimit në mbështetje të praktikave klinike dhe profesionale.pdf.*<br>*Shtojca 2.10 Marrëveshjet e bashkepunimit në mbështetje të praktikave klinike dhe profesionale.pdf*<br>*Shtojca 3.16.2 Udhëzues vlerësimi i praktikave mësimore, klinike-profesionale.*<br>*Shtojca 5; Tabela Përmbledhëse për aneks RVB*<br>*Shtojca 2.4.1; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2021-2022.*<br>*Shtojca 2.4.2; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2022-2023.*<br>*Shtojca 2.4.3 Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore,* |

| | |
|---|---|
| | *kërkimore dhe financiare i UK 2023-2024.*<br>*Shtojca 2.13.1; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2021-2022*<br>*Shtojca 2.13.2; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2022-2023*<br>*Shtojca 2.13.3; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2023-2024* |
| **Kriteri 4.** Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. | Departamenti i Infermierisë dhe Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Humane (FSHNH) në Universitetin e Korçës realizojnë raporte analitike periodike mbi përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione të ndryshme shëndetësore dhe akademike. Këto raporte përmbajnë informacion mbi institucionet me të cilat janë nënshkruar marrëveshjet, qëllimin dhe përfitimet e tyre, datën e nënshkrimit dhe afatin e vlefshmërisë. Përmes këtyre bashkëpunimeve, Universiteti synon të rrisë cilësinë e përgatitjes së studentëve dhe të kontribuojë në zhvillimin e kërkimit shkencor.<br>Vlerësimi i ndikimit të marrëveshjeve në mobilitetin e studentëve dhe stafit akademik, shkëmbimin e përvojave, zhvillimin e kërkimit shkencor dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies është një proces i vazhdueshëm. Të dhënat e mbledhura shërbejnë si bazë për hartimin e politikave të zhvillimit dhe strategjive për përmirësimin e cilësisë akademike dhe profesionale.<br>Zhvillimi i bashkëpunimeve të reja mbetet një nga prioritetet strategjike të institucionit, duke u fokusuar në zgjerimin e mundësive për studentët dhe stafin akademik në aspektin e praktikave profesionale, kërkimit dhe trajnimeve të specializuara. Përmes analizave të vazhdueshme dhe përmirësimit të mekanizmave të bashkëpunimit, Universiteti siguron një mjedis akademik që mbështet zhvillimin profesional dhe shkencor të studentëve dhe stafit.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 2.4.1; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2021-2022.*<br>*Shtojca 1.3 Plani strategjik i zhvillimit të uniko.pdf.*<br>*Shtojca 2.4.2; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2022-2023.*<br>*Shtojca 2.4.3 Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2023-2024.*<br>*Shtojca 2.13.1; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2021-2022* |

| | |
|---|---|
| | *Shtojca 2.13.2; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2022-2023*<br>*Shtojca 2.13.3; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2023-2024*<br>*Shtojca 2.17.1; Analiza e punës mësimore-shkencore Departamenti Infermierisë ,per vitin akademik 2021-2022.*<br>*Shtojca 2.17.2; Analiza e punës mësimore-shkencore Departamenti Infermierisë ,per vitin akademik 2022-2023.*<br>*Shtojca 2.17.3; Analiza e punës mësimore-shkencore Departamenti Infermierisë ,per vitin akademik 2023-2024.* |
| **Konkluzione** | *UK ka në Rregulloren dhe Statutin e vet Njësitë akademike dhe administrative specifike të cilat bashkëpunojnë me njëra tjetrën me qëllim mbarvajtjen e programit të studimit. Secila Njësi ka të përcaktuara detyrat dhe rolin e vet. Me qëllim formimin e studentëve, UK ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Institucione brenda dhe jashtë vendit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

| **Standardi II.1**<br>**Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë | Vendimi i Ministrisë së Arsimit për hapjen e Programit të Studimit të Ciklit të Parë: "Infermieri e Përgjithshme", është: *"VKM Nr. 369, datë 10. 07. 1995, për hapjen e Programit të Studimit të Ciklit të Parë: "INFERMIER I PËRGJITHSHËM" (180 ETCS)"* dhe ka një kohëzgjatje prej tre vitesh akademike. Në fund të këtij |

| | |
|---|---|
| përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | programi, studentët marrin diplomën "Bachelor" në fushën e studimit përkatës. Programi është i ndarë në module dhe është i vlerësuar sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).<br>Çdo semestër ka 15 javë mësimore, duke përfunduar me gjithsej 90 javë mësimore për të gjithë programin. Çdo semestër është i vlerësuar me 30 kredite, ndërsa çdo vit akademik ka 60 kredite, duke arritur një total prej 180 kreditesh, në përputhje me Ligjin 80/15 për "Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", Nenet 70 dhe 73.<br>Programi është i organizuar në module dhe lëndët janë të kategorizuara sipas veprimtarisë formuese, duke u ndarë në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore dhe plotësuese.<br>Shpërndarja e krediteve është si më poshtë:<br>A. **Lëndë bazë** 32 ECTS (18.8 %)<br>B. **Lëndë karakterizuese** 99 ECTS (55 %)<br>C. **Lëndë ndërdisiplinore/ integruese** 23 ECTS (12.8 %)<br>D. **Lëndë plotësuese** 19 ECTS (10.6 %)<br>E. **Detyrime përmbyllëse dhe diploma** 7 ECTS (3.9 %)<br><br>Ky plan mësimor siguron një strukturë të qartë dhe të organizuar për zhvillimin e studimeve, duke ofruar një ekuilibër të mirë mes teorisë dhe praktikës.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 5; Tabela Përmbledhëse për aneks RVB*<br>*Shtojca 2.1 Dokumentacioni i licencimit të programit te studimit M (2).pdf.*<br>*Shtojca 2.7.1; Plani mësimor i programit të studimit 2022-2023*<br>*Shtojca 2.7.2; Plani mësimor i programit të studimit 2023-2024*<br>*Shtojca 2.7.3; Plani mësimor i programit të studimit 2024-2025*<br>*Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2022-2023*<br>*Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2023-2024*<br>*Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2024-2025* |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, | Në total, programi i studimit përmban 48 lëndë duke u ndarë në lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore dhe plotësuese me 173 kredite në total dhe 7 kredite të *provimit të diplomës.*<br>Programi i studimit mbyllet me temë diplome. Programi "Bachelor |

| | |
|---|---|
| jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. | në Infermieri e Përgjithshme" në Universitetin e Korçës ka një kohëzgjatje prej 6 semestrash dhe një ngarkesë totale prej 180 kreditesh. Ky program synon të përgatisë infermierë të aftë profesionalisht, duke u fokusuar në kujdesin shëndetësor të përgjithshëm, me një vëmendje të veçantë ndaj shëndetit të nënës dhe fëmijës.<br>Programi përfshin një kombinim të balancuar mes njohurive teorike dhe praktikës klinike, e cila fillon që në vitin e parë dhe zhvillohet në mënyrë graduale gjatë gjithë ciklit të studimeve. Praktikat realizohen në institucione shëndetësore bashkëpunuese, duke u mundësuar studentëve të aplikojnë njohuritë në kushte reale pune dhe të përgatiten për sfidat e profesionit.<br>Sipas rregullores së programit, vlerësimi i studentëve realizohet përmes provimeve, praktikave klinike dhe mikrotezës. Mikroteza është një komponent i rëndësishëm, i cili ndihmon në vlerësimin e aftësisë së studentëve për të analizuar dhe zbatuar njohuritë e tyre në një fushë specifike të infermierisë.<br>Në përfundim të programit, studentët fitojnë aftësi profesionale në ofrimin e kujdesit infermieror për pacientë me sëmundje të ndryshme, menaxhimin e gjendjeve akute dhe kronike, kujdesin parësor dhe rehabilitimin. Ata trajnohen për të ofruar ndërhyrje infermierore në situata klinike të ndryshme, të ndihmojnë në procesin e shërimit dhe të kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së jetës së pacientëve. Përmes praktikave klinike dhe trajtimit të rasteve reale, ata përgatiten për të punuar në spitale, qendra shëndetësore dhe institucione të tjera të kujdesit shëndetësor. Përgatitja e tyre teorike dhe praktike i bën ata konkurrues në tregun e punës, si në nivel kombëtar ashtu edhe ndërkombëtar, duke u mundësuar një integrim më të lehtë në sistemin shëndetësor.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 2.7.1; Plani mësimor i programit të studimit 2022-2023*<br>*Shtojca 2.7.2; Plani mësimor i programit të studimit 2023-2024*<br>*Shtojca 2.7.3; Plani mësimor i programit të studimit 2024-2025*<br>*Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2022-2023*<br>*Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2023-2024*<br>*Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2024-2025*<br>*Shtojca 5; Tabela Përmbledhëse për aneks RVB* |

| | |
|---|---|
| | *Shtojca 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset).*<br>*Shtojca 2.8.1; Model programi lëndor* |
| **Kriteri 3.** Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite. | Programi i studimit Bachelor në "Infermieri e Përgjithshme" është ndërtuar në përputhje me VKM Nr. 41/2018 dhe ndryshimet e mëvonshme, duke siguruar një ndarje të qartë të lëndëve sipas kategorive të veprimtarive formuese. Ky program, me një total prej 180 kreditesh ECTS, është strukturuar sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve, duke ofruar një kombinim të balancuar të njohurive teorike dhe praktike.<br>Lëndët ndahen në pesë kategori kryesore:<br>A. **Lëndë bazë** 32 ECTS (18.8 %)<br>B. **Lëndë karakterizuese** 99 ECTS (55 %)<br>C. **Lëndë ndërdisiplinore/ integruese** 23 ECTS (12.8 %)<br>D. **Lëndë plotësuese** 19 ECTS (10.6 %)<br>E. **Detyrime përmbyllëse dhe diploma** 7 ECTS (3.9 %)<br><br>Plani mësimor dhe syllabuset janë të përditësuara për të reflektuar zhvillimet e fundit në fushën e infermierisë, duke siguruar përgatitjen më të mirë të studentëve për kërkesat e tregut të punës dhe për avancimet profesionale në kujdesin shëndetësor.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 2.7.1; Plani mësimor i programit të studimit 2022-2023*<br>*Shtojca 2.7.2; Plani mësimor i programit të studimit 2023-2024*<br>*Shtojca 2.7.3; Plani mësimor i programit të studimit 2024-2025*<br>*Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2022-2023*<br>*Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2023-2024*<br>*Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2024-2025*<br>*Shtojca 5; Tabela Përmbledhëse për aneks RVB*<br>*Shtojca 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset).*<br>*Shtojca 2.8.1; Model programi lëndor* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të | Programi i studimit përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e një programi studimi sipas ligjit 80/2015, VKM nr.41. datë 24.01.2018 të ndryshuar, si dhe aktet nënligjore. Ai është organizuar sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe |

| | |
|---|---|
| detyrimeve përmbyllëse. | Grumbullimit të Krediteve (ECTS), realizohet në 3 vite studimi / 6 semestra, me 180 ECTS në total dhe është i strukturuar në grup-lëndë sipas kategorive të formimit duke respektuar kërkesat e kuadrit ligjor. Programi përmban 49 lëndë (180 kredite ECTS në total), duke përfshirë provimin përfundimtar për diplomë (7 ECTS). Programi ka 520 orë praktika klinike (35 ECTS), 231 orë praktika laboratorike të kujdesit infermier (11 ECTS), në total 751 orë ose 30,2 % të orëve totale në auditor. Programi i studimit përfshin praktikën klinike, e cila realizohet në institucione shëndetësore me të cilat Universiteti ka marrëveshje bashkëpunimi. Praktika mbikëqyrët nga pedagogë të miratuar, të cilët janë mjekë ose infermierë të autorizuar. Koordinimi i praktikës bëhet nga një pedagog i caktuar dhe studentët vlerësohen me provim përkatës pas përfundimit të saj.<br>Në përfundim të programit, studentët kryejnë detyrime përmbyllëse, të cilat përbëjnë 7 ECTS. Programi mbyllet me mbrojtjen e mikrotezës ose provim formimi, sipas rregulloreve të Universitetit. Për t'u pranuar në provim, studentët duhet të kenë një notë mesatare ≥7 gjatë katër semestrave të parë.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 2.7.1; Plani mësimor i programit të studimit 2022-2023*<br>*Shtojca 2.7.2; Plani mësimor i programit të studimit 2023-2024*<br>*Shtojca 2.7.3; Plani mësimor i programit të studimit 2024-2025*<br>*Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2022-2023*<br>*Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2023-2024*<br>*Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2024-2025*<br>*Shtojca 5; Tabela Përmbledhëse për aneks RVB*<br>*Shtojca 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset).*<br>*Shtojca 2.8.1; Model programi lëndor*<br>*Shtojca 2.18.3 Manuali i hartimit të temës së diplomës* |
| **Kriteri 5.** Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të | Në Statutin e UK përcaktohet se pranimi dhe regjistrimi i studentëve në Programin e studimit në "Infermieri e Përgjithshme" realizohet në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore që janë në fuqi. Kapacitetet pritëse dhe kuotat e pranimit për çdo program studimi përcaktohen me vendim të Senatit të Universitetit, duke |

| | |
|---|---|
| veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin. | siguruar që procesi të jetë transparent dhe i përshtatur me kërkesat e arsimit të lartë.<br>Programi i studimit Bachelor në "Infermieri e përgjithshme" organizohet dhe financohet në përputhje me Ligjin 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe aktet nënligjore të këtij ligji. Kriteret e pranimit dhe kuotat e pranimit miratohen nga Senati Akademik i Universitetit, duke siguruar një proces të rregullt dhe të drejtë pranimi për studentët.<br>Gjithashtu, UK zbaton një sistem financimi për kategori të veçanta studentësh, duke përfshirë ata të ekselencës, në përputhje me Ligjin për arsimin e lartë dhe VKM-në Nr. 780, datë 26.10.2018. Ky sistem i financimit ofron mundësi të barabarta dhe mbështetje për studentët që shfaqin rezultate të shkëlqyera akademike.<br>***UK nuk është një Institucion i Arsimit të Lartë me status të veçantë***.<br><br>**Evidencat:**<br>*Shtojca 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë*<br>*Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2022-2023*<br>*Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2023-2024*<br>*Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2024-2025*<br>*Shtojca 1.20; Rregullore e bordit të administrimit*<br>*Shtojca 4.7; Njoftimi për përfitimin e bursave* |
| **Kriteri 6.** Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind. | Programi i studimit Bachelor në "Infermieri e përgjithshme" ka ngjashmëri të dukshme me programet e tjera të së njëjtës fushë, që ofrohen nga institucione të arsimit të lartë (IAL) publike dhe private. Kjo u konfirmua gjatë takimeve të zhvilluara me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Njësisë Bazë të programit. Struktura dhe përmbajtja e këtij programi janë të ngjashme me ato të programeve Bachelor në Infermieri të ofruara kryesisht nga FSHNH dhe Universiteti i Korçës (UK).<br>Kjo koherencë e strukturës midis institucioneve të arsimit të lartë mundëson një mundësi të lehtë për transferimin e krediteve të studentëve që vazhdojnë studimet nga një institucion në tjetrin. Kjo e bën programin më fleksibël dhe të përshtatshëm për studentët që kërkojnë mundësi të tjera edukimi dhe avancimi në fushën e |

| | |
|---|---|
| | infermierisë, duke ofruar mundësi për zhvillimin profesional në institucione të ndryshme.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 2.7.1; Plani mësimor i programit të studimit 2022-2023*<br>*Shtojca 2.7.2; Plani mësimor i programit të studimit 2023-2024*<br>*Shtojca 2.7.3; Plani mësimor i programit të studimit 2024-2025*<br>*Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2022-2023*<br>*Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2023-2024*<br>*Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2024-2025* |
| **Kriteri 7.** Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit. | Universiteti i Korçës (UK) ka realizuar një ndarje të strukturuar të programeve të studimit, duke përdorur kode specifike për secilin program. Programi i studimit Bachelor në "Infermieri" është kodifikuar sipas kritereve përkatëse dhe fushës së studimit, me kodin **63BA0913S.**<br>Gjithashtu, çdo lëndë e përfshirë në program ka kodin e saj të veçantë, që mundëson një organizim të qartë dhe të ndarë të të gjithë programit, duke siguruar një menaxhim të saktë dhe të koordinuar të kurseve dhe krediteve. Ky sistem i kodifikimit e bën procesin e administratës më efikas dhe ndihmon në përshtatshmërinë e programit me standardet ndërkombëtare të arsimit të lartë.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 2.7.1; Plani mësimor i programit të studimit 2022-2023*<br>*Shtojca 2.7.2; Plani mësimor i programit të studimit 2023-2024*<br>*Shtojca 2.7.3; Plani mësimor i programit të studimit 2024-2025*<br>*Shtojca 4.12; Praktika e plotë e dokumentacionit "për kodifikimin e lëndëve të programit të studimit"* |
| **Kriteri 8.** Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në | ***Ky nuk është një program i përbashkët por ofrohet vetëm nga IAL-ja.*** |

| | |
|---|---|
| fuqi. | |
| **Konkluzione** | *Ky është një program studimi me 180 kredite (ECTS), dhe ky program ofrohet në module të veçanta dhe është i vlerësuar në kredite, sipas Sistemit Europian te Transferimit dhe Grumbullimit te Krediteve (ECTS). Nga plani mësimor lëndët janë ndarë në: A.Lëndë bazë 32 ECTS (18.8 %), B.Lëndë karakterizuese 99 ECTS (55 %), C.Lëndë ndërdisiplinore/ integruese 23 ECTS (12.8 %), D.Lëndë plotësuese 19 ECTS (10.6 %), E.Detyrime përmbyllëse dhe diploma 7 ECTS (3.9 %). Kurrikula e këtij programi studimi ka një kohëzgjatje të rregullt të planifikuar në 6 semestra dhe me një numër në total 180 Kredite.*<br>*Pjesë integrale e programit është praktika profesionale e cila zhvillohet në të tre vitet e studimit. Programi i studimit Bachelor në "Infermieri " ka ngjashmëri me programe të tjera të së njëjtës fushë që ofrohen në IAL të tjera publike e private. GVJ gjykon se raporti orë në auditor me orë individuale, lehtësisht në favor të orëve në auditor, është në përputhje me formimin dhe kompetencat e një profesionisti si Infermieria (profesion i rregulluar).* |

| Shkalla e përmbushjes së standardit | | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi II.2**<br>**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. | Të gjitha detyrimet ligjiore në fuqi përmbushen për ofrimin e këtij programi studimi. Universiteti i Korçës është krijuar me vendim **nr. 5, datë 07.01.1992** të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, mbi bazën e Institutit të Lartë Bujqësor (ILB), themeluar në vitin 1971.<br>Ky program studimi ofrohet nga departamenti i infermierisë pjesë e FSHNH (Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane) dhe ka në përbërjen e vet ka këto departamente sipas tabelës vijuese:<br>1. Departamenti Biologji-Kimisë<br>2. Departamenti i Infermierisë<br>3. Departamenti i Informatikës<br>4. Departamenti i Matematikës dhe Fizikës<br>5. Departamenti i Shkencave Sociale |

| | |
|---|---|
| | Në bazë të evidencave të derguara GVJ vë re që për Departamentin e Infermierisë gjatë viteve akademike 2022–2025, në total janë angazhuar 110 staf akademik, prej të cilëve 35 janë staf i brendshëm (PAE), të shpërndarë në mënyrë të qëndrueshme ndër vite (11 në vitin e parë dhe 12 në secilin nga dy vitet e tjera) dhe 75 janë staf i jashtëm (PAK), me një rritje të dukshme në vitin 2024–2025, ku arritën në 28.<br>Kjo tregon një mbështetje të madhe nga stafi i jashtëm, sidomos në vitin e fundit. Në të gjitha vitet, nuk ka asnjë Prof. Asoc. të angazhuar<br>Shumica e stafit me kontratë është e angazhuar me kohë të plotë në institucionet shëndetësore, duke krijuar një lidhje të fortë midis mësimdhënies në auditor dhe praktikës profesionale.<br>Menaxhimi i departamentit kryhet nga drejtuesi i tij, i cili ka përgjegjësinë për shpërndarjen e ngarkesës mësimore në përputhje me kualifikimet dhe profilin akademik të pedagogëve. Monitorimi i vazhdueshëm i procesit mësimor dhe shkencor siguron cilësi dhe përmirësim të vazhdueshëm.<br>Veprimtaria shkencore në departament është aktive, me pjesëmarrje të stafit në studime dhe botime shkencore. Bashkëpunimet ndërkombëtare dhe projektet kërkimore kanë një ndikim të rëndësishëm në pozitën akademike të departamentit dhe në cilësinë e mësimdhënies. Infrastruktura didaktike dhe burimet për kërkimin shkencor janë faktorë që ndikojnë në zhvillimin akademik.<br>Departamenti i Infermierisë është një njësi akademike e strukturuar mirë, me një trupë pedagogjike të kualifikuar dhe një proces të rregullt akademik e shkencor. Ai luan një rol të rëndësishëm në formimin e profesionistëve të shëndetësisë dhe në zhvillimin e kërkimit shkencor në këtë fushë.<br>***Të dhëna për Departamentin e Infermierisë:*** |

| **Tituj/ grada** | **2022 – 2023** | | **2023 – 2024** | | **2024-2025** | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **PAE** | **PAK** | **PAE** | **PAK** | **PAE** | **PAK** |
| Prof.Dr. | - | 1 | - | 1 | - | 1 |
| Prof. Asoc. | - | - | - | - | - | - |
| Dr./PhD. | 5 | 1 | 4 | 1 | 5 | 2 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Msc. | 6 | 22 | 7 | 21 | 7 | 25 |
| **Totali** | **11** | **24** | **12** | **23** | **12** | **28** |

**Evidenca:**

*Shtojca 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë*

*Shtojca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë*

*Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2022-2023*

*Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2023-2024*

*Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2024-2025*

*Shtojca 2.3; Rregullore e njësisë bazë "Departamenti i Infermierisë";*

*Shtojca 5; Tabela Përmbledhëse për aneks RVB*

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj. | Sipas rregullores së UNIKO, Nenet 99 dhe 100, praktikat profesionale janë të detyrueshme për studentët dhe përfshihen në planet mësimore. Sekretaria e departamentit njofton studentët për kohën e zhvillimit të praktikës. Praktikat zhvillohen në institucione publike ose private sipas profilit të studimit dhe studentët janë të detyruar të respektojnë rregullat e institucionit pritës. Në përfundim, ata dorëzojnë një raport pune që vlerësohet nga pedagogu dhe institucioni pritës, me pikë që konvertohen në notë. Organizimi i praktikave bëhet nga komisioni përkatës dhe zhvillohet sipas rregullores mësimore të programit të studimit. Institucionet pritëse duhet të jenë të miratuara nga fakultetet.<br>Detyrat e pedagogëve të praktikës janë të përcaktuara qartë në rregulloren e praktikave mësimore, klinike-profesionale si dhe në programin e studimit. Për të siguruar zhvillimin e suksesshëm të praktikave klinike, një numër i konsiderueshëm mjekësh dhe infermierësh PAK janë angazhuar për mbikëqyrjen e praktikave, duke ofruar mbështetje në shërbimet dhe vendet e duhura.<br>Praktikat klinike janë të mbikëqyra nga **5 pedagogë të stafit PAE** dhe **20 pedagogë të stafit PAK**, që përfshijnë 10 mjekë dhe 10 kryeinfermierë, të cilët sigurojnë mbikëqyrje dhe orientim të drejtpërdrejtë gjatë praktikave. Në të njëjtën kohë, orët laboratorike realizohen nga 10 pedagogë të stafit PAE dhe 4 pedagogë të stafit PAK, duke ofruar mundësi për studentët për të zhvilluar aftësi të |

| | |
|---|---|
| | nevojshme teknike dhe praktike.<br>Për koordinimin dhe monitorimin e praktikave, është caktuar një koordinator PAE, i cili ka përgjegjësinë për të organizuar dhe ndjekur ecurinë e tyre. Ky koordinator siguron që praktikantët të kenë mbikëqyrjen dhe udhëzimin e nevojshëm dhe se praktikat zhvillohen në përputhje me kërkesat dhe standardet e programit të studimit.<br>***Stafi mbikqyrës i praktikës profesionale i raportuar nga Institucioni, bazuar dhe në Statutin e UK, janë staf mjeksor i spitaleve dhe kjo është një pikë e fortë për këtë program studimi.***<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 1.2 Rregullorja e UNIKO.pdf.*<br>*Shtojca 3.16.1 Udhëzues & rregullore e praktikave mësimore, klinike-profesionale.pdf*<br>*Shtojca 3.16.2 Udhëzues vlerësimi e praktikave mësimore, klinike-profesionale.pdf*<br>*Shtojca 5; Tabela Përmbledhëse për aneks RVB*<br>*Shtojca 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset).*<br>*Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2022-2023*<br>*Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2023-2024*<br>*Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2024-2025* |
| **Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. | Në bazë të Rregullores së organizimit dhe veprimtarisë mësimore kërkimore Kreu II, Neni 14 Koordinatori i programit të studimit është përgjegjës për ecurinë dhe mbarvajtjen e programit dhe praktikave profesionale. Paralelisht, ai informon drejtuesin e departamentit për problematikat e ndryshme. Koordinatori propozohet nga drejtuesi i njësisë bazë dhe miratohet nga Dekani. Kjo procedurë u konfirmua dhe në takimin me Drejtuesit e Njësive kryesore/Bazë. GVJ në bazë të dokumentacionit të vënë në dispozicion konstaton që institucioni tregon një angazhim serioz për mbikëqyrjen e realizimit të praktikës klinike, duke siguruar që studentët të marrin mbështetje të plotë dhe udhëzime profesionale gjatë gjithë periudhës së praktikës<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 1.2 Rregullorja e UNIKO.pdf.* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *2.2 Rregullore e organizimit & veprimtarisë mësimore kërkimore.pdf.pdf*<br>*Shtojca 2.11; Vendimi i njësisë bazë për emërimin e koordinatorëve të programeve të studimit.*<br>*Shtojca 4.13; Vendimi rektoratit "Grupi monitorimit procesit mësimor"*<br>*Takim me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë;*<br>*Takim me studentët* | | | |
| **Konkluzione** | *Të gjitha detyrimet ligjiore në fuqi përmbushen për ofrimin e këtij programi studimi. Numri i stafit akademik në vite është i qëndrueshëm. Ka një numër të konsiterueshëm të stafit akademik me Grada dhe Tituj akademike dhe kjo është një pikë shumë e fortë. Departamenti ka në përbërje staf ndihmës akademik. Koordinatori i programit të studimit (përgjegjësi i departamentit) është përgjegjës për ecurinë dhe mbarvajtjen e programit dhe praktikave profesionale.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi II.3**<br>**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve. | Dokumentacioni i nevojshëm për ofrimin e këtij programi studimi është i disponueshëm pranë Njësisë Kryesore. Statuti dhe Rregullorja e Institucionit përcaktojnë rregullat e përgjithshme, ndërsa informacionet më të detajuara për këtë program studimi paraqiten në Rregulloren e Njësisë Kryesore, Njësisë Bazë dhe në Rregulloren e programit të studimit.<br>Në takimin e zhvilluar me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Njësisë Bazë, ata raportuan se i gjithë dokumentacioni është i disponueshëm pranë Njësisë Kryesore, përfshirë rregulloren, planin mësimor, syllabuset, literaturën bazë. Po ashtu, ndarja e lëndëve sipas veprimtarive formuese është e disponueshme në dy gjuhë, shqip dhe anglisht. Një kopje e këtij dokumentacioni është gjithashtu e disponueshme pranë Njësisë Bazë.<br>Ndarja e lëndëve moduleve sipas veprimtarive formuese është bazuar dhe ka respektuar kërkesat e VKM numër 41. datë 24.01.2018. "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e |

arsimit të lartë". i ndryshuar, të kategorizuara si më poshtë:

| Kategoria e Lëndëve | ECTS | Pesha në % |
|---|---|---|
| **A. Lëndë bazë – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme** | 32 | 18.8% |
| **B. Lëndë karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore (B)** | 99 | 55% |
| **C. Lëndë ndërdisiplinore/integruese – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (C)** | 23 | 12.8% |
| **D. Lëndë plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale (D)** | 19 | 10.6% |
| **E. Detyrime përmbyllëse dhe diploma** | 7 | 3.9% |

**Evidenca:**

*Shtojca 1.2 Rregullorja e UNIKO.pdf.*
*Shtojca 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë*
*Shtojca 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH*
*Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2022-2023*
*Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2023-2024*
*Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2024-2025*
*Shtojca 2.14; Struktura dhe organigrama e UK*
*Shtojca 2.13.1; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2021-2022*
*Shtojca 2.13.2; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2022-2023*
*Shtojca 2.13.3; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin* akademik *2023-2024*
*Shtojca 2.7.1; Plani mësimor i programit të studimit 2022-2023*
*Shtojca 2.7.2; Plani mësimor i programit të studimit 2023-2024*
*Shtojca 2.7.3; Plani mësimor i programit të studimit 2024-2025*
*Shtojca 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset).*
*Shtojca 5; Tabela Përmbledhëse për aneks RVB*

**Kriteri 2.** Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.

Ky është një program studimi me 180 kredite (ECTS). Programi i formimit për Infermieritë përbëhet nga të paktën 4500 orë formimi teorik dhe praktik me të paktën 1/3 e kohëzgjatjes minimale që përfaqëson formimin klinik.
GVJ gjykon se raporti orë në auditor me orë individuale, lehtësisht në favor të orëve në auditor, është në përputhje me formimin si profesion të rregulluar të Infermierisë.
Plani mësimor prezanton lëndët nëse janë semestrale apo vjetore, kategorinë nr. e provimeve, kreditet, ndarja e orëve në kredite, ndarja e orëve në semestër dhe totalin e orëve në auditor.

| **Bachelor në Infermieri** | **Në total** |
|---|---|
| **Orë në auditor** | **2209 (49.1 %)** |
| • Leksione | 1106 |
| • Seminare | 223 |
| • Ushtrime | 117 |
| • Laboratore | 243 |
| • Praktika klinike | 520 |
| • Pregatitje e mikrotezës | 175 (jashtë auditorit) |
| **Punë e pavarur e studentit** | **2291 (50.9 %)** |
| **Gjithsej** | **4500** |

FSHNH vë në dispozicion të studentëve "Manualin e studentit" i cili përmban informacione të detajuara jo vetëm për programet e studimit, por dhe mënyrën e realizimit të tyre dhe infrastrukturën mbështetëse.
Plani mësimor përmban emërtimin e lëndëve të renditura sipas semestrave, numrin e krediteve dhe raportin e orëve ndërmjet leksioneve, seminareve dhe laboratorëve. Detyrimet për secilën lëndë përfshijnë seminare, detyra, projekte, laboratorë dhe praktikë klinike. Kontrolli i dijeve realizohet përmes metodave të përcaktuara për çdo lëndë. Sylabuset janë përshtatur sipas VKM nr. 41, datë 24.01.2018, e ndryshuar, duke pasqyruar të gjithë elementët e kërkuar në shtojcën e këtij vendimi.

**Evidenca:**
*Shtojca 2.7.1; Plani mësimor i programit të studimit 2022-2023*
*Shtojca 2.7.2; Plani mësimor i programit të studimit 2023-2024*
*Shtojca 2.7.3; Plani mësimor i programit të studimit 2024-2025*
*Shtojca 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset)*

| | |
|---|---|
| | *Shtojca 3.14; Udhërrëfyesi i studentëve (prezantimi me vitet e para)*<br>*Shtojca 4.11; Jeta studentore dhe veprimtaria e QKA*<br>*Shtojca 5; Tabela Përmbledhëse për aneks RVB* |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. | Neni 55 i Statutit të Institucionit përcakton se në programet e studimit të ciklit të parë pranohen si studentë vendas ashtu edhe të huaj, ndërsa detajet e pranimit janë të përfshira në rregulloren e programit të studimit (Neni 46). Transferimi dhe ekuivalentimi i studimeve, diplomave dhe kalimi nga një program në një tjetër rregullohen nga Neni 60 i rregullores së Institucionit UK, Neni 66 i Statutit dhe pika 15 e Rregullores së programit të studimit. Po ashtu, pika 7 e Rregullores së rogramit të studimit përcakton politikat e pranimit në programin e studimeve. Raporti i vlerësimit të jashtëm për programin e Infermierisë vlerëson strukturën akademike, pranimin dhe transferimin e studentëve, si dhe përputhshmërinë me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare. Plani mësimor, i miratuar nga dekanati dhe senati akademik, përfshin informacion mbi lëndët, kreditet, metodat e mësimdhënies dhe vlerësimit.<br>Pranimi i studentëve bazohet në rregulloret institucionale dhe kriteret e miratuara çdo vit nga senati akademik, ndërsa transferimi i studimeve rregullohet sipas akteve të MASH. Procedurat për transferim dhe ekuivalentim të krediteve janë të përcaktuara qartë, duke siguruar fleksibilitet akademik.<br>Në përgjithësi, programi garanton cilësi në përgatitjen e profesionistëve të infermierisë, duke përmbushur standardet akademike dhe kërkesat e tregut të punës.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë*<br>*Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2022-2023*<br>*Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2023-2024*<br>*Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2024-2025*<br>*Shtojca 2.7.1; Plani mësimor i programit të studimit 2022-2023*<br>*Shtojca 2.7.2; Plani mësimor i programit të studimit 2023-2024*<br>*Shtojca 2.7.3; Plani mësimor i programit të studimit 2024-2025*<br>*Shtojca 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset)*<br>*Shtojca 5; Tabela Përmbledhëse për aneks RVB*<br>*Shtojca 3.19; "Propozim për kuotat & kriteret e pranimit të* |

| | |
|---|---|
| | *studentëve".* |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikat, seminaret apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara. | Sipas nenit 71 të Rregullores së Universitetit F. S. Noli Korçë , stafi akademik është i detyruar të hartoj programin mësimor të lëndës, plotësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tij dhe ta dorëzoj atë në Departament. Programi lëndor (syllabusi) përmban: titullarin ose pedagogun e lëndës, ngarkesën, tipologjinë e lëndës, vitin akademik ose semestrin kur zhvillohet, llojin e lëndës, programin e studimit, kodin e lëndës dhe adresën elektronike të titullarit ose pedagogut të lëndës. Ai gjithashtu përfshin një përmbledhje dhe rezultatet e të nxënit, konceptet themelore, temat e lëndës, formën e kontrollit të dijeve, frekuentimin, kontrollin e vazhdueshëm si dhe literaturën, e cila ndahet në literaturë bazë të detyrueshme dhe literaturë të rekomanduar. Në fund, përfshihen edhe vërejtjet përfundimtare nga pedagogu i lëndës.<br>Formati i programit lëndor miratohet me vendim rektorati dhe i përcillet përgjegjësve të Njësive Bazë. Syllabuset janë të formatuara me të gjithë elementët e parashikuara në VKM 41/2018, e ndryshuar duke pasqyruar të gjithë elementët që parashikohen në shtojcën e këtij vendimi.<br>Në takimin me stafin akademik ata raportuan se çdo fillim viti dorëzojnë syllabuset me ndryshimet/përmirësimet përkatëse.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë*<br>*Shtojca 2.7.1; Plani mësimor i programit të studimit 2022-2023*<br>*Shtojca 2.7.2; Plani mësimor i programit të studimit 2023-2024*<br>*Shtojca 2.7.3; Plani mësimor i programit të studimit 2024-2025*<br>*Shtojca 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset)* |
| **Kriteri 5.** Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë. | Programi i studimit është në proces përmirësimi të vazhdueshëm. Kjo u përmend në takimin me Drejtuesit e Njësive Kryesore/Bazë. Ata raportuan se në fillim të çdo viti akademik bëhen rregullime nëse është e nevojshme, pasi miratohen në Departament. E gjithë procedura e përditësimit ndjek një cikël të plotë, duke filluar nga departamentet, miratimin në dekanat dhe dërgimin e propozimeve për aprovimin përfundimtar nga Akademik i UK. Studentët raportuan se ata pyetishin nga pedagogët për mundësi përmirësimi të programit të lëndëve por nuk kishin marrë pjesë në procedurë për përmirësimin e programit të studimit. Stafi akademik, në takimin e zhvilluar raportuan se kanë marrë pjesë në procedurë për përditësimin e |

| | |
|---|---|
| | programit të studimit.<br>Në takimin e zhvilluar me përfaqësues të drejtorisë përkatëse për kurrikulat, ato raportuan procedurën për rishikim të planeve dhe programeve mësimore, përpara fillimit të çdo viti akademik.<br>Në takimin me stafin akademik ata raportuan se çdo fillim viti dorëzojnë syllabuset me ndryshimet/përmirësimet përkatëse.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë*<br>*Shtojca 2.12.1; Praktika e plotë për miratimin e ndryshimeve të propozuara në kurrikulën e programit*<br>*Shtojca 2.12.2; Procedura e ndryshimeve në planin mësimor (rishikimi i kurrikulës).*<br>*Takim me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë;*<br>*Takim me stafin akademik;*<br>*Takim me studentët.* |
| **Konkluzione** | *Dokumentacioni i nevojshëm për ofrimin e këtij programi studimi është i disponueshëm nga Njësia Bazë. Ky është një program i ciklit të parë dhe ka në total 180 kredite (ECTS). Plani mësimor prezanton lëndët nëse janë semestrale apo vjetore, kategorinë , nr. e provimeve, kreditet, ndarja e orëve në kredite, ndarja e orëve në semestër dhe totalin e orëve në auditor. Syllabuset janë të formatuara me të gjithë elementët e parashikuara në VKM 41/2018, e ndyshuar, megjithatë GVJ konsideron përditësimin e vazhdueshëm të literaturës. Rishikimi i planit dhe programeve mësimore kryhet përpara fillimit të çdo viti akademik sipas një procedure të formalizuar.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi II.4**<br>**Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimit të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe | Programi i studimit në Infermieri është hartuar për të ofruar një bazë të fortë teorike dhe praktike, duke përgatitur studentët për sfidat profesionale në kujdesin shëndetësor. Ai fokusohet në |

| | |
|---|---|
| praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve. | zhvillimin e aftësive të nevojshme për ofrimin e kujdesit infermieror cilësor për pacientët në mjedise të ndryshme shëndetësore.<br>Një rëndësi e veçantë i kushtohet formimit praktik, i cili fillon që në vitin e parë dhe zhvillohet gjatë gjithë studimeve. Studentët aftësohen në trajtimin, monitorimin dhe mbështetjen e pacientëve, si dhe në zbatimin e protokolleve të kujdesit infermieror. Programi synon të përgatisë infermierë të kualifikuar, të aftë për të punuar në sektorin shëndetësor, duke u bazuar në standardet më të mira profesionale dhe kërkesat e tregut të punës.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 2.7.1; Plani mësimor i programit të studimit 2022-2023*<br>*Shtojca 2.7.2; Plani mësimor i programit të studimit 2023-2024*<br>*Shtojca 2.7.3; Plani mësimor i programit të studimit 2024-2025*<br>*Shtojca 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset)*<br>*Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2022-2023*<br>*Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2024-2025* |
| **Kriteri 2.** Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit. | Ky program studimi është organizuar sipas ligjit. 80/ 2015, VKM numër 41. datë 24.01.2018, i ndryshuar. Programi studimit synon të ofroj një formim bazë në fushën e Infermierisë që do tu shërbej studentëve si për studime të mëtejshme por edhe për punësim. Programi i studimit ofrohet në tre vite akademike (6 semestra) dhe ka një total 180 kredite. Totali i krediteve konverohet në orë brenda dhe jashtë auditorit. Lëndët e modulet e këtij programi studimi janë të ndara në vite/semestra. Secila lëndë ka një numër të caktuar kreditesh. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohen objektivat e përgjithshme ndërsa në syllabuset e lëndëve janë të përcaktuara qartë objektivat formuese si dhe rezultatet e të nxënit. Në takimet e zhvilluara në Institucion, u raportua se përmes lëndëve/moduleve, është e mundur arritja e objektivave të këtij programi studimi. Për të siguruar përmirësimin e vazhdueshëm të programit, departamentet dhe personeli akademik, përveç eksperiencës së tyre profesionale, bashkëpunojnë rregullisht me partnerë dhe institucione si Urdhri i Infermierit, studentë të diplomuar dhe aktorë të tjerë të fushës. Këto konsultime ndihmojnë në përditësimin e kurrikulës, duke e përshtatur atë me nevojat e |

| | |
|---|---|
| | tregut të punës dhe zhvillimet më të fundit në fushën e infermierisë.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2022-2023*<br>*Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2023-2024*<br>*Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2024-2025*<br>*Shtojca 2.7.1; Plani mësimor i programit të studimit 2022-2023*<br>*Shtojca 2.7.2; Plani mësimor i programit të studimit 2023-2024*<br>*Shtojca 2.7.3; Plani mësimor i programit të studimit 2024-2025*<br>*Shtojca 4.15; VKM 41/2018 (e ndryshuar)*<br>*Takim me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë;*<br>*Takim me stafin akademik;*<br>*Takim me studentët.* |
| **Kriteri 3.** Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. | Programi i studimit përfshin orë brenda dhe jashtë auditorit. Në total ky program ofrohet në tre vite akademike dhe kërkon angazhimin për 4500 orë nga të cilat 2209 orë në auditor dhe 2291 orë jashtë auditorit. Programi i studimit përfshin teori dhe praktikë.<br><br>(see table below)<br><br>Programi i studimit është i ngjashëm me programe të tjera brenda Shqipërisë, siç raportuan Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë në takimin e zhvilluar. Në syllabuset e lëndëve përcaktohen qartë orët e teorisë dhe praktikës.<br>Në total studentët gjatë studimeve të tyre zhvillojnë 1106 orë |

| **Bachelor në Infermieri** | **Në total** |
|---|---|
| **Orë në auditor** | **2209 (49.1 %)** |
| • Leksione | 1106 |
| • Seminare | 223 |
| • Ushtrime | 117 |
| • Laboratore | 243 |
| • Praktika klinike | 520 |
| • Pregatitje e mikrotezës | 175 (jashtë auditorit) |
| **Punë e pavarur e studentit** | **2291 (50.9 %)** |
| **Gjithsej** | **4500** |

| | |
|---|---|
| | leksione, 223 orë seminare, 117 orë ushtrime, 243 orë laboratorë dhe 520 orë praktikë klinike. Në total, ky program ka 2209 orë. . Aktualisht raporti teori-praktikë është në nivelin **70/30** çka tregoni përafrim të kënaqshëm me standardet europiane në programe të ngjashme. GVJ konsideron se orët e praktikës profesionale janë në përputhje me aktet ligjore/nënligjore në fuqi, por për vitet e ardhshme në zbatim të VKM nr.41/2018, ndryshuar së fundmi me VKM nr.823/2023, këto orë do të rriten për programin e Bachelor në Infermieri, në të gjitha IAL në nivel vendi (brenda viti 2027).<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 2.7.1; Plani mësimor i programit të studimit 2022-2023*<br>*Shtojca 2.7.2; Plani mësimor i programit të studimit 2023-2024*<br>*Shtojca 2.7.3; Plani mësimor i programit të studimit 2024-2025*<br>*Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2022-2023*<br>*Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2023-2024*<br>*Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2024-2025*<br>*Shtojca 2.13.1; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2021-2022*<br>*Shtojca 2.13.2; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2022-2023*<br>*Shtojca 2.13.3; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2023-2024*<br>*Shtojca 2.17.1; Analiza e punës mësimore-shkencore Departamenti Infermierisë, për vitin akademik 2021-2022.*<br>*Shtojca 2.17.2; Analiza e punës mësimore-shkencore Departamenti Infermierisë ,per vitin akademik 2022-2023.* |
| **Kriteri 4.** Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve. | Disiplinat mësimore të programit të studimit Bachelor në "Infermieri", janë të organizuara në pesë kategori, nga A tek E. A. Lëndë bazë – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme 32 ECTS (18.8 %), B. Lëndë karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore (B) 99 ECTS (55 %), C. Lëndë ndërdisiplinore/integruese – nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (C) 23 ECTS (12.8 %), D. Lëndë plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale (D) 19 ECTS (10.6 %), E. Detyrime përmbyllëse dhe diploma 7 ECTS (3.9 %) Plani mësimor përcakton të detajuar kreditet për secilën lëndë. Neni |

| | |
|---|---|
| | 55 i Statutit së Institucionit raporton se në programet e studimit pranohen student vendas dhe të huaj ndërsa detajet për pranimin e tyre përfshihen në rregulloren e programit të studimit. Transferimi dhe ekuivalentimi i studimeve, diplomave dhe kalimi nga një program në një tjetër rregullohen nga Neni 60 i rregullores së Institucionit UK, Neni 66 i Statutit dhe pika 15 e rregullores së Programit të studimit. Po ashtu, pika 7 e Rregullores së programit të studimit përcakton politikat e pranimit në programin e studimeve.<br>Mobiliteti është i mundur në kuadër të këtij programi studimi dhe u raportua nga Drejtuesit e Njësisë Kryesore/Bazë si dhe nga studentët.<br>Nga dokumentat e dorëzuara ne DVV, rezulton se ka thirrje të vazhdueshme për studentët për pjesëmarrje në programin Erasmus+ dhe ka marrëveshje bashkëpunimi Erasmus+ dhe kjo është pikë pozitive. Gjithashtu ka pjesëmarrje të stafit akademik në këto projekte. Për përmirësimin e vazhdueshëm të përmbajtjes së programit departamenti dhe personeli akademik përveç eksperiencës së fituar, konsultohen vazhdimisht me partnerët dhe bashkëpunëtorët si Urdhri i Infermierit, shoqata të ndryshme, studentë të diplomuar etj. Në përfundim të studimeve, punësimi është i mundur. GVJ vëren se vetëm një pjesë e vogël e të diplomuarve nuk punojnë në profilin e tyre.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 2.4.1 Raporti i analizes vjetore të veprimtarisë mësimore, kerkimorë dhe financiare i uk 2021-2022.pdf*<br>*Shtojca 2.4.2 Raporti i analizes vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i uk 2022-2023.pdf*<br>*Shtojca 2.4.3 Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i uk 2023-2024.pdf.*<br>*Shtojca 2.3; Rregullore e njësisë bazë "Departamenti i Infermierisë";*<br>*Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2022-2023*<br>*Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2023-2024*<br>*Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2024-2025*<br>*Shtojca 2.7.1; Plani mësimor i programit të studimit 2022-2023*<br>*Shtojca 2.7.2; Plani mësimor i programit të studimit 2023-2024* |

| | |
|---|---|
| | *Shtojca 2.7.3; Plani mësimor i programit të studimit 2024-2025*<br>*Shtojca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë*<br>*Shtojca 3.5 Mobilitete kombetare & nderkombetare te stafit akademik (erasmus+).pdf.*<br>*Takim me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë;* |
| **Kriteri 5.** Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit. | Sipas nenit 71 të Rregullores së Universitetit F. S. Noli Korçë, stafi akademik është i detyruar të hartoj programin mësimor të lëndës, plotësimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të tij dhe ta dorëzoj atë në Departament. Pedagogu i lëndës harton programin mësimor në bazë të objektivave të programit të studimit si dhe në bazë të ecurisë së shkencës së Infermierisë. Syllabusi dorëzohet dhe miratohet në Departament nga Drejtuesi i Njësisë Bazë. Literatura bazë dhe e rekomanduar përfshihet në të gjithë syllabuset e dorëzuar.<br>Syllabuset janë të formatuara me të gjithë elementët e parashikuara në VKM 41/2018, e ndyshuar. Nga dokumentet e dorëzuara, rezulton se kërkesa e fundit për pasurimin e bibliotekës është bërë disa vite më parë. Drejtuesit e Njësisë Kryesore/Bazë e justifikuan këtë me disponueshmërinë e librave online, të cilët studentët i përdorin lehtësisht. Gjatë takimit me studentët, ata raportuan se e frekuentojnë bibliotekën. Aktualisht, FSHNH ka në bibliotekë 1665 tituj, 3892 libra, 43 staf akademik dhe 200 studentë që e frekuentojnë.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset).*<br>*Shtojca 2.8.1; Model programi lëndor*<br>*Shtojca 3.12 Raport informues i bibliotekes shkencore të uk mbi botimet dhe përditësimet e literaturës.pdf.*<br>*Shtojca 3.12.1 Biblioteka online j-store + u-library.pdf*<br>*Shtojca 3.13 Tabelë përmbledhëse e fondit të bibliotekës fshnh.pdf.pdf*<br>*Takim me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë;* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 6.** Përmbajtja e programit të studimit garanton përftimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara. | Programi i studimit Bachelor në "Infermieri" u mundëson studentëve përfitimin e njohurive, aftësive dhe kompetencave të synuara. Objektivat e programit të studimit janë të prezantuara në Rregulloren e programit si dhe në syllabuset respektive. Kjo gjë u raportua dhe në takimin e zhvilluar me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë. Përfshirja e teorisë dhe praktikës rrit kompetencat e studentëve për përdorimin e tyre gjatë punësimit.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca* 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2022-2023<br>*Shtojca* 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2023-2024<br>*Shtojca* 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2024-2025<br>*Takim me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë.* |
| **Kriteri 7.** Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës. | Ky është një program studimi Bachelor në "Infermieri" dhe studentët kanë mundësinë të vazhdojnë studime në ciklin e dytë të studimeve Master profesinal apo i Shkencave në përfundim të këtij programi, apo dhe të punësohen. Universiteti i Korçës, përveç stimulimit dhe forcimit të kompetencave dhe aftësive të studentëve nëpërmjet programeve akademike, gjithashtu mbështet studentët që të integrohen me sukses në tregun e punës nëpërmjet zyrës së karrierës, e cila funksionon në bazë të statutit të universitetit. Gjithashtu kontaktet institucionale zhvillohen përmes eventeve si ditët e karrierës, trajnime dhe workshope të ndryshme, reagime të punëdhënësve, aktivitete, veprimtari shkencore etj. Nga të dhënat e ALUMNI shumica e studentëve të këtij programi janë të punësuar. I njëjti rezultat evidentohet edhe nga të dhënat e siguruara nga Urdhri i Infermierit të Shqipërisë që është institucioni për marrjen e Lejes së Ushtrimit të profesionit.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 2.16; Gjurmimi i ecurisë së punësimit (alumni) dhe UISH*<br>*Shtojca 2.20; Jeta studentore dhe veprimtaritë e QKA*<br>*Shtojca 4.8; Webfaqja e UK*<br>*Shtojca 4.9; Webfaqja e FSHNH*<br>*Takim me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë;*<br>*Takim me studentët.* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Konkluzione** | *Ky program studimi ka objektiva të përcaktuara qartë për formimin e vazhdueshëm të studentëve, të cilat përfshijnë dijet, aftësite dhe kompetencat profesionale. Në total ky program ofrohet në tre vite akademike dhe kërkon angazhimin për 4500 orë nga të cilat 2209 orë në auditor dhe 2291 orë jashtë auditorit. Studentët gjatë studimeve të tyre zhvillojnë 1106 orë leksione, 223 orë seminare, 117 orë ushtrime, 243 orë laboratorë dhe 520 orë praktikë klinike. Në total, ky program ka 2209 orë Nuk u raportuan mobilitete për studentët e këtij programi studimi, por institucioni ofron për studentët mundësi mobiliteti. Janë shumë marrëveshje me projekte Erasmus + dhe kjo është pikë pozitive. Ka një përfshirje të stafit akademik në këto projekte. Pjesa dërrmuese e studentëve që kanë përfunduar këtë program studimi janë të punësuar.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi II.5**<br>**Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës. | UK ofron programe studimi të përshtatura me tregun e punës. Drejtuesia e Njësisë Kryesore raportoi se janë munduar të përshtasin programet e studimit sipas nevojave. Institucioni raporton se mundohet të përshtasë programin e studimit.<br>Në kuadër të përshtatjes me kërkesat e tregut të punës dhe nevojat shëndetësore, institucioni realizon studime të tregut dhe zhvillon takime me përfaqësues të institucioneve shëndetësore, IAL-ve me profil mjekësor, si dhe Urdhrin e Infermierit.<br>Në shtator 2022, UK kreu një studim të detajuar të tregut të punës, duke reflektuar gjetjet e tij në përditësimin e programeve të studimit. Gjithashtu, takimet me titullarët e FSHNH dhe stafin akademik konfirmojnë se opinioni i tregut të punës merret kryesisht përmes kontakteve në ambientet spitalore, ku studentët zhvillojnë praktikat e tyre.<br>Një kontribut të rëndësishëm në këtë proces japin edhe pedagogët e departamentit, të cilët, duke qenë profesionistë aktivë në spitale, ndihmojnë në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve mësimore. |

| | |
|---|---|
| | Programi i studimit Bachelor. Infermieri është në përputhje me vizionin dhe misionin e UK dhe FSHNH, strategjinë e zhvillimit, plotësimit të nevojave të edukimit, kërkimit dhe transferimit të njohurive.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 3.11; Studim tregu për programin e studimit*<br>*Takim me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë;*<br>*Takim me stafin akademik;*<br>*Takim me përfaqsues të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave* |
| **Kriteri 2.** Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit. | Në përputhje me parashikimet ligjore dhe Statutin e UK, Senati Akademik përfshin në përbërjen e tij edhe studentë. Institucioni ka ngritur gjithashtu Këshillin Studentor, duke garantuar përfaqësimin e studentëve në komisione të ndryshme, përfshirë proceset e akreditimit.<br>Një tjetër mekanizëm efektiv është senatori i klasës, i cili ka shërbyer si urë lidhëse midis studentëve dhe strukturave drejtuese, duke funksionuar në mënyrë optimale. Këto u konfirmuan edhe në takimin me studentët, të cilët raportuan se kanë akses të hapur në Drejtuesinë e Njësisë Kryesore për adresimin e problematikave të ndryshme.<br>Gjithashtu, studentët raportuan për përfshirjen e tyre aktive, duke dhënë mendimin për organizimin e konferencave dhe duke marrë pjesë në vendimmarrje institucionale. Vlerësimi i stafit akademik nga ana e studentëve rezulton pozitiv.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë*<br>*Shtojca 1.17; Rregullorja e Këshillit Studentor*<br>*Shtojca 3.11; Studim tregu për programin e studimit*<br>*Takim me studentët.* |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionalë | Bashkëpunimi me institucione kërkimore dhe shkencore është një pjesë thelbësore e përmirësimit të programeve të studimit. Angazhimi i personelit akademik nga këto institucione ndihmon departamentet të reflektojnë mbi zhvillimet më të fundit në fushën e Infermierisë dhe të ndërveprojnë me një rrjet të gjerë profesionistësh, shoqata dhe borde të ndryshme.<br>Drejtuesit e UK raportuan për përpjekjet e vazhdueshme në përditësimin e programeve të studimit në përputhje me ndryshimet më të fundit në sektorin shëndetësor. Kjo u konfirmua edhe nga |

| | |
|---|---|
| (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private. | stafi akademik gjatë takimeve të zhvilluara. Institucioni ka një komunikim zyrtar me UISH për të identifikuar nivelin e kalueshmërisë në provimin e praktikës profesionale dhe atë të licencës, çka ndihmon në përshtatjen e kurrikulave me kërkesat e tregut të punës. GVJ vlerëson si të rëndësishme rritjen e vazhdueshme të këtij bashkëpunimi për të përmirësuar dhe përditësuar programet akademike.<br>Gjithashtu, institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me një sërë institucionesh shëndetësore, duke përfshirë Spitalin Rajonal, Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor Parësor, Qendrën Komunitare të Shëndetit Mendor, Qendrën e Kujdesit Paliativ, Kryqin e Kuq dhe institucione homologe brenda dhe jashtë Shqipërisë. Ky rrjet bashkëpunëtorësh luan një rol kyç në përmirësimin e cilësisë së programeve të studimit dhe përgatitjen profesionale të studentëve.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 2.10; Marrëveshjet e bashkëpunimit në mbështetje të praktikave klinike dhe profesionale.*<br>*Shtojca 2.16 Gjurmimi i ecurisë së punësimit (Alumni) dhe UISH (Urdhëri i Infermierit të Shqipërisë) .pdf.*<br>*Shtojca 2.10.1; Marrëveshje bashkëpunimi të FSHNH*<br>*Shtojca 2.10.2; Listë përmbledhëse e marrëveshjeve institucionale;*<br>*Takim me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë;*<br>*Takim me stafin akademik.* |
| **Konkluzione** | *Institucioni ka vijuar përmirësimin e programit të studimit në përputhje me nevojat dhe kërkesat e tregut të punës. Ky proces mbështetet në feedback-un e vazhdueshëm të marrë nga partnerët institucionalë, pedagogët/ekspertët e fushës dhe Alumni.*<br>*Të dhënat e siguruara nga Alumni tregojnë se shumica e studentëve të këtij programi janë të punësuar. Ky rezultat konfirmohet edhe nga UISH, i cili pajis studentët me Lejen e Ushtrimit të Profesionit pas kalimit me sukses të provimit të shtetit pranë QSHA-së. Këto të dhëna dëshmojnë efektivitetin e programit të studimit në përgatitjen e studentëve për tregun e punës.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së** | Nuk | **Përmbushet** | **Përmbushet** | **Përmbushet** |
|---|---|---|---|---|

| standardeve të fushës II | përmbushet | pjesërisht | kryesisht | plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

| **Standardi III.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminaret, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni. | Sipas Rregullorres së Institucionit, Rregullores së Njësisë Kryesore dhe Rregullores së programit të studimit, përcaktohen format e mësimdhënies. Ato janë leksionet, seminaret, praktikat profesionale, detyrat e kursit, laboratorët etj. Programi i studimit është i strukturuar duke përfshirë një gamë të gjerë metodash mësimdhënieje, si leksione, seminare, laboratorë, praktika profesionale dhe klinike, përgatitjen e detyrave të kursit, tema diplome, punë kërkimore në laborator, si dhe leksione të hapura të organizuara nga departamenti. Institucioni inkurajon gjithashtu pjesëmarrjen e studentëve në konferenca, trajnime dhe workshope, duke nxitur zhvillimin akademik dhe profesional të tyre.<br>Një komponent i rëndësishëm në organizimin e studimeve është edhe puna e pavarur e studentit, e cila përfshin 2291 orë nga një total prej 4500 orësh të programit. Nga këto, 2209 orë realizohen në auditor. |

| **Bachelor në Infermieri** | **Në total** |
|---|---|
| **Orë në auditor** | **2209 (49.1 %)** |
| • Leksione | 1106 |
| • Seminare | 223 |
| • Ushtrime | 117 |
| • Laboratore | 243 |
| • Praktika klinike | 520 |
| • Pregatitje e mikrotezës | 175 (jashtë auditorit) |
| **Punë e pavarur e** | **2291 (50.9 %)** |

| | | |
|---|---|---|
| | **studentit** | |
| | **Gjithsej** | **4500** |

Në këtë program parashikohen 14 lëndë viti i I, 17 lëndë viti i II, 18 lëndë viti i III (së bashku me praktikën dhe provimin përfundimtar), 49 provime. Plani mësimor është i ndarë në lëndë të detyrueshme dhe me zgjedhje, duke përcaktuar në mënyrë të qartë ndarjen e orëve për të gjitha format e mësimdhënies dhe mësimnxënies.

| **Viti Akademik** | **Semestri** | **Numri i Lëndëve** | **Totali për Vitin** |
|---|---|---|---|
| **Viti I** | Semestri I | 7 | **14** |
| | Semestri II | 7 | |
| **Viti II** | Semestri III | 8 | **17** |
| | Semestri IV | 9 | |
| **Viti III** | Semestri V | 8 | **18** |
| | Semestri VI | 10 | |
| **Totali i përgjithshëm** | | | **49** |

Kjo tabelë tregon numrin e lëndëve për secilin semestër dhe vit akademik.
Në syllabuset e lëndëve përcaktohen orët dhe format e mësimdhënies, të cilat janë konfirmuar edhe gjatë takimeve me stafin akademik, studentët dhe përfaqësuesit e sektorit të standardeve të cilësisë dhe kurrikulave. Këto tregojnë një qasje të strukturuar dhe të mirëpërcaktuar në organizimin e procesit mësimor.

**Evidenca:**
*Shtojca 2.7.1; Plani mësimor i programit të studimit 2022-2023*
*Shtojca 2.7.2; Plani mësimor i programit të studimit 2023-2024*
*Shtojca 2.7.3; Plani mësimor i programit të studimit 2024-2025*
*Shtojca 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset).*
*Takim me stafin akademik;*
*Takim me studentët;*
*Takim me përfaqsues të Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të*

| | |
|---|---|
| | *Cilësisë dhe Zyrën e Zhvillimit të Kurrikulave.* |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. | Personeli akademik përdor një gamë të gjerë metodash alternative të mësimdhënies për të siguruar zhvillimin e procesit mësimor në mënyrë sa më të përshtatshme për studentët. Metodat e përdorura përfshijnë PowerPoint, figura, video, bashkëbisedim, raste klinike dhe teknika të tjera, të cilat synojnë ta bëjnë mësimin më interesant dhe interaktiv. Këto metoda janë të konfirmuara nga studentët, të cilët i kanë vlerësuar ato si efektive në përmirësimin e angazhimit dhe kuptimit të materialeve mësimore.<br>Në periudhën e pandemisë, UK ka përdorur mësimdhënien online si një përvojë të re për të përballuar kushtet e imponuara. Megjithatë, kjo metodë nuk është më në përdorim aktualisht.<br>Në formimin teorik dhe praktik, një rol të rëndësishëm zënë leksionet, seminaret, punët laboratorike, praktikat profesionale, detyrat dhe projektet e kursit. Nga ana tjetër, stafi akademik organizon veprimtaritë mësimore në përputhje me nevojat e studentëve, duke ofruar mundësi dhe metoda të ndryshme për mësimdhënie dhe mësimnxënie që janë më të përshtatshme për ta. Kjo qasje fleksibël ndihmon në krijimin e një mjedisi të favorshëm për zhvillimin e aftësive profesionale dhe akademike të studentëve.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 5; Tabela Përmbledhëse për aneks RVB*<br>*Shtojca 4.8; Webfaqja e UK*<br>*Shtojca 4.9; Webfaqja e FSHNH*<br>*Shtojca 3.12.1; Biblioteka online J-store + U-library*<br>*Shtojca 2.4.1; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2021-2022.*<br>*Shtojca 2.4.2; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2022-2023.*<br>*Shtojca 2.4.3 Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2023-2024.*<br>*Takim me stafin akademik;*<br>*Takim me studentët.* |
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit. | Me qëllim përmirësimin e mësimdhënies, UK, organizon trajnime për stafin akademik. Trajnimet e personelit akademik zhvillohen mbi bazë nevojash. Në UK vazhdimisht ka trajnime me profesorët më të njohur ndërkombëtarisht ku stafi i FSHNH është i ftuar të marrë pjesë. Për më tepër, në kushtet kur stafi akademik është me tituj grada, si dhe organizon vetë trajnime në aktivitete e |

| | |
|---|---|
| | veprimtari të zhvilluara në UK apo institucione të tjera, trajnimi i stafit gjatë viteve të fundit është fokusuar në drejtim të kërkimit shkencor, hartimit dhe pjesëmarrjes në projekte. Në takimin me stafin akademik ata raportuan se Zyra e Kërkimit Shkencor ka marrë ekspert nga jashtë me qëllim zhvillimin e trajnimeve. Paralelisht, u dërgojnë thirrje për aplikime të ndryshme si dhe website. Çdo syllabus përmban të gjitha specifikimet e parashikuara në VKM. 41/2018, e ndryshuar, përfshirë format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe vlerësimit të njohurive.<br><br>***Evidenca:***<br>*Shtojca 2.4.1; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2021-2022.*<br>*Shtojca 2.4.2; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2022-2023.*<br>*Shtojca 2.4.3 Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2023-2024.*<br>*Shtojca 1.23; Rregullore e Drejtorisë së Projekteve dhe Kërkimit Shkencor*<br>*Shtojca 2.10.3; Lista e projekteve kombëtare dhe ndërkombëtare;*<br>*Shtojca 2.13.1; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2021-2022*<br>*Shtojca 2.13.2; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2022-2023*<br>*Shtojca 2.13.3; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2023-2024Takim me stafin akademik;*<br>*Njësinë e Sigurimit të Brendshtëm të Cilësisë;*<br>*Takim me përfaqsuesit e Komisionit për Kurrikulat dhe Mësimin* |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te studentet mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë | Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie disponon njohuritë dhe aftësitë e duhura për të siguruar një proces mësimor cilësor. Stafi akademik ka aftësi të forta didaktike, duke mundësuar shpjegimin e materialeve në mënyrën më të kuptueshme për studentët. Për të mbështetur procesin mësimor, UK ka siguruar marrëveshje që mundësojnë përdorimin e librarive online dhe botimeve shkencore të universitetit, duke ofruar një burim të pasur informacioni për stafin dhe studentët. Në bibliotekën online të fakultetit, studentët kanë mundësi të konsultojnë libra nga fusha të ndryshme të mjekësisë, të cilat ndihmojnë në thellimin e dijes dhe kërkimit shkencor. |

| | |
|---|---|
| Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | Studentët kanë raportuar se janë të kënaqur me mësimdhënien e zhvilluar nga stafi akademik, duke e vlerësuar mësimin si interesant dhe interaktiv. Personeli akademik përdor një gamë të gjerë metodash mësimdhënieje, përfshirë PowerPoint, figura, video, bashkëbisedim dhe raste klinike, për të bërë mësimin më tërheqës dhe angazhues për studentët. Këto metoda janë gjithashtu të konfirmuara nga studentët, të cilët i kanë vlerësuar ato pozitivisht.<br>Gjatë takimeve me autoritetet drejtuese dhe Burimet Njerëzore, u raportua se UK përpiqet të rekrutojë staf me eksperiencë të mjaftueshme në mësimdhënie. CV-të e pedagogëve tregojnë se ata kanë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për të realizuar një mësimdhënie cilësore. Po ashtu, UK organizon aktivitete trajnuese për përmirësimin e aftësive mësimdhënëse të stafit, duke siguruar kështu zhvillimin e vazhdueshëm të kapaciteteve profesionale të tij akademik.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 2.9; CV Jetëshkrimet e stafit akademik të përfshirë në programin e studimit.*<br>*Takim me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë;*<br>*Takim me stafin akademik;*<br>*Takim me studentët;*<br>*Takim me përfaqësues të Burimeve Njëerëzore.* |
| **Kriteri 5.** Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre. | Institucioni ka zhvilluar një procedurë standarde për vlerësimin e stafit akademik nga studentët, e cila përfshin pyetësorë të veçantë për lëndën dhe për institucionin. Kjo praktikë është një pjesë e rëndësishme e angazhimit të UK për të përfshirë studentët në përmirësimin e procesit mësimor. Stafi akademik ka raportuar se ata vlerësohen nga studentët dhe janë të informuar për rezultatet e vlerësimit në vijimësi. Studentët kanë konfirmuar se ata marrin pyetësorët përmes emailit dhe i plotësojnë ato, duke kontribuar kështu në procesin e përmirësimit të mësimdhënies. Kjo procedurë është gjithashtu e njohur dhe e konfirmuar nga përfaqësuesit e Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave.<br>Përveç vlerësimit nga studentët, stafi akademik vlerësohet gjithashtu nga Drejtuesi i Departamentit, një praktikë që është konfirmuar gjatë takimeve me stafin akademik. Ky vlerësim është pjesë e një procesi të rregullt që ndihmon në identifikimin e mundësive për përmirësim.<br>Departamenti rishikon dhe përmirëson metodat e mësimdhënies në |

| | |
|---|---|
| | mënyrë periodike, duke përfshirë mendimet dhe sugjerimet e studentëve. Ky reflektim mbi feedback-un e studentëve është një praktikë e rëndësishme që ndihmon në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies.<br>Pavarësisht specifikës së programit në fushën e mjekësisë, teknologjia ka luajtur një rol të rëndësishëm në përmirësimin e mësimdhënies dhe është aplikuar gjerësisht për të mbështetur procesin mësimor. Rezultatet e raportuara nga NJSBC në raportin vjetor tregojnë se studentët e gjykojnë tërheqës procesin mësimor dhe sfidues detyrat e pedagogëve. Rezultatet e pyetësorëve përdoren nga njësia kryesore për hartimin e politikave të përmirësimit të programit të studimit.<br>GVJ e konsideron këtë praktikë si një model të suksesshëm që UK duhet ta vazhdojë dhe ta zhvillojë më tej, duke e përdorur për të siguruar një përmirësim të vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe procesit edukativ në përgjithësi.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 3.8.1; Pyetësori i NJSBC pas sezonit në bashkëpunim me Këshillin Studentor*<br>*Shtojca 3.8.2; Relacion i të dhënave nga pyetësoret me studentët*<br>*Shtojca 3.8.3; Shembull vlerësimi të performancës së stafit akademik*<br>*Shtojca 3.6; Raporti vjetor i NJSBC FSHNH*<br>*Shtojca 3.7; Raporti Institucional i vlerësimit të brendshëm UK (relacion)*<br>*Takim me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë;*<br>*Takim me stafin akademik;*<br>*Takim me studentët;*<br>*Takim me përfaqsuesit e Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave.* |
| **Kriteri 6.** Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të | Institucioni ka krjuar struktura për të koordinuar dhe bashkëpunuar me njësitë kryesore akademike në përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies. Strukturat organizative mbështesin trajnimin dhe zhvillimin profesional të stafit akademik, duke ofruar mundësi për aftësim shkencor dhe përvojë në mësimdhënie. Për promovimin e aktiviteteteve , institucioni boton rregullisht Buletinin e UK dhe organizon konferenca dhe aktivitete akademike në bashkëpunim me partnerë kombëtarë dhe ndërkombëtarë.<br>Personeli akademik është trajnuar për aplikimin e metodave |

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel:+355 (04) 222-43423

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja. | bashkëkohore të mësimdhënies, përfshirë edhe platformat online. Arritjet e stafit vlerësohen dhe analizohen periodikisht në nivel departamenti dhe fakulteti. NJSBC ka krijuar protokolle për përgatitjen e pyetësorëve të vlerësimit, ndërsa pedagogët plotësojnë çdo vit skedën e vetëvlerësimit për arritjet shkencore.<br>Përveç vlerësimeve nga përgjegjësit e departamenteve, institucionit i shërben edhe Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Kurrikulave, e cila organizon aktivitete për zhvillimin akademik dhe përfshin ekspertë të jashtëm për rritjen e cilësisë dhe përmirësimin e kurrikulave.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 1.5; Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional*<br>*Shtojca 3.10; Lista e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë (NJSBC)*<br>*Takim me përfaqësuesit e Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave.* | | | |
| **Konkluzione** | *Format e mësimdhënies janë leksionet, seminaret, praktikat profesionale, detyrat e kursit, laboratorët etj. Personeli akademik përdor mënyra alternative të mësimdhënies me qëllim zhvillimin dhe bërjen e tij sa më interaktiv për studentët. Stafi akademik raportoi se përdor mënyra të ndryshme gjatë mësimdhënies si PowerPoint, imazhe, video, bashkëbisedime, raste klinike etj. me qëllim mësimi të jetë interesant dhe interaktiv. Me qëllim përmirësimin e mësimdhënies, UK, organizon trajnime për stafin akademik, mbi bazë nevojash. Në UK vazhdimisht ka trajnime me profesorët më të njohur ndërkombëtarisht. Gjithashtu, institucioni ka marrë ekspert nga jashtë me qëllim zhvillimin e trajnimeve në drejtim të kërkimit shkencor, hartimit dhe pjesëmarrjes në projekte. Institucioni ka hartuar pyetësorë për vlerësimin e stafit akademik nga studentët.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| | |
|---|---|
| **Standardi III.2**<br>**Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |

<table>
<tr>
<td>Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</td>
<td>Institucioni ka një bazë ligjore të plotë që rregullon organizimin e provimeve dhe vlerësimin e njohurive të studentëve, të cilat janë të njohura dhe të disponueshme për studentët që në fillim të vitit akademik. Rregullorja e programit të studimit dhe rregulloret e përgjithshme të institucionit përcaktojnë qartë modalitetet e testimit të njohurive. Në syllabuset e lëndëve pasqyrohen format e kontrollit të njohurive.<br>
Për disa vjet, Departamenti i Infermierisë përdor sistemin automatizuar CLEANSCORE për korrigjimin e provimeve, i financuar nga AADF. Sipas Nenit 63 të Rregullores së institucionit, Rregullorja e Njësisë Kryesore dhe Rregullorja e Programit pika 13 të studimit përcaktojnë kriteret dhe metodat e testimit dhe vlerësimit të njohurive.<br>
Vlerësimi i studentëve bazohet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, ku nota përfundimtare është një kombinim i elementëve të mëposhtëm:<br>
1. Provimi përfundimtar 70 %<br>
2. Vlerësimi i vazhduar 30 %<br>
- Ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive 10%<br>
- Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit) 5 – 10 %<br>
- Testimet gjatë vitit 10 – 15 %
<table>
<tr><th>Format e kontrollit të njohurive</th><th>Programi i Studimit Bachelor në INFERMIERI</th></tr>
<tr><td>Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive</td><td>10%</td></tr>
<tr><td>Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit)</td><td>5 – 10%</td></tr>
<tr><td>Testimet gjatë vitit</td><td>10 – 15%</td></tr>
<tr><td>Provimi përfundimtar</td><td>70%</td></tr>
<tr><td>Në total</td><td>100%</td></tr>
</table>
Vlerësimi i tezës është pjesë e vlerësimit përfundimtar, që bëhet pas korrigjimit të provimit dhe pas grumbullimit të rezultateve nga aktivitetet gjatë semestrit (seminare, laboratore, provime të ndërmjetëm). Në sezonet e riprovimeve, vlerësimi bëhet vetëm me tezë 100 pikëshe dhe rezultatet e vitit anulohen ose zerohen. Vlerësimi përfundimtar mund të ndryshohet vetëm me rifutjen për përmirësim.<br>
Vlerësimi përfiton nga sistemi me notë (4-10), pikë ose përqindje</td>
</tr>
</table>

| | |
|---|---|
| | (100 pikë/100%), dhe është i detajuar në syllabuset përkatëse të lëndëve. Ky proces është konfirmuar nga stafi akademik dhe studentët.<br>Programi i studimit bachelor Infermieri ka të përcaktuara qartë të gjitha veprimtaritë formuese dhe vlerësuese. Rregullorja e programit, dosja e tij, syllabuset dhe procedurat përkatëse përcaktojnë qartë aspektet e organizimit dhe zhvillimit të mësimdhënies. Personeli akademik ka të drejtën të rishikojë metodat e vlerësimit, duke i harmonizuar ato me rregulloren e programit të studimit.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë*<br>*Shtojca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë*<br>*Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2022-2023*<br>*Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2023-2024*<br>*Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2024-2025*<br>*Shtojca 2.3; Rregullore e njësisë bazë "Departamenti i Infermierisë";*<br>*Shtojca 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH*<br>*Shtojca 2.18; Kontrata AADF me UK*<br>*Shtojca 2.18.2; Model testimi clean score* |
| **Kriteri 2.** Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të +parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Në fillim të çdo moduli, pedagogu informon studentët mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive, informacion që është gjithashtu i dokumentuar në syllabuset përkatëse të lëndëve. Ky informacion është konfirmuar si nga stafi akademik, ashtu edhe nga studentët gjatë takimeve. Procedura e vlerësimit është e qartë dhe transparente, dhe studentët janë të informuar për detyrimet që kanë në përfundim të lëndës/modulit. Koordinatori i programit të studimit, si dhe studentët koordinatorë të programit, janë përgjegjës për informacionin shtesë, duke diskutuar me studentët edhe forma të tjera testimi dhe vlerësimi, të cilat para se të aplikohen miratohen në departamentet përkatëse. Të gjitha këto informacione janë të aksesueshme për studentët përmes programit të studimit, faqes zyrtare të internetit, rrjeteve sociale dhe stendave të FSHNH. Frekuentimi i seancave të ndryshme të procesit mësimor është i ndarë si vijon: leksionet janë fakultative, ndërsa |

| | |
|---|---|
| | seminaret, ushtrimet, laboratorët, praktikat dhe praktikat klinike janë të detyrueshme me një frekuentim minimal prej 75%. Frekuentimi i proçesit mësimor është si vijon:<br>• Frekuentimi në seancat e leksioneve është **fakultativ**.<br>• Frekuentimi në seancat e seminareve është **i detyrueshëm në masën 75 %**..<br>• Frekuentimi në seancat e ushtrimeve është **i detyrueshëm në masën 75 %**..<br>• Frekuentimi në seancat e laboratoreve është **i detyrueshëm në masën 75 %**.<br>• Frekuentimi në seancat e praktikave është **i detyrueshëm në masën 75 %**.<br>• Frekuentimi në seancat e praktikave klinike është **i detyrueshëm në masën 75 %**.<br>Në rregulloren e Departamentit të Infermierisë, përcaktohen qartë format e kontrollit të dijeve, sistemi i vlerësimit për lëndë dhe module, si dhe sezonet e provimeve. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohen kushtet për të hyrë në provim, mënyra e zhvillimit të provimeve dhe vlerësimit, kushtet kur studenti konsiderohet i kalueshëm ose i mbetur, dokumentimi i rezultateve dhe procedurat për ankimim, riprovime dhe përmirësim. Ky sistem vlerësimi është i strukturuar dhe i përshtatshëm për të siguruar transparencë dhe drejtësi në procesin e vlerësimit të njohurive.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2022-2023*<br>*Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2023-2024*<br>*Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2024-2025*<br>*Shtojca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë*<br>*Shtojca 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH*<br>*Takim me stafin akademik;*<br>*Takim me studentët.* |
| **Kriteri 3.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore | Sipas Kreut IV të Rregullores së Njësisë Kryesore dhe sipas pikës 16 të Rregullores së programit të studimit, kontrolli i dijes së një lënde bëhet me cikle (module dhe provime). Kontrolli i dijes, si |

| | |
|---|---|
| realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. | rregull, bëhet me dorëzim projektesh, detyrash, me provim me shkrim, me gojë, me praktikë ose i kombinuar me shkrim dhe me gojë. Në detyrimet e studentit përfshihen si lëndët e detyrueshme dhe ato fakultative: zgjedhja e lëndëve fakultative është në pëlqimin e studentit. Njohuritë e përfituara nga studenti, mund të kontrollohen dhe të vlerësohen përmes një kombinimi të frekuentimit dhe aktivizimit të studentit gjatë orëve të mësimit në auditor, provimeve me shkrim, detyrave të kursit, punëve laboratorike dhe provimit me gojë. Vlerësimi në përfundim të secilës lëndë bëhet me pikë (nga 0-100 pikë) dhe rezultati përfundimtar konvertohet me sistemin kombëtar të vlerësimit me notë, i cili është nga 4 - 10 ku 4 është notë jo kaluese dhe 10 është vlerësimi maksimal për njohuritë e përfituara si dhe shprehet me gërma nga A deri në E sipas sistemit të vlerësimit ECTS me notë. Provimi përfundimtar është me shkrim i bazuar në një set pyetjesh të cilat janë përzgjedhur nga komisioni i diplomës. Në syllabusin e çdo lënde përcaktohen dhe disiplinohen format e ndryshme të kontrollit të njohurive të cilat zhvillohen sipas afateve të caktuara në kalendarin akademik, të bëra publike nga Departamenti përkatës dhe që janë të detyrueshme për zbatim, si nga pedagoget ashtu dhe nga studentët.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2022-2023*<br>*Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2023-2024*<br>*Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2024-2025*<br>*Shtojca 2.18; Kontrata AADF me UK*<br>*Shtojca 2.18.2; Model testimi clean score*<br>*Shtojca 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset).*<br>*Takim me stafin akademik;*<br>*Takim me studentët.* |
| **Kriteri 4.** Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë | Stafi akademik përpiqet të përmirësojë vazhdimisht format dhe metodat e mësimdhënies, duke përfshirë në këtë proces edhe studentët e programit të studimit. Sipas raportimeve të stafit akademik, gjatë mësimdhënies përdoren metoda të ndryshme, si prezantime me PowerPoint, figura, video, bashkëbisedime, analiza |

| | |
|---|---|
| periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre. | të rasteve klinike etj., me qëllim që mësimi të jetë sa më interesant dhe interaktiv.<br>Studentët kanë konfirmuar se vlerësojnë përpjekjet e stafit akademik. Ata marrin një pyetësor me email, të cilin e plotësojnë për të dhënë opinionet e tyre mbi cilësinë e mësimdhënies. Kjo procedurë është raportuar edhe nga përfaqësuesit e Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave. Përveç kësaj, performanca e stafit akademik vlerësohet edhe nga Drejtuesi i Departamentit, siç u konfirmua edhe në takimin me stafin akademik.<br>Personeli akademik është gjithmonë i hapur ndaj aplikimit të metodave alternative të mësimdhënies dhe mësimnxënies, duke i përshtatur ato me fushën dhe natyrën e programit të studimit, si dhe me modulet dhe aktivitetet formuese specifike. Eksperienca e gjatë e stafit akademik ndërthuret me atë të personelit të ri, duke siguruar kështu ruajtjen e traditës së krijuar dhe, njëkohësisht, implementimin e metodave bashkëkohore të mësimdhënies.<br>Përmes trajnimeve, pjesëmarrjes në projekte dhe reflektimit mbi sugjerimet e studentëve, stafi akademik përmirëson vazhdimisht procesin e mësimdhënies. Duke vendosur studentin në qendër, synohet zhvillimi i një qasjeje mësimore të bazuar në kompetenca, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe efiçiencës në mësimdhënie.<br><br>*GVJ e konsideron këtë një praktikë të mirë që UK duhet të vazhdojë ta ndjekë.*<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset).*<br>*Shtojca 4.8; Webfaqja e UK*<br>*Shtojca 4.9; Webfaqja e FSHNH*<br>*Shtojca 3.8.1; Pyetësori i NJSBC pas sezonit në bashkëpunim me Këshillin Studentor*<br>*Shtojca 3.8.2; Relacion i të dhënave nga pyetësoret me studentët*<br>*Takim me stafin akademik;*<br>*Takim me studentët;*<br>*Takim me përfaqsuesit e Sektorit të Standardeve të Cilësisë dhe Kurrikulave.* |
| **Kriteri 5.** Institucioni mundëson përdorimin e | Autonomia dhe liria akademike është një pikë kryesore të cilën e gëzojnë stafi akademik dhe studentët. Institucioni ka integruar një |

| | |
|---|---|
| metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studenti, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre. | qasje pedagogjike të shumëllojshme dhe fleksibël në programin e studimit të Infermierisë, duke përfshirë metoda inovative të mësimdhënies që i përshtaten nevojave të studentëve dhe kërkesave të tregut të punës. Kombinimi i leksioneve teorike me punën praktike në laboratorë dhe institucione shëndetësore u mundëson studentëve të fitojnë njohuri të thelluara dhe aftësi të aplikueshme në praktikë. Metodat e mësimdhënies përfshijnë mësimin interaktiv, studime të rasteve, simulime praktike dhe projekte të pavarura, duke nxitur autonominë e studentëve dhe përgatitjen e tyre për situata reale në fushën e kujdesit shëndetësor. Studentët gëzojnë lirinë për të shprehur mendimet dhe idetë e tyre gjatë leksioneve dhe seminareve, duke krijuar një mjedis të favorshëm për mësim dhe bashkëpunim mes stafit akademik dhe studentëve. Në përfundim të secilit modul, zhvillohet provimi përkatës, ndërsa shfrytëzimi i infrastrukturës së FSHNH dhe shërbimeve shëndetësore ndihmon në praktikimin e studentëve me raste klinike në pacientë realë. Plani mësimor përcakton qartë edhe orët e studimit individual, duke siguruar një balancë mes mësimit të udhëhequr dhe atij të pavarur.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë*<br>*Shtojca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë*<br>*Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2022-2023*<br>*Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2023-2024*<br>*Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2024-2025*<br>*4.6 Tabelë përmbledhëse e kapaciteteve infrastrukturore dhe laboratorike .pdf.pdf*<br>*Takim me stafin akademik;*<br>*Takim me studentët.* |
| **Konkluzione** | *Në rregulloren e Programit të studimit raportohet se vlerësimi i përgatitjes së studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm, ku nota përfundimtare është një kombinim i provimit përfundimtar (70%) dhe vlerësimit të vazhdueshëm (30%), përfshirë ndjekjen e lëndës dhe pjesëmarrjen aktive (10%), plotësimin e detyrimeve (5-10%), testimet gjatë vitit (10-15%).* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *Studentët orën e parë të lëndës informohen nga pedagogu respektiv mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive. Kontrolli i dijes, si rregull, bëhet me dorëzim projektesh, detyrash, me provim me shkrim, me gojë, me praktikë ose i kombinuar me shkrim dhe me gojë. Stafi akademik mundohet të përmirësojë rregullisht format dhe metodat e mësimdhënies. Në këtë process përfshihen dhe studentët e këtij programi studimi. Stafi akademik raportoi se përdor mënyra të ndryshme gjatë mësimdhënies si PowerPoint, figura, video, bashkëbisedim, raste klinike etj. me qëllim mësimi të jetë interesant dhe interaktiv. Studentët konfirmuan që vlersojnë stafin akademik.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| **Standardi III.3**<br>**Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/ moduleve nga titullari i lëndës/modulit. | Sipas kapitullit 13 të Rregullores së Njësisë Kryesore kontrolli i dijes së një lënde bëhet me cikle (module dhe provime), pra vlerësimi i përgatitjes së studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshem dhe në syllabuse raportohet se nota përfundimtare është rezultat i kombinimit të elementëve të mëposhtëm:<br>Provimi përfundimtar 70 %<br>Vlerësimi i vazhduar 30 %<br>Ndjekja e lëndës dhe pjesmarrja aktive 10%<br>Plotësimi i detyrimeve (laboratorike, detyrave të kursit) 5 – 10 %<br>Testimet gjatë vitit 10 – 15 %<br>Të gjitha mënyrat dhe elementet e vlerësimit janë të parashikuara në syllabuse dhe rregullore, të cilat prezantohen edhe nga titullari i lëndës. Format e testimit të njohurive janë për aktivizime në seminare, praktika, dorëzim projektesh, detyrash, testime të pjesshme dhe provimi final. Perveç njoftimit ne javën e parë nga secili titullarë lënde, këto metoda përsëriten dhe shpjegohen për studentët edhe gjatë vitit. Provimi përfundimtar organizohet në varësi të specifikave të lëndës dhe në bashkëpunim me komisionin e provimit.<br>Provimi përfundimtar mund të jetë me shkrim. |

| | |
|---|---|
| | Të gjitha këto informacione, studenti mund ti marrë në forma të ndryshme, nëpërmjet programit të studimit, informacionit të publikuar në faqen e internetit dhe në rrjetet sociale, në stendat e FSHNH.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë*<br>*Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2022-2023*<br>*Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2024-2025*<br>*Shtojca 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH*<br>*Shtojca 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset).*<br>*Shtojca 4.8; Webfaqja e UK*<br>*Shtojca 4.9; Webfaqja e FSHNH* |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën. | Institucioni prej disa vitesh ka vënë në përdorim platformën e korrigjimit të provimeve Clean Score në bashkëpunim me AADF. Projekti zbatohet prej disa vitesh në institucione publike dhe jo-publike të arsimit të lartë. Me qëllim që vlerësimi të jetë i drejtë dhe i paanshëm, në të gjitha provimet e programit Bachelor në "Infermieri" përdoret korrigjimi i tezave me sistemin Clean-score. Rezultatet jepen në kohë reale, ndërsa notat publikohen brenda afateve të përcaktuara nga rregullorja përmes sistemit Pitagora.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 1.6 Marrëveshja me rash për sistemin elektronik pitagora.pdf.*<br>*Shtojca 1.6.1 Manual i sistemit elektronik pitagora.pdf.*<br>*Shtojca 2.18; Kontrata AADF me UK*<br>*Shtojca 2.18.2; Model testimi clean score* |
| **Kriteri 3.** Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. | Testimi përfundimtar i lëndës realizohet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi, dhe mund të jetë i shkruar, me gojë ose i kombinuar, në varësi të lëndës. Provimi është i mbikëqyrur nga një komision i përbërë nga dy pedagogë, të cilët janë të pranishëm gjatë zhvillimit të tij, në përputhje me numrin e studentëve dhe sallën në dispozicion. Teza e provimit hartohet nga pedagogu që ka zhvilluar leksionet, kontrollohet nga titullari i lëndës dhe miratohet nga përgjegjësi i departamentit.<br>Në syllabuset e lëndëve janë përcaktuar detyrimet e studentëve, |

| | |
|---|---|
| | duke përfshirë mënyrën e vlerësimit të vazhduar, raportet e vlerësimit, detyrat e kursit, laboratorët dhe frekuentimin. Studentët informohen gjithashtu për temat që do të mbulohen në provim, formatin e pyetjeve dhe materialet që do të përdoren gjatë lëndës.<br>GVJ u njoh me formatin e fletës së provimit dhe procedurën e ndjekur për hartimin, korrigjimin dhe vlerësimin përfundimtar.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë*<br>*Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2022-2023*<br>*Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2023-2024*<br>*Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2024-2025*<br>*Shtojca 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset).*<br>*Shtojca 2.18; Kontrata AADF me UK*<br>*Shtojca 2.18.2; Model testimi clean score* |
| **Kriteri 4.** Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. | Studenti hyn në provim pasi ka kryer detyrimet e proçesit mësimor për çdo lënde dhe detyrimet financiare sipas kontratës që ka me institucionin. Në rregulloren e programit të stdimit përcaktohen qartë detyrimet që lidhen jo vetëm me ndjekjen e proçesit mësimor por dhe me numrin e ECTS-ve teoriko-praktike dhe llojin e lëndëve që studenti duhet të ketë të plotësuara para futjes në një sezon provimi. Kur provimi kryhet me gojë vlerësimi shoqërohet me komente dhe këshillime të studentit për performancën e arritur në provim. Ndërsa në provimet me shkrim komentet dhe sugjerimet kryhen në seancën e komunikimit të rezultateve. Në këto seanca pedagogu i mundëson studentit, nëse dëshiron, të shikojë rezultatet e provimit, bazuar në Rregulloren e UK, Rregulloren e FSHNH dhe Rregulloren e Programit të studimit. Në përfundimin e provimeve, studentët informohen për rezultatet e provimit në sistemin Pitagora.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 1.6.1 Manual i sistemit elektronik pitagora.pdf.pdf*<br>*Shtojca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë*<br>*Shtojca 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë* |

| | |
|---|---|
| | *Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH*<br>*Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2022-2023*<br>*Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2023-2024*<br>*Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2024-2025* |
| **Kriteri 5.** Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra. | Sjelljet akademike joetike, përfshirë përdorimin e materialeve të palejuara gjatë provimeve, kopjimin dhe plagjiaturën, janë të ndaluara. Rregullat dhe standardet e integritetit akademik janë të përcaktuara qartë në syllabuset e çdo lënde, përmes referencës ndaj Kodit të Etikës së institucionit, i cili përshkruan në mënyrë të detajuar sjelljet e papranueshme dhe pasojat përkatëse. Komisioni i provimeve siguron transparencë maksimale dhe nuk lejon asnjë abuzim nga studentët, duke parandaluar kopjimin dhe çdo formë tjetër që mund të deformojë vlerësimin e drejtë që secili student meriton. Për punimet e detyrave të kursit dhe diplomave, aplikohen verifikime nëpërmjet programeve antiplagjiaturë.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset).*<br>*Shtojca 1.19; Rregullore e Këshillit të Etikës UK*<br>*Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2022-2023*<br>*Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2023-2024*<br>*Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2024-2025* |
| **Kriteri 6.** Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse. | Studentët informohen mbi rezultatet e provimeve brenda afateve ligjore të përcaktuara nga Rregullorja e programit të studimit. Korrigjimi i provimeve bëhet me sistemin Clean-score, i cili kodifikon automatikisht rezultatet 30-60 minuta pas mbarimit të provimit. Rezultatet publikohen menjëherë online në faqen përkatëse https://cleanscore.al/arkiva. ***Kjo është një procedurë shumë e rëndësishme dhe një pikë e fortë e këtij programi studimi.***<br>Korrigjimi i provimit me shkrim bëhet nga komisioni i provimeve, dhe rezultatet u bëhen të njohura studentëve brenda afatit të përcaktuar. Komisioni cakton një ditë për dhënien e rezultateve dhe shqyrtimin e ankesave lidhur me vlerësimin. Studentët |

| | |
|---|---|
| | shprehen të kënaqur me procedurën e vlerësimit dhe kanë deklaruar se vlerësimi është i drejtë dhe në përputhje me rregulloren e provimeve.<br>Rezultatet e provimeve u komunikohen studentëve në mënyrë konfidenciale përmes llogarisë së tyre personale në sistemin Pitagora. Studentët kanë të drejtën e ankimimit, i cili parashikohet dhe rregullohet nga rregullorja, dhe shqyrtohet nga komisioni përkatës i ngritur nga njësia përgjegjëse. Procesi mbyllet me dorëzimin e fletës së notave në sekretari. Gjithashtu, studenti ka të drejtën të kërkojë rishikimin e notës.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 2.18; Kontrata AADF me UK*<br>*Shtojca 2.18.2; Model testimi clean score*<br>*Shtojca 1.6.1 Manual i sistemit elektronik pitagora.pdf.*<br>*Takim me studentët.* |
| **Kriteri 7.** Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit. | Studentët gëzojnë të drejtën të informohen mbi rezultatet e vlerësimit dhe të njihen me gabimet e bëra gjatë provimit. Në rast mosdakordësie me vlerësimin, atyre u ofrohet mundësia për të paraqitur ankesë apo për të kontestuar rezultatin. Po ashtu, studentët kanë të drejtë të informohen mbi shpërndarjen e pikëve në tezë, në përputhje me përcaktimet e nenit 85 të Rregullores së UK.<br>Në rast se janë shkelur rregullat proceduriale gjatë zhvillimit të provimit ose nëse ndjehen të vlerësuar padrejtësisht, studentët mund të ankohen. Ankesa duhet të bëhet me shkrim brenda ditës së marrjes së rezultatit për provimin me gojë dhe jo më vonë se 8 ditë pas dhënies së rezultatit për provimin me shkrim. Ankesa duhet të drejtohet tek Dekani i Fakultetit, i cili vlerëson nëse ankesa është e drejtë dhe ia përcjell për shqyrtim departamentit përkatës.<br>Kjo e drejtë për ankesa është e parashikuar në rregulloret e institucionit dhe të programit të studimit, duke mundësuar që studenti të njihet me vlerësimin, të ankimohet për të dhe të mund të përmirësojë notën përmes riprovimit.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë*<br>*Shtojca 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH*<br>*Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri"* |

| | |
|---|---|
| | *2022-2023*<br>*Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2023-2024*<br>*Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2024-2025*<br>*Shtojca 1.6.1 Manual i sistemit elektronik pitagora.pdf.* |
| **Kriteri 8.** Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet. | Sipas nenit 83 të Rregullorës së UK, çdo ankimim për vlerësim shqyrtohet pasi kalon nga përgjegjësi i departamentit dhe dërgohet te Dekani i Fakultetit. Dekani, me propozim nga Përgjegjësi i Departamentit, vendos për ndryshimin e komisionit të provimit dhe mund të caktojë ridhënien e provimit brenda ditës ose të nesërmen pas përfundimit të tij.<br>Komisioni i provimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë, duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara të studentit me tezën e zgjidhur. Nëse studenti nuk është i kënaqur me sqarimin e komisionit, ai ka të drejtën të kërkojë rishikim të testit nga një komision tjetër, i cili ngrihet me propozim të përgjegjësit të departamentit dhe miratohet nga Dekani i Fakultetit, pasi analizon pretendimet dhe argumentet e studentit.<br>Pas këtij afati, nota konsiderohet përfundimtare dhe komisioni është i detyruar të bëjë mbylljen përfundimtare të procesverbalit në sistem dhe në sekretarinë mësimore.<br>Studentit i vihet në dispozicion rregullorja e programit të studimit, e cila përshkruan procedurën e ankimimit. Për çdo sqarim të mëtejshëm, studenti mund t'i drejtohet koordinatorit të programit ose përgjegjësit të departamentit deri në sqarimin e çdo problematike që mund të ketë.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë*<br>*Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2022-2023*<br>*Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2023-2024*<br>*Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2024-2025*<br>*Shtojca 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH* |
| **Konkluzione** | *Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe proçesin e ankimimit.* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Mënyra e vlerësimit është e parashikuar në syllabuset e lëndeve/moduleve. Testimi përfundimtar i lëndës realizohet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi. Provimi realizohet me shkrim, me gojë ose i kombinuar. Studentët kanë të drejtën e ankimimit të rezultatit nëse kanë pakënaqësi apo paqartësi të lidhura me vlerësimin. Kjo e drejtë sanksionohet në rregulloret e institucionit dhe të programit të studimit. Vlerësimi bazohet në meritë. FSHNH ka krijuar mekanizma për të luftuar plagjiaturën dhe kopjimin në provime.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi III.4**<br>**Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve. | Programi i studimit Bachelor në "Infermieri e Përgjithshme" synon të thellojë njohuritë dhe të zhvillojë aftësitë profesionale të studentëve. Ky program ka një kohëzgjatje prej 3 vite akademike (6 semestra) dhe një ngarkesë prej 180 ECTS. Çdo semestër përbëhet nga 15 javë mësimore, ndërsa një orë mësimore zgjat 50 minuta.<br>Sistemi i krediteve (ECTS) parashikon që 1 ECTS të përfaqësojë 25 orë pune studentore, duke përfshirë leksionet, seminaret dhe studimin e pavarur, ku më shumë se 50% e ngarkesës së çdo krediti përbëhet nga puna e pavarur e studentit.<br><br>**Në vitin e parë të studimit programi ofron lëndë të karakterit të përgjithshëm:** |

| | |
|---|---|
| Etikë-Deontologji-Legjislacion | A |
| Shëndet publik-Higjenë | A |
| Bazat e infermieristikës 1/1 | A |
| Bazat e infermieristikës 1/2 | A |
| Psikologji-Sociologji | A |
| Fiziologji | B |
| Mikrobiologji | B |
| Anatomi normale | B |
| Histologji-embriologji-gjenetikë | B |

| | |
|---|---|
| Terminologji mjekësore | D |
| Biofizikë dhe biokimi mjeksore | D |
| Gjuhë angleze | D |
| Informatikë | D |
| Praktikë 1 | D |

**Në vitin e dytë programi përmban këto lëndë:**

| | |
|---|---|
| Farmakologji | A |
| Anatomi patologjike | A |
| Sëmundje e brendshme 2 | B |
| Kujdes infermieror sëmundje e brendshme 2 | B |
| Kirurgji e përgjithshme | B |
| Kujdes infermieror kirurgji e përgjithshme | B |
| Shëndet mendor dhe Neurologji | B |
| Kujdes infermieror shëndet mendor dhe neurologjik | B |
| Pediatri 2 | B |
| Kujdes infermieror pediatrik 2 | B |
| Anestezi-reanimacion | C |
| Urgjenca infermierore | C |
| Metodologji kërkimi në kujdesin shëndetsor | C |
| Dietologji | C |
| Radiologji-imazhëri // Ekonomi shëndeti | C |
| Statistikë mjekësore | D |

**Në vitin e tretë programi ofron këto lëndë:**

| | |
|---|---|
| Pediatri 3 | B |
| Kujdes infermieror pediatrik 3 | B |
| Sëmundje e brendshme 3 | B |
| Kujdes infermieror sëmundje e brendshme 3 | B |
| Kirurgji speciale | B |
| Kujdes infermieror kirurgji speciale | B |
| Obstetrikë-gjinekologji | B |
| Kujdes infermieror obstetrikë- | B |

<table>
<tr>
<td></td>
<td>
<table>
<tr><td>gjinekologji</td><td></td></tr>
<tr><td>Geriatri-gerontologji</td><td>B</td></tr>
<tr><td>Kujdes infermieror geriatrik-gerontologjik</td><td>B</td></tr>
<tr><td>Sëmundje infektive</td><td>C</td></tr>
<tr><td>Kujdes infermieror sëmundje infektive</td><td>C</td></tr>
<tr><td>Kujdes paliativ</td><td>C</td></tr>
<tr><td>ORL-okulistikë// Dermatologji// Kujdes infermieror njohuri speciale</td><td>C</td></tr>
<tr><td>Fizioterapi// Onkologji// Logopedi</td><td>C</td></tr>
</table>
Proçesi mësimor zhvillohet nëpërmjet një kombinimi orarësh teorike dhe praktike, duke përfshirë leksione, seminare, praktika laboratorike, detyra kursi, prezantime, si dhe praktika mësimore klinike dhe profesionale. Ky angazhim i shumëfishtë kontribuon në formimin e gjithanshëm të studentëve dhe i ofron ata njohuri të thelluara për studimin e patologjive.<br><br>
Evidenca:<br>
Shtojca 2.7.1; Plani mësimor i programit të studimit 2022-2023<br>
Shtojca 2.7.2; Plani mësimor i programit të studimit 2023-2024<br>
Shtojca 2.7.3; Plani mësimor i programit të studimit 2024-2025<br>
Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2022-2023<br>
Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2023-2024<br>
Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2024-2025<br>
Shtojca 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset).
</td>
</tr>
<tr>
<td>Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.</td>
<td>Ky program studimi është i fokusuar në përgatitjen e infermierëve për tregun e punës, duke i aftësuar ata për të ofruar kujdes cilësor ndaj pacientëve të të gjitha moshave dhe në fusha të ndryshme të kujdesit shëndetësor. Ai synon të kontribuojë në përmirësimin e shëndetit të individëve dhe komunitetit përmes një qasjeje profesionale dhe gjithëpërfshirëse në infermieri. Pothuajse të gjitha procedurat e përfitimit të imazheve mjekësore realizohen tashmë nga pajisjet mjekësore të integruara me teknologjinë e informacionit. Për këtë arsye, programi i studimit është orientuar drejt përdorimit të kësaj technologie në lëndë dhe module të ndryshme. Syllabuset e lëndëve/modulave paraqesin përmbajtjen e</td>
</tr>
</table>

| | |
|---|---|
| | tyre, ndarjen sipas aktiviteteve formuese, kreditet dhe orët përkatëse. Objektivat, aftësitë dhe kompetencat janë të paraqitura jo vetëm në përmbajtjen e programit të studimit, por gjithashtu në çdo syllabus të lëndës. Programi Bachelor në "Infermieri" përfshin lëndë si teknologjia e informacionit, etikë dhe deontologji, legjislacion, dhe statistikë mjekësore, të cilat zhvillojnë aftësi të veçanta te studentët në fushat e teknologjisë së informacionit, shkencave humane, sociale dhe të komunikimit.<br>Lëndë ndërdisiplinore si: radiologjia dhe imazheria, ekonomia e shëndetit, shëndeti mendor, fizioterapia, onkologjia dhe kujdesi infermieror në kirurgji, përfshihen në programin e studimit si lëndë me zgjedhje.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 2.7.1; Plani mësimor i programit të studimit 2022-2023*<br>*Shtojca 2.7.2; Plani mësimor i programit të studimit 2023-2024*<br>*Shtojca 2.7.3; Plani mësimor i programit të studimit 2024-2025*<br>*Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2022-2023*<br>*Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2023-2024*<br>*Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2024-2025*<br>*Shtojca 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset).* |
| **Kriteri 3.** Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse. | Në fund të lëndës, pedagogët informojnë dhe orjentojnë studentët për çështjet më të rëndësishme. Stafi akademik raportoi se zhvillon konsultime me studentët në orën e fundit të lëndës. Në javën e fundit të semestrit studentët orientohen në lidhje me strukturën dhe natyrën e pyetjeve që do të ketë provimi final dhe gjithashtu edhe për peshën që do të ketë në notën finale të modulit provimi final. Personeli akademik i angazhuar në programin e studimit bachelor "Infermieri" integron të rejat më të fundit të shkencës dhe teknologjisë së informacionit që ju jepet studentëve gjatë orarit normal të zhvillimit të modulit dhe jashtë tij kur është e nevojshme. Në fund të praktikës klinike dhe profesionale pedagogu analizon dhe vlerëson aftësitë profesionale të fituara nga studentët.<br>Institucioni ka hartuar një raport vjetor, që plotëson stafin akademik në fund të semestrit dhe ku specifikohen objektivat e arritura, literatura e përdorur, frekuentimi, realizimi i programit etj. ***Kjo është një procedurë shumë e rëndësishme dhe GVJ e*** |

<table>
<tr>
<td></td>
<td>konsideron si pikë të fortë. Studentët raportuan se zhvillojnë konsultime me pedagogët.<br><br>Evidenca:<br>Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2022-2023<br>Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2023-2024<br>Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2024-2025<br>Shtojca 2.7.1; Plani mësimor i programit të studimit 2022-2023<br>Shtojca 2.7.2; Plani mësimor i programit të studimit 2023-2024<br>Shtojca 2.7.3; Plani mësimor i programit të studimit 2024-2025<br>Shtojca 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset).<br>Takim me stafin akademik;<br>Takim me studentët.</td>
</tr>
<tr>
<td>Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.</td>
<td>Gjatë programit të studimit, studentët përfitojnë njohuri dhe kompetenca. Ata zhvillojën orë seminare, orë laboratorike dhe praktika të ndara sipas tabelës së mëposhtme:
<table>
<tr><th>Bachelor në Infermieri</th><th>Në total</th></tr>
<tr><td>Orë në auditor</td><td>2209 (49.1 %)</td></tr>
<tr><td>• Leksione</td><td>1106</td></tr>
<tr><td>• Seminare</td><td>223</td></tr>
<tr><td>• Ushtrime</td><td>117</td></tr>
<tr><td>• Laboratore</td><td>243</td></tr>
<tr><td>• Praktika klinike</td><td>520</td></tr>
<tr><td>• Pregatitje e mikrotezës</td><td>175 (jashtë auditorit)</td></tr>
<tr><td>Punë e pavarur e studentit</td><td>2291 (50.9 %)</td></tr>
<tr><td>Gjithsej</td><td>4500</td></tr>
</table>
Gjatë orëve të mësimit, me qëllim rritjen e aftësive dhe kompetencave të studentëve, zhvillohen diskutime, punë në grup, studime rasti, dhe stimulimi i mendimit kritik. Pedagogët mundohen të krijojnë një klimë pozitive duke dhënë shembuj dhe raste konkrete nga puna e tyre klinike. Angazhimi i personelit akademik në shërbimet spitalore dhe maternitete është një avantazh i rëndësishëm për studentët, pasi sjellin eksperiencën e tyre me raste konkrete që diskutohen dhe interpretohen gjatë mësimit. Kjo</td>
</tr>
</table>

| | |
|---|---|
| | mundësi angazhohet për të zhvilluar më tej aftësitë profesionale të studentëve dhe për të rritur besimin e tyre në fushën e mjekësisë. Punimet kërkimore të studentëve mund të publikohen në Buletinin e UK. Studentët gjithashtu kanë mundësinë të prezantojnë punimet e tyre në konferencën studentore të organizuar nga FSHNH, duke kontribuar në zhvillimin e mëtejshëm të aftësive të tyre kërkimore dhe prezantuese. Kjo mundësi i mundëson studentëve të shprehin idetë e tyre dhe të përfitojnë nga një platformë akademike për të ndarë rezultatet e kërkimit të tyre.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2022-2023*<br>*Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2023-2024*<br>*Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2024-2025*<br>*Shtojca 2.7.1; Plani mësimor i programit të studimit 2022-2023*<br>*Shtojca 2.7.2; Plani mësimor i programit të studimit 2023-2024*<br>*Shtojca 2.7.3; Plani mësimor i programit të studimit 2024-2025*<br>*Shtojca 4.8; Webfaqja e UK*<br>*Shtojca 4.11; Jeta studentore dhe veprimtaritë e QKA*<br>*Takim me stafin akademik;*<br>*Takim me studentët.* |
| **Kriteri 5.** Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit. | Gjatë vitit akademik, në përputhje me kalendarin e aktiviteteve shkencore dhe kalendarin e promocionit shëndetësor, organizohen seminare, konferenca, leksione të hapura dhe tavolina të rrumbullakëta jashtë strukturës së programit mësimor. Këto aktivitete ofrojnë mundësinë që studentët dhe pedagogët të njihet me zhvillimet më të fundit në fushën e shëndetit, të shkëmbejnë eksperiencat dhe dijet e tyre. Pjesëmarrës në këto aktivitete janë studentët, të cilët kontribuojnë dhe përfitojnë nga njohuritë e reja të prezantuara. Institucioni disponon dokumentacion që vërteton realizimin e këtyre aktiviteteve.<br>Stafi akademik organizon orë të hapura dhe seminare mbi të rejat e shkencës së Infermierisë, duke e raportuar këtë aktivitet në takimet përkatëse. Kjo është një praktikë e mirë që është implementuar dhe vazhdon të praktikohet në periudhën aktuale. Aktivitetet e organizuara janë të lidhura ngushtë me fushat e veprimtarisë së departamentit dhe kanë për qëllim të nxisin përfshirjen e studentëve në aktivitete praktike dhe shkencore. Po ashtu, studentët marrin |

| | |
|---|---|
| | pjesë në mënyrë interaktive në evente të ndryshme që zhvillohen në FSHNH.<br>Konferenca dhe workshop-e të ndryshme janë organizuar brenda FSHNH, ku studentët janë aktivë dhe pjesëmarrës. Ndërkohë, stafi akademik zhvillon studime kërkimore shkencore, brenda dhe jashtë strukturës së programit të studimit, duke kontribuar në avancimin e dijes dhe kërkimit shkencor në fushën e shëndetit dhe Infermierisë. Kjo angazhim kontribuon në zhvillimin e aftësive kërkimore të studentëve dhe rrit ndërveprimin e tyre me mjedisin shkencor dhe profesional.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 4.11; Jeta studentore dhe veprimtaritë e QKA*<br>*Shtojca 4.8; Webfaqja e UK*<br>*Shtojca 4.9; Webfaqja e FSHNH*<br>*Takim me stafin akademik.* |
| **Konkluzione** | *GVJ gjykon se standardi III.4 përmbushet plotësisht. Programi i studimit synon thellimin e njohurive dhe zhvillimin e aftësive profesionale në fushën e Infermierisë. Proçesi mësimor realizohet nëpërmjet orëve teorike dhe praktike si leksione, seminare, detyra kursi, prezantime apo praktika. Studentët marrin formim të avancuar infermieror në fushën e obstetrikë-gjinekologjisë. Programi mësimor krahas lëndëve të formimit bazë në fushën e infermieristikës përmban dhe lëndë të formimit të përgjithshëm përmes të cilave synohet zhvillimi i aftësive në fushën e teknologjisë së informacionit, në fushën e komunikimit dhe ndërveprimit. Institucioni mbështet studentët në zhvillimin e ideve të tyre inovative apo realizimin e punimeve të ndryshme. Në funksion të një përgatitje të gjithanshme profesionale dhe të formimit të mendimit kritik, institucioni organizon në mënyrë periodike leksione të hapura apo konferenca shkencore me pjesmarrjen.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi III.5**<br>**Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike. | Bazuar në *Nenin 108, "Rregullore Organizimit dhe Veprimtarisë Mesimore, Kërkimore Shkencore" e Universitetit "Fan S. Noli", Korçë* si dhe Neni 90 në Rregulloren e UNIKO, në përfundim të kursit të plotë të studimeve, studenti ka të drejtë të diplomohet me provim formimi ose me temë diplome, sipas përcaktimeve të bëra në këtë rregullore. Diploma nënshkruhet nga dekani i fakultetit përkatës dhe rektori i universitetit, dhe nënshkrimi i rektorit shoqërohet me vulën zyrtare të universitetit.<br>Për studentët që kanë përfunduar studimet me të gjitha notat dhjeta, jepet certifikata "Medalje e Artë". Për studentët që gjatë studimeve kanë marrë mbi 70% të notave 10 dhe pjesën tjetër vetëm 9, jepet certifikata "Student i Shkëlqyer". Studentëve që në përfundim të studimeve kanë mesataren e përgjithshme mbi 8, u shënohet emri në Librin e Nderit të Universitetit.<br>Studenti nuk lejohet të japë Provimin Përfundimtar nëse nuk ka shlyer më parë të gjitha detyrimet (nuk ka marrë nota kaluese në të gjitha provimet e disiplinave të Programit të Studimit). Kjo bazohet në *Nenin 73, pika 2, të Ligjit Nr. 80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë".*<br>Studentët me mesatare mbi 7 (dy vitet e para të studimit) mund të zhvillojnë provimin e formimit me "Temë". Në këtë rast, ata bëjnë përcaktimin e temës në bashkëpunim me pedagogët udhëheqës. Po ashtu, studenti do të njihet më parë me mënyrën e hartimit të tezës dhe me skemën e zhvillimit të Provimit të Formimit të Përfundimtar. Studentët nota mesatare e të cilëve është nën 7 në 4 semestrat e 1-rë e shlyejnë detyrimin përfundimtar me provim.<br>Detyrimet përmbyllëse kanë në total 7 kredite.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë*<br>*Shtojca 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH*<br>*Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2022-2023*<br>*Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2023-2024*<br>*Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2024-2025*<br>*Takim me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë.* |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse. | Sipas Nenit 90 të Rregullores së UNIKO, studentët në programet e ciklit të parë të studimeve diplomohen me provim të përgjithshëm përfundimtar. Neni 70, pika 3 e Statutit të UNIKO përcakton që në përfundim të programeve të ciklit të parë lëshohet diploma "Bachelor" në fushën e arsimimit të kryer. Modalitetet e zhvillimit të provimit final jepen në aktet e brendshme të institucionit dhe për të fituar të drejtën e hyrjes në provimin përfundimtar studenti duhet të ketë marrë vlerësime pozitive në të gjitha lëndët mësimore dhe në praktikë duke marrë kreditet e nevojshme. Diplomimi realizohet në sezone dhe për studentët që nuk diplomohen në sezonin e diplomimit të verës mund të diplomohen në sezonin pasardhës të vjeshtës. Pedagogu mbështetet në **Manualin e Hartimit të Temës së Diplomës** për procesin e hartimit të temës, duke udhëzuar studentin mbi strukturën, metodologjinë dhe kërkesat akademike që duhen ndjekur. Ky manual shërben si udhëzues për të siguruar një punim shkencor të rregullt dhe në përputhje me standardet e institucionit.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë*<br>*Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2022-2023*<br>*Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2023-2024*<br>*Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2024-2025*<br>*Shtojca 2.18.3; Manuali i hartimit të temës së diplomës*<br>*Takim me studentët.*<br>*Shtojca 1.1 Statuti i universitetit 'Fan S. Noli".pdf.* |
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | Studenti ka të drejtë të mbrojë diplomën pasi ka plotësuar të gjitha kreditet e programit të studimit. Vlerësimi final i studentëve bëhet përmes provimit final, i cili realizohet para një komisioni të posaçëm për provimin dhe një komisioni për mbrojtjen me temë. Këto komisione ngrihen me propozim të drejtuesit të departamentit dhe miratohen nga dekani i FSHNH në nivel Fakulteti.<br>Studentëve u vihen në dispozicion materialet e nevojshme në funksion të provimit final. Temat e diplomës propozohen nga pedagogët përkatës dhe bëhen të ditura për studentët para zhvillimit të provimit.<br><br>**Evidenca:** |

| | |
|---|---|
| | *Shtojca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë*<br>*Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2022-2023*<br>*Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2023-2024*<br>*Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2024-2025*<br>*Shtojca 2.18.3; Manuali i hartimit të temës së diplomës Takim me stafin akademik;*<br>*Takim me studentët.* |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | Studentët asistohen nga pedagogët në procesin e hartimit të temës së diplomës përmes zhvillimit të seancave konsultuese, të cilat përbëjnë orë pune të dedikuara për të ndihmuar në hartimin e strukturës së temës, zgjedhjen e literaturës, metodologjinë e hartimit dhe shkrimit të punimit, si dhe në teknikat e prezantimit të tij. Konsultimet zhvillohen nga pedagogu udhëheqës i temës dhe kanë një qasje interaktive, duke mundësuar diskutime dhe orientim të vazhdueshëm mbi përmbajtjen dhe cilësinë e punimit.<br>Institucioni garanton studentëve të gjitha kushtet e nevojshme për realizimin e pjesës teorike të temës së diplomës, duke vënë në dispozicion infrastrukturën akademike dhe burimet shkencore të nevojshme. Gjithashtu, u mundësohet mbështetje për mbledhjen e të dhënave dhe realizimin e testeve në institucionet shëndetësore me të cilat ka marrëveshje bashkëpunimi, duke siguruar kështu cilësinë dhe saktësinë e informacionit të përfshirë në punimin e diplomës dhe rritjen e nivelit akademik të punimeve të realizuara nga studentët.<br>Bazuar tek GVB në vlerësimin e procesit të hartimit të temës së diplomës, evidentohen praktika të mira në aspektin e mbështetjes akademike dhe organizimit të procesit konsultativ. Megjithatë, rekomandohet rritja e ndërveprimit mes studentëve dhe pedagogëve për të siguruar një qasje më efektive në zbatimin e metodologjisë së punimit shkencor.<br><br>**Evidencat:**<br>*Shtojca 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH*<br>*Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2022-2023*<br>*Shtojca.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri"* |

| | |
|---|---|
| | *2023-2024*<br>*Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2024-2025*<br>*Shtojca 2.18.3; Manuali i hartimit të temës së diplomës* |
| **Kriteri 5.** Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit. | Studentët kanë mundësi të shfrytëzojnë kapacitetet dhe infrastrukturën e Universitetit "Fan S. Noli" për qëllime kërkimore, duke përfituar nga pajisjet dhe ambientet e duhura për realizimin e analizave dhe punimeve praktike. Kjo është konfirmuar gjatë takimeve në institucion me drejtuesit e njësive akademike dhe studentët. Përveç mjediseve të institucionit, studentëve u mundësohet kryerja e testimeve dhe mbledhja e të dhënave edhe në institucionet partnere me të cilat universiteti ka marrëveshje bashkëpunimi.<br>Temat propozohen nga pedagogët në konsultim me studentët, duke iu përshtatur fushave të tyre të studimit dhe interesave akademike. Studentët asistohen nga pedagogët dhe stafi administrativ i departamentit në procesin e përzgjedhjes së temës, caktimin e udhëheqësit akademik dhe plotësimin e formularit të aplikimit. Aplikimet shqyrtohen nga departamenti dhe miratohen nga Përgjegjësi i Departamentit, duke siguruar një proces të rregullt dhe transparent.<br>Mikroteza vlerësohet me 7 ECTS, e cila përfaqëson 175 orë punë të pavarur të studentit. Për të garantuar një proces efektiv, institucioni siguron mbështetje të vazhdueshme akademike, duke vënë në dispozicion udhëheqës të kualifikuar dhe burime të përshtatshme për kërkimin shkencor. Kjo qasje siguron një standard të lartë akademik dhe përgatit studentët për sfidat profesionale në fushën e tyre të studimit.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2022-2023*<br>*Shtojca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2023-2024*<br>*Shtojca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri" 2024-2025*<br>*Shtojca 2.10; Marrëveshjet e bashkëpunimit në mbështetje të praktikave klinike dhe profesionale.*<br>*Shtojca 2.10.1; Marrëveshje bashkëpunimi të FSHNH*<br>*Shtojca 2.10.2; Listë përmbledhëse e marrëveshjeve institucionale;* |

| | |
|---|---|
| | *Takim me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë;*<br>*Takim me studentët.* |
| **Kriteri 6.** Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë. | Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë nga anëtarët e komisionit përkatës. Pas vlerësimit, procesverbali dorëzohet në sektorin e studimeve dhe sektorin e TIK, i firmosur nga anëtarët dhe kryetari i komisionit. Korrigjimi i provimit kryhet në mënyrë anonime, pa kodim të identitetit të studentit. Pas përfundimit të korrigjimit, sekretaria përpilon dhe publikon rezultatet, duke siguruar transparencë dhe saktësi në vlerësim.<br><br>**Evidenca:**<br><br>*Shtojca 2.18.3; Manuali i hartimit të temës së diplomës*<br><br>*Shtojca 1.10; Rregullore e sektorit të studimeve dhe sektorit të TIK*<br><br>*Shtojca 2.18 Kontrata aadf me Univerisitetin F. S. Noli Korcë.pdf.* |
| **Kriteri 7.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | Në përfundim të studimeve, studentët pajisen me diplomën përkatëse dhe suplementin e diplomës, sipas parashikimeve të nenit 70, pika 3 të Statutit të Universitetit "Fan S. Noli" dhe Nenit 90 të Rregullores së programit të studimit. Përveç diplomës dhe suplementit, studentët marrin një kopje të programit të studimit që kanë përfunduar në ciklin e parë të studimeve (Bachelor).<br>Kopjet e dokumenteve të studentëve ruhen në përputhje me legjislacionin në fuqi, duke siguruar mbrojtjen e të dhënave personale dhe akademike. Informacioni mbi studentët, përfshirë regjistrin themeltar dhe regjistrin e arritjeve akademike, plotësohet dhe ruhet sipas procedurave dhe rregullave të përcaktuara nga legjislativa dhe politika e institucionit.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH*<br>*Shtojca 2.5.4; Modeli i diplomës & suplementi i programit të studimit në bachelor "Infermieri"*<br>*Shtojca 1.10; Rregullore e sektorit të studimeve dhe sektorit të TIK*<br>*Shtojca 1.9 Rregullore për mbrojtjen , ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale.pdf.* |
| **Kriteri 8.** Institucioni ruan në | Dokumentacioni i studentëve për periudhën e studimeve, nga hyrja |

| | |
|---|---|
| përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. | deri në përfundim, mbahet, përpunohet dhe ruhet sipas rregullave dhe procedurave përkatëse. Ky proces siguron mundësinë e shërbimit të shpejtë për kërkesat e studentëve, siç janë transferimi i studimeve, hartimi i vërtetimeve, listave të notave dhe dokumenteve të tjera të nevojshme.<br>Diplomat e studentëve regjistrohen në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor, që mbahet në Ministrinë e Arsimit dhe Sporteve. Kjo siguron që informacioni mbi diplomimin e studentëve është i dokumentuar dhe i njohur në nivel shtetëror.<br>Për sa i përket ruajtjes së dokumentacionit, kopjet e tij ruhen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe janë të disponueshme për studentët, sipas kërkesës, përmes sekretarisë mësimore.<br>Informacioni mbi studentët (regjistri themeltar, regjistri i arritjeve akademike) ju vu GVJ në dispozicion nga sekretaria mësimore gjatë vizitës në institucion.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 1.10; Rregullore e sektorit të studimeve dhe sektorit të TIK*<br>*Shtojca 1.9 Rregullore për mbrojtjen , ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale.pdf.*<br>*Takim me sekretarinë mësimore.* |
| **Konkluzione** | *Procesi i diplomimit realizohet me anë të provimit përfundimtar të formimit, në përfundim të vitit të tretë akademik, Provimi i diplomës bëhet në dy sesione diplomimi të cilat percaktohen nga Dekani i Fakultetit. Studenti që nuk paraqitet ose vlerësohet negativisht në sesionin e parë të provimeve, ka të drejte të paraqitet në provim në sesionin e ardhshëm. Departamenti përcakton datën e zhvillimit të provimit të diplomes. Detyrimet përmbyllëse kanë në tota 17 kredite. Studentët kanë mundësi të përdorin kapacitetet dhe infrastrukturën e UK, për arsye kërkimore. Në përfundim të studimeve, studentët pajisen me diplomën dhe suplementin e diplomës.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<table>
<tr><td colspan="2">Standardi IV.1<br><br>Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.</td></tr>
<tr><td>Kriteret</td><td>Vlerësimi i ekspertëve</td></tr>
<tr><td>Kriteri 1. Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.</td><td>Personeli akademik që mbulon programin e studimit përbëhet nga pedagogë me eksperiencë dhe përgjithësisht kualifikimin e duhur profesional në fushat përkatëse që ata zhvillojnë në program. Nga shyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, janë angazhuar në FSHNH staf akademik për tre vite akademike si më poshtë:<br>- 2022-2023 është 48 PAE, 66 PAK , 3 personel ndihmës, gjithsej 117<br>- 2023-2024 është 49 PAE, 62 PAK , 3 personel ndihmës, gjithsej 114<br>- 2024-2025 është 51 PAE, 66 PAK , 3 personel ndihmës, gjithsej 120.<br>Raporti i stafit akademik në FSHNH për vitin akademik 2024-2025 është 51 PAE, 66 PAK, 3 personel ndihmës, gjithsej 120.<br><br>Për tre vite akademike të dhënat e stafit për program studimi vijojnë si më poshtë:<br>
<table>
<tr><td rowspan="2">Kualifikimi i stafit akademik të programit të studimit</td><td colspan="2">2022-2023</td><td colspan="2">2023-2024</td><td colspan="2">2024-2025</td></tr>
<tr><td>PAE</td><td>PAK</td><td>PAE</td><td>PAK</td><td>PAE</td><td>PAK</td></tr>
<tr><td>Prof.Dr</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td></tr>
<tr><td>Prof.As.Dr</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td><td>-</td></tr>
<tr><td>Dr</td><td>8</td><td>1</td><td>9</td><td>1</td><td>9</td><td>2</td></tr>
<tr><td>MSc</td><td>8</td><td>24</td><td>9</td><td>23</td><td>9</td><td>26</td></tr>
<tr><td>Total</td><td>16</td><td>25</td><td>18</td><td>24</td><td>18</td><td>28</td></tr>
</table></td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| | **Evidenca:**<br>*Shtojca 2.5.1 Rregullore e programit të studimit Infermieri 2022-2023 pika 6 pdf.*<br>*Shtojca 2.5.2 Rregullore e programit të studimit Infermieri 2023-2024 pika 6 pdf.*<br>*Shtojca 2.5.3 Rregullore e programit të studimit Infermieri 2024-2025 pika 6 pdf.*<br>*Shtojca 1.3 Plani strategjik i zhvillimit të uniko.pdf.*<br>*Shtojca 2.2 Rregullore e organlzimit & veprimtarisë mësimore kërkimore.pdf.*<br>*Vizita në ambientet e Universitetit "Fan S. Noli" në Korçë.*<br>*Shtojca 5; Tabela Përmbledhëse për aneks RVB* |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. | Gjatë vizitës në institucion dhe gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion në sistem, GVJ konstatoi se FSHNH disponon një bazë të dhënash për anëtarët e personelit akademik efektiv dhe me kontratë të përfshirë në programin e studimit "Bsc Infermieri e përgjithshme". Ngarkesa mësimore e këtij program-studimi mbulohet në masën në masën 69.3% nga personeli akademik me kohë të plotë i dhe 30.7% nga personeli akademik me kohë të pjesshme.<br><br>**Evidenca:**<br>*Shtojca 5; Tabela Përmbledhëse për aneks RVB*<br>*Shtojca 2.5.1 Rregullore e programit të studimit Infermieri 2022-2023 pika 6 pdf.*<br>*Shtojca 2.5.2 Rregullore e programit të studimit Infermieri 2023-2024 pika 6 pdf.*<br>*Shtojca 2.5.3 Rregullore e programit të studimit Infermieri 2024-2025 pika 6 pdf.*<br>*Shtojca 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset).*<br>*Vizita në ambientet e Universitetit "Fan S. Noli" në Korçë.*<br>*Takim me Drejtuesin e Njësisë Kryesore dhe Njësisë Bazë* |
| **Kriteri 3.** Institucioni | Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe dokumentacionin |

| | |
|---|---|
| duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. | shoqërues, si dhe nga takimet e zhvilluara gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar pranë programit të studimit. Personeli akademik efektiv i angazhuar në programin e studimit gjatë 3 viteve të fundit nuk ka patur ndryshime të mëdha. Kjo vërehet në listën e PAE të tre viteve të fundit, por edhe në kontratat e punës të lidhura midis personelit akademik dhe institucionit, të cilat kanë të parashikuara mbulimin e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore nga institucioni sipas ligjeve në fuqi.<br><br>**Evidenca:**<br>*RVB- Bachelor në Infermieri të Përgjithshme;*<br>*Evidenca 2.9 CV Jeteshkrimet e stafit akademik të perfshirë në programin e studimit.*<br>*Evidenca 4.2 Kontrate individuale e punës, për personel akademik me kohë të pjesshme.*<br>*Evidenca 4.3 Kontratë pune staf akademik efektiv.*<br>*Evidenca 4.3.1 Kontrate pune personel ndihmës akademik.*<br>*Evidenca 5. Tabela përmbledhëse për aneks RVB*<br>*Shtojca 1.13 Udhëzimi për rekrutimin e stafit akademik.*<br>*Shtojca 1.14 Udhëzimi për përmbajtjen e dosjes së stafit* |
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të publikuara e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | Institucioni ndjek procedurë rekrutimi të mirëpërcaktuar në rregulloren e Burimeve Njerëzore si edhe në udhëzimin për rekrutimin e stafit akademik, ku përcaktohet qartë procedura e punësimit, që nga kërkesa për personel akademik efektiv, nga njësia bazë drejt njësisë kryesore, e më pas drejt Rektorit. Në kërkesat për punësim, përcaktohen edhe kriteret e përgjithshme dhe specifike në lidhje me kualifikimin profesional dhe akademik.GVJ verifikoi në mënyrë rastësore dosjet e personelit akademik, kontratat e punës të stafit akademik efektiv dhe me kontratë dhe staf i ri akademik me kontratë, dhe u konstatua se dosjet e personelit nuk kishin mangësi në plotësimin e tyre.<br>*GVJ rekomandon unifikimin e CV sipas të njëjtit format.*<br><br>**Evidenca:**<br>*RVB- Bsc në Infermieri të përgjithshme;*<br>*Evidenca 2.9 CV Jeteshkrimet e stafit akademik të perfshirë në programin e studimit.* |

| | |
|---|---|
| | *Shtojca 1.1 Statuti i universitetit 'Fan s. Noli"*<br>*Shtojca 1.2 Rregullorja e Uniko.*<br>*Takim me Drejtuesin e Njësisë Kryesore dhe Njësisë Bazë, takim me përfaqësues të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arkivës* |
| **Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. | Gjatë vizitës në Institucion dhe në dokumentacion, u evidentua angazhimi i personelit ndihmës akademik, ata asistojnë dhe realizojnë orët laboratorike dhe gjithashtu realizojnë mirembajtjen e laboratoreve. Personeli ndihmës akademik ka kompetencën dhe angazhimin e duhur për realizimin e detyrave të tij.<br><br>**Evidenca:**<br><br>*Evidenca 2.14 Struktura dhe Organigrama e UK*<br>*Takim me Drejtuesin e Njësisë Bazë* |
| **Kriteri 6.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ. | Zyra Juridike dhe e Burimeve Njerëzore mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Në tabelat përmbledhëse, si dhe në dosjet e vëzhguara fizikisht në institucion, të dhënat përfshijnë anëtarët e personelit akademik të angazhuar në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrative. Të dhënat ruhen në letër dhe në formë statistikore.<br><br>**Evidencat:**<br>*Evidenca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë*<br>*Evidenca 1.4; Rregullorja e Drejtorisë Juridike dhe Burimeve Njerëzore*<br>*Evidenca 1.9; Rregullore për mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale*<br>*Evidenca 4.3; Kontratë pune staf akademik efektiv*<br>*Evidenca 4.2; Kontratë individuale e punës, për personel akademik me kohë të pjesshme*<br>*Takim me Drejtuesin e Njësisë Kryesore dhe Njësisë Bazë, takim me përfaqësues të Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Protokoll Arkivës* |
| **Kriteri 7.** Institucioni, në marrëveshje e | GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi dhe ju vunë në dispozicion marrëveshje të bashkëpunit me institucione të tjera, |

| | |
|---|---|
| bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | sipas referencave përkatëse me: Njësinënë Vendore të Kujdesit Shëndetësor parësor, Shërbimin Spitalor Rajonal, Qendrën e Kujdesit Paliativ "Mery Potter" dhe Kryqin e kuq dega Korçë.<br>Në kuadër të këtyre marrëveshjeve në të gjitha këto institucione janë angazhuar infermierë që organizojnë dhe mbikqyrin dhe monitorojnë studentët gjatë praktikave klinike. Stafi infermieror efektiv i programit që gjithashtu janë infermierë në këto institucione drejtojnë dhe mbikqyrin praktikat infermieristike në institucion.<br><br>**Evidencat:**<br>*Evidenca 2.10; Marrëveshjet e bashkëpunimit në mbështetje të praktikave klinike dhe profesionale.*<br>*Evidenca 2.10.1; Marrëveshje bashkëpunimi të FSHNH*<br>*Evidenca 2.10.2; Listë përmbledhëse e marrëveshjeve institucionale;*<br>*Evidenca 4.2; Kontratë individuale e punës, për personel akademik me kohë të pjesshme*<br>*Evidenca 4.5.1; Orari, grafiku i praktikave*<br>*Evidenca 3.16.1; Udhëzues & rregullore e praktikave mësimore, klinike-profesionale*<br>*Evidenca 3.16.2; Udhëzues vlerësimi i praktikave mësimore, klinike-profesionale*<br>*Takim me stafin* |
| **Kriter 8.** Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. | Referuar RVB-së, në fillim të ciklit të praktikës referentët e shërbimeve spitalore pasi janë njoftuar paraprakisht dhe zyrtarisht për kalendarin e praktikës klinike, pajisen me listën e studentëve dhe objektivat specifike specifike për çdo shërbim. Në përfundim të praktikës kthehet në institucion "Raporti i Praktikës", lista me kontrollin e frekuentimit dhe një relacion që përmban frekuentimin, paraqitjen (uniformën), angazhimin dhe seriozitetin e studenteve në praktikat klinike profesionale.<br><br>***Evidenca:***<br>*Evidenca 3.16.1; Udhëzues & rregullore e praktikave mësimore, klinike-profesionale*<br>*Evidenca 3.16.2; Udhëzues vlerësimi i praktikave mësimore, klinike-profesionale.*<br>*Evidenca 2.5.1; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri e Përgjithshme" 2022-2023* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *Evidenca 2.5.2; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri e Përgjithshme" 2023-2024*<br>*Evidenca 2.5.3; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri e Përgjithshme" 2024-2025*<br>*Evidenca 4.5.1; Orari, grafiku i praktikave*<br>*Evidenca 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset).*<br>*Takim me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë;* | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se ky standart plotësohet pasi personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.2**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | GVJ gjatë guidës në institucion vuri re se ky Institucion ka hapësirat e nevojshme për zhvillimin sa më bashkëkohor të programit mësimor si: Sallat e leksioneve, të seminareve, laboratorët, etj. Hapësirat mësimore janë pajisur me infrastrukturën e nevojshme didaktike për zhvillimin e leksioneve, seminareve, por jo për zhvillimin e orëve laboratorike.<br><br>***Evidenca:***<br>*Vizita në institucion;* |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së | Mjediset mësimore janë të pajisura me mjetet elektronike dhe teknologjisë së informacionit, që ndihmojnë në realizimin e procesit mësimor teorik dhe praktik. Sallat e leksionit janë të pajisura me projektorë që mundësojnë demostrimin me video të leksioneve të ndryshme. Në godinën B të FSHNH janë 7 |

| | |
|---|---|
| informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | laboratore me mjetet didaktike e pajisje për zhvillimin e procesit mësimor. Godina e Infermierisë kishte nevojë për mirëmbajtje, ashtu sikurse edhe mbulimi me internet i çdo ambjenti të UK.<br><br>***Evidenca:***<br>*Vizita në institucion* |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | Laboratorët klinikë-diagnostikë të kompletuar në Histologji, Mikrobiologji, Imunologji, Biokimi, përbëjnë një bazë të konsiderueshme në funksion të programit dhe projekteve kërkimore të studentëve. Laboratoret e Infermieristikës janë imitim i një dhome spitali që përmbajnë mjete, mulazhe total body dhe të pjesshëm, aparatura bashkëkohore të monitorimit dhe mjekimit të pacientit si monitor, sfigmomanometër, termometër, oksimetër, shiringa të përmasave të ndryshme dhe shiringa elektrike, pompa perfuzioni, kateter venoz periferik të përmasave të ndryshme, etj. Këto laboratore pajisen vazhdimisht si me mjete të konsumit ashtu edhe me aparatura të reja sipas kërkesave të stafit dhe departamentit. 9 laboratorët që gjenden në godinën B të FSHNH të dedikuar për veprimtari në fushën e kujdesit shëndetësor janë investim i drejtpërdrejtë i institucionit.<br><br>***Evidenca:***<br>*Evidenca 4.6; Tabelë përmbledhëse e kapaciteteve infrastrukturore dhe laboratorike*<br>*Vizita në institucion* |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | Nga vizita në institucion GVJ evidentoi se departamenti i informatikës u krijon mundësinë studentëve të programit Bachelor në Infermieri të Përgjithshme, që t'i përdorin këto mjedise (2 laboratorë në teknologji informacioni dhe 1 laborator në biokimi) të pajisura me kompjutera dhe programe profesionale. Aty ata zhvillojnë orët e lëndëve Informatikë dhe Statistikë mjekësore. |
| | ***Evidenca:***<br>*Evidenca 2.7.1; Plani mësimor i programit të studimit 2022-2023* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *Evidenca 2.7.2; Plani mësimor i programit të studimit 2023-2024*<br>*Evidenca 2.7.3; Plani mësimor i programit të studimit 2024-2025*<br>*Evidenca 4.6; Tabelë përmbledhëse e kapaciteteve infrastrukturore dhe laboratorike.*<br>*Evidenca 4.5; Model orari mësimor*<br>*Vizita në institucion* | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ mendon se FSHNH disponon mjedise mësimore dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të përshtatura me fushën e programit të studimit.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.3**<br>**IV.3 Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. | GVJ bazuar në dokumentat e vëna në dispozicion, vizitën në institucion, në bibliotekë, takimin me stafin dhe studentët u informua se, studentët dhe stafi kanë në dispozicion një gamë të gjërë tekstesh fizike dhe on-line (bibloteka online J-store dhe U-library Institucioni siguron tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse në gjuhën shqipe dhe të huaj, leksione të shkruara/të printuara për programet e studimit. Nga vizita në bibliotekë rezultoi se ajo ishte e pajisur me poste interneti, me kompjutera që i mundësojnë studentëve dhe pedagogëve shfrytëzimin e literaturës së nevojshme për realizimin e procesit të mësimdhënies dhe mësimnxënies. Gjithashtu komunikimi student-pedagog mundësohet edhe nëpërmjet platformave elektronike.<br><br>***Evidenca:***<br><br>*Evidenca 3.12 raport informues i bibliotekes shkencore të uk mbi botimet dhe përditësimet e literaturës.* |

| | |
|---|---|
| | *Evidenca 3.12.1 biblioteka online j-store + u-library.*<br>*Evidenca 3.13 tabelë përmbledhëse e fondit të bibliotekës fshnh.*<br>*Evidenca 2.8; programet lëndore të programit të studimit (syllabuset).*<br>*Takim me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë;*<br>*Takim me stafin akademik;takim me studentët* |
| **Kriteri 2.** Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit. | GVJ u informua se stafi akademik çdo fund viti akademik përditëson syllabusin, temat përkatëse, literaturën bazë dhe atë të rekomanduar, ciklin e leksioneve dhe bazuar në këtë përditësim bën dhe kërkesën për literaturë fizike apo on-line. *FSHNH* pasuron bibliotekën me literaturë të fundit. Literatura e të gjitha moduleve dhe burimet e paraqitura në syllabus aprovohet në fillim të vitit akademik nga njësia bazë. Bashkëbisedimi me drejtuesit e Njësisë Kryesore/Bazë na informoi që mospërditësimi i disa prej teksteve ka ndodhur edhe pasi tanimë shumë prej pedagogëve përdorin edhe libra online.<br><br>***GVJ rekomandon përditësim të literaturës me botime të viteve të fundit.***<br><br>***Evidenca:***<br><br>*Evidenca 2.8; programet lëndore të programit të studimit (syllabuset).*<br>*Takim me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë;*<br>*Takim me stafin akademik* |
| **Kriteri 3.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | GVJ konstatoi se *FSHNH* vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën mësimore. Biblioteka është në dispozicion të stafit dhe studentëve në mënyrë të barabartë në të gjitha programet dhe ciklet e studimit, edhe pse në proçes rikonstruksioni. Nuk ka asnjë kufizim të shfrytëzimit të librave në bibliotekë që lidhet me programin apo fushën e studimit. Studentët mund të shfrytëzojnë gjithë fondin e bibliotekës, pavarësisht nga fusha që studiojnë.<br><br>***Evidenca:***<br><br>*Evidenca 3.12 raport informues i bibliotekes shkencore të uk mbi botimet dhe përditësimet e literaturës.*<br>*Evidenca 3.12.1 biblioteka online j-store + u-library.*<br>*Evidenca 3.13 tabelë përmbledhëse e fondit të bibliotekës fshnh.* |

| | |
|---|---|
| | *Takim me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë;*<br>*Takim me stafin akademik* |
| **Kriteri 4.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | GVJ gjatë vizitës në institucion dhe takimin me stafin e bibliotekës u informua se Fondi i librave të bibliotekës të FSHNH përmban një numër të konsiderueshëm vëllimesh revista shkencore, koleksione si tekste mësimore, bazë literaturë ndihmëse në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj. Studentët dhe stafi akademik kanë të drejtë pa pagesë shfrytëzimin jo vetëm të literaturës fizike, por edhe on-line, për realizimin sa më të mirë të procesit mësimor dhe moduleve të programit Bsc "Infermieri e Përgjithshme". Por nuk përdorej në kohën e vizitës që GVJ zhvilloi për shkak të procesit të rikonstruksionit në të cilin është përfshirë.<br><br>***Evidenca:***<br>*Evidenca: 3.12; Raport informues i bibliotekës shkencore të UK mbi botimet dhe përditësimet e literatures*<br>*Evidenca: 3.12.1; Biblioteka online J-store + U-library*<br>*Evidenca:3.13; Tabelë përmbledhëse e fondit të bibliotekës FSHNH*<br>*Takim me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë;*<br>*Takim me stafin akademik;takim me studentët* |
| **Kriteri 5.** Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit. | GVJ konstatoi se *FSHNH* është abonuar në bibliotekën on line J-store dhe U-library të cilat shfrytëzohen nga stafi dhe studentët nëpërmjet kompjuterave të instaluar në ambjentet e bibliotekës dhe lidhur pa kufizim në internet, por për shkak të rikonstruksionit në këtë nuk mundëm ta evidentonim.<br><br>***Evidenca:***<br>*Evidenca: 3.12; Raport informues i bibliotekës shkencore të UK mbi botimet dhe përditësimet e literatures*<br>*Evidenca: 3.12.1; Biblioteka online J-store + U-library* |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët. | GVJ konstatoi se bibloteka e FSHNH është përkohësisht jashtë shërbimit për shkak të rikonstruksionit. Por nga biseda me drejtuesit konfirmohet fakti që ajo përmban një fond të rëndësishëm dhe të konsiderueshëm librash.<br><br>***Evidenca:***<br>*Evidenca: 3.12; Raport informues i bibliotekës shkencore të UK* |

| | |
|---|---|
| | *mbi botimet dhe përditësimet e literatures*<br>*Evidenca: 3.12.1; Biblioteka online J-store + U-library*<br>*Evidenca:3.13; Tabelë përmbledhëse e fondit të bibliotekës FSHNH*<br>*Takim me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë;*<br>*Takim me stafin akademik;takim me studentët* |
| **Kriteri 7.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | Biblioteka e FSHNH ka një rregullore të funksionimit, e evidentuar kjo nga dokumentacionet e paraqitura, por për shkak të restaurimit GVJ nuk pati mundësi ta shohë nga afër. Sipas asaj që referonte stafi por edhe studentët oraret e shfrytëzimit të bibliotekës përshtateshin për studentët në përputhje me orarin e tyre të mësimit.<br><br>***Evidenca:***<br>*Evidenca: 3.12; Raport informues i bibliotekës shkencore të UK mbi botimet dhe përditësimet e literatures*<br>*Takim me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë;*<br>*Takim me stafin akademik;takim me studentët* |
| **Kriteri 8.** Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik. | Biblioteka funksiononte në bazë të një rregulloreje ku çdo gjë dokumentohej në bazë të kartelave për studentë dhe për staf. Orientimi i studentëve për përzgjedhjen e literaturës në përgjithësi bëhej nga stafi akademik. *Por për shkak të rikonstruksionit në të cilin është përfshirë bibloteka nuk patëm mundësi ta shohim nga afër.*<br><br>**Evidencat:**<br>*Evidenca* 2.4.1; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2021-2022, 2022-2023. 2023-2024<br>*Evidenca* 2.13.1; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2021-2022, 2022-2023,2023-2024<br>*Evidenca* 3.13; Tabelë përmbledhëse e fondit të bibliotekës FSHNH<br>*Evidenca* 3.12; Raport informues i bibliotekës shkencore të UK mbi botimet dhe përditësimet e literatures<br>*Evidenca* 3.12.1; Biblioteka online J-store + U-library |

| Konkluzione | *FSHNH ka një Bibliotekë Universitare që ka hapësira të dedikuara dhe të bollshme për studentët, kjo sipas dokumentacioneve të paraqitura, pasi për shkak të rikonstruksionit GVJ nuk pati mundësi t'i shikonte nga afër. Biblioteka është në funksion të programit mësimor si për studentët dhe pedagogët.* | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| **Standardi IV.4**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. | FSHNH ka sistem menaxhimi të brendshëm për administrimin e informacionit që lidhet studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.<br><br>PITAGORA është aplikacioni i sekretarisë online i zhvilluar nga RASH, i cili ofron funksionalitete për sekretarinë, studentët dhe pedagogët për menaxhimin e të gjithë ciklit akademik të studimeve, si dhe regjistri themeltar sipas formatit të miratuar nga MAS.<br><br>***Evidenca:***<br>***Evidenca:*** 1.6; Manual i sistemit elektronik pitagora;<br>***Evidenca:*** 1.6.1; Marrëveshja me RASH për systemin elektronik Pitagora;<br>*Takim me stafin, studentët dhe sekretarinë mësimore*<br>*Takim me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë;* |
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve | Zyra e Burimeve Njerëzore në FSHNH, administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. FSHNH nëpërmjet sistemit PITAGORA, mundëson, përvec shërbimeve të sekretarisë, edhe menaxhimin e detyrimeve akademike të studentëve. |

| | |
|---|---|
| të angazhuar në realizimin e programit. | ***Evidenca:***<br>- *Evidenca:* 1.6; Manual i sistemit elektronik pitagora;<br>- *Evidenca:* 1.6.1; Marrëveshja me RASH për sistemin elektronik Pitagora;<br>- *Takim me stafin, studentët dhe sekretarinë mësimore*<br>- *Takim me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë;* |
| **Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | Nga vizita që GVJ pati në institucion dhe nga komunikimi me studentë dhe pedagogë, evidentoi se sistemi i menaxhimit që ky universitet, fakultet dhe departament ka, bën të mundur sigurimin e aksesit si në informacion ashtu edhe në dokumentacione për të gjithë.<br><br>***Evidenca:***<br>- *Takim me stafin, studentët dhe sekretarinë mësimore*<br>- *Takim me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë;* |
| **Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. | Institucioni nëpërmjet sistemit të menaxhimit Pitagora, mundëson komunikimin, informimin e studentëve në lidhje me veprimtari, takime, mbjedhje, diskutime, kërkim shkencor, mobilitete, etj.<br><br>***Evidenca:***<br>*Evidenca:* 1.6; Manual i sistemit elektronik pitagora;<br>*Evidenca:* 1.6.1; Marrëveshja me RASH për sistemin elektronik Pitagora;<br>*Evidenca 1.10 rregullore e sektoritte studimeve dhe sektorit TIK*<br>*Takim me stafin, studentët dhe sekretarinë mësimor*<br>*Takim me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë;* |
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. | UMIKO, FSHNH, me anë të sistemit të dixhitalizimit siguronte akses, përdorim, informacion në kohë reale të materialeve në modulet e programit që studenti frekuentonte. Falë Zyrës së IT bëhej e mundur mirëmbajtja e sistemit duke bërë të mundur përdorimin në çdo kohë. Gjithashtu, sekretaria, përgjegjësit e programeve, stafi akademik dhe studentët mund të marrin të dhëna në çdo kohë.<br><br>***Evidenca:***<br>*Evidenca: 1.6; Manual i sistemit elektronik pitagora;*<br>*Evidenca: 1.6.1; Marrëveshja me RASH për sistemin elektronik* |

| | |
|---|---|
| | *Pitagora;*<br>*Evidenca 1.10 rregullore e sektorit te studimeve dhe sektorit TIK*<br>*Takim me stafin, studentët dhe sekretarinë mësimor*<br>*Takim me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë;* |
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe. | UNIKO zotëron një faqe ëeb aktive, që mund të aksesohet nga çdo njeri. Kjo faqe është dinamike dhe përveç informacioneve të ndryshme, publikon në mënyrë periodike aktivitetin e fakultetit, të departamenteve dhe njësive të tjera.<br><br>***GVJ sygjeron që publikimet në këtë faqe të bëhen edhe në gjuhën angleze.***<br><br>***Evidenca:***<br><br>*Evidenca:* 4.8; Webfaqja e UK https://unkorce.edu.al/<br>*Evidenca:* 4.9; Webfaqja e FSHNH https://unkorce.edu.al/fakulteti-i-shkencave-natyrore-dhe-shkencave-humane-3/<br>*Takim me stafin, studentët dhe sekretarinë mësimor*<br>*Takim me Drejtuesit e Njësisë Kryesore dhe Bazë* |
| **Konkluzione** | *Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për studentët dhe pedagogët. Çdo student ka llogarinë e tij në këtë sistem ku në mënyrë konfidencialë merr informacion për rezultatet e provimeve gjatë vitit akademik.*<br><br>*Sistemi ka të përfshirë edhe komunikimin interaktiv dhe shkëmbimin e informacioneve.*<br><br>*Institucioni disponon faqen zyrtare, ku studentët dhe të gjithë të interesuarit mund të hyjnë lehtësisht dhe të marrin informacione për programet dhe për aktivitetin akademik të Universitetit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

**Standardi IV.5**

**Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.**

| Kriteret | Vlerësimi i ekspertëve |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | Bazuar në materialin e RVB-së, evidencat përkatëse, si edhe informacionet e marra gjatë vizitës 2-ditore në institucion, u evidentua që FSHNH harton raportin vjetor, një raport mjaft i rëndësishëm për të gjithë informacionin që ofron. Në këtë raport përfshiheshin të dhënat vjetore për aktivitetin mësimor, kërkimor shkencor dhe atë financiar. Raporti vjetor përmbledh analizën vjetore të cdo njësie bazë, njësie kryesore e administrative në FSHNH dhe UK.<br><br>***Evidenca:***<br><br>*Evidenca* 1.7; Rregullore e Drejtorisë Ekonomike;<br>*Evidenca* 1.8; Rregullore e Drejtorisë së Financës (EDE);<br>*Evidenca* 1.8.1 Rregullore Financiare e Shpërndarjes së të Ardhurave të UK;<br>*Evidenca* 1.11; Rregullore e Senatit Akademik; |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 2.** Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë. | Në FSHNH, përgatitja e buxhetit, mënyra e shpërndarjes së fondeve dhe përdorimit të tyre, është kompetencë e institucionit dhe menaxhohet nga Bordi i Administrimit. Propozimet vijnë nga baza dhe miratimi i tyre bëhej nga Rektorati. Proçesi i hartimit të buxhetit nis me diskutimet dhe marrjen e propozimeve nga njësitë bazë dhe strukturat administrative. Pas shqyrtimit dhe miratimit të propozimeve, fakulteti përcjell planin në nivel fakulteti në Rektorat. Në planin e financimit përfshiheshin zëra për: burimet njerëzore dhe infrastrukturore, materialet e konsumit dhe materialet për laboratore, pajisjet, zhvillimin e praktikave spitalore, pasurimin e bibliotekës, mundësitë e mbështetjes finanaciare në fushën e kërkimit shkencor për stafin akademik.<br><br>***Evidenca:***<br><br>*Evidenca* 1.7; Rregullore e Drejtorisë Ekonomike;<br>*Evidenca* 1.8; Rregullore e Drejtorisë së Financës (EDE);<br>*Evidenca* 1.8.1 Rregullore Financiare e Shpërndarjes së të Ardhurave të UK;<br>*Evidenca* 3.15; Praktika e miratimit të Buxhetit UK<br>*Evidenca* 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.<br><br>**Kriteri 4.** Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. | Bazuar në dokumentacionet e sjella, NJAB (Njësia e Auditimit të Brendshëm) është struktura e ngritur në nivel universiteti për të kryer auditimin periodik. NJAB ushtron veprimtari të pavarur, dhe në mënyrë sistematike ndihmon në vlerësimin dhe përmirësimin e proceseve të menaxhimit të brendshëm të institucionit. Kështu FSHNH në përbërje të së cilës është edhe *Departamenti i Infermierisë, si pjesë përbërëse e UK, kryejnë veprimtarinë e tyre financiare në përputhje me planet e miratuara nga Rektorati.*<br><br>Gjatë takimit me drejtuesen e departamentit dhe me drejtuesin e njësisë kryesore na u shpjeguan qartësisht etapat që ndiqeshin deri në hartimin final të Raportit Vjetor, ashtu sikurse ishte paraqitur edhe në dokumentacionet e dorëzuara.<br><br>***Evidenca:*** |

| | |
|---|---|
| | *Evidenca* 2.4.1; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2021-2022.<br>*Evidenca* 2.4.2; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2022-2023.<br>*Evidenca* 2.4.3 Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2023-2024.<br>*Evidenca* 2.13.1; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2021-2022<br>*Evidenca* 2.13.2; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2022-2023<br>*Evidenca* 2.13.3; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik 2023-2024<br>*Evidenca* 1.8.1 Rregullore Financiare e Shpërndarjes së të Ardhurave të UK;<br>*Evidenca* 1.15; Raport i kontrollit të MASR për kapacitetet pritëse të UK 2023-2024<br>*Takim me drejtuesit e njësisë bazë dhe njësisë kryesore* |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve. | GVJ bazuar në RVB, referencat përkatëse si dhe takimin me drejtuesit e institucionit konstaton se institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve.<br><br>Të ardhurat siguroheshin kryesisht nga tarifat e shkollimit dhe të ardhurat nga shërbimet që kryhen. Gjithashtu UK vendos lidhjen e marrëveshjeve të pavarura me institucione private edhe shtetërore.<br><br>***Evidenca:***<br><br>*Evidenca* 2.4.; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK 2021-2022, 2022-2023, 2023-2024<br>*Evidenca* 1.8.1 Rregullore Financiare e Shpërndarjes së të Ardhurave të UK;<br>*Evidenca* 3.7; Raporti Institucional i vlerësimit të brendshëm UK (relacion)<br>*Evidenca* 3.15; Praktika e miratimit të Buxhetit UK<br>*Evidenca* 5; Tabela Përmbledhëse për aneks RVB<br>*Takim me drejtuesit e njësisë bazë dhe njësisë kryesore* |

| Konkluzione | *Çdo vit akademik UK dhe FSHNH hartojnë raportin financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit Bachelor në Infermieri dhe mbështetjen e studentëve. UK garanton qëndrueshmërinë financiare për realizimin e objektivave dhe misionit të tij* | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| **Standardi V.1**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | GVJ gjatë bashkëbisedimit me drejtues të institucionit, studentët, koordinatorin e programit, sekretarinë mësimore, RVB, konstatoi se ky institucion harton politika dhe procedura të sakta gjatë vitit akademik të studentëve (në hyrje dhe në përfundim të studimeve), në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi.Institucioni disponon akte rregullatore për strukturat dhe njësitë kryesore në përputhje me statutin e universitetit. Institucioni, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të miratuara nga Senati Akademik, zbaton procedura, të cilat garantojnë të drejta të njëjta, për të gjithë studentët. Mundësohet ndjekja korrekte e kandidatit që nga momenti i aplikimit deri në përmbylljen e detyrimeve akademike dhe diplomimin e tij. Çdo student që paraqet kërkesë |

| | |
|---|---|
| | për transferim për largim apo kalim në UK ka të drejtë ta realizojë këtë në bazë të rregullores dhe legjislacionit në fuqi.<br><br>***Evidenca:***<br><br>*Evidenca* 1.1 Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë<br>*Evidenca* 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë<br>*Evidenca* 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH<br>*Evidenca* 2.5.; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri e Përgjithshme" 2022-2023, 2023-2024, 2024-2025<br>*Evidenca* 2.18.2; Model testimi clean score<br>*Evidenca* 2.18.3; Manuali i hartimit të temës së diplomës<br>*Evidenca* 2.18.4; Formulari i vlerësimit të temës së diplomës udhëheqës/oponent.<br>*Evidenca* 2.10; Marrëveshjet e bashkëpunimit në mbështetje të praktikave klinike dhe profesionale.<br>*Evidenca* 2.20; Jeta studentore dhe veprimtaritë e QKA<br>*Evidenca* 4.10; Material promovues broshura për promovimin<br>*Evidenca* 2.5.4; Modeli i diplomës & suplementi i programit të studimit në bachelor "Infermieri e Përgjithshme".<br>Takim me studentët<br>*Takim me drejtuesit e Njësisë Bazë, Njësisë Kryesore* |
| **Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | Gjatë vizitës në institucion, në sekretarinë mësimore GVJ vuri re se ky institucion bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë Shqiptar, statutin e UK siguron barazinë bazuar mbi kriteret dhe procedurat për të gjithë kandidatët për t'u rregjistruar në Programin e Studimit të Diplomës Bachelor në "Infermieri e Përgjithshme". Studentët kanë mundësi të njëjta informimi, studimi, kandidimi për forume drejtuese, pjesëmarrje në aktivitete promovuese, konkurimi për bursa apo mobilitete në kuadër të projekteve të ndryshme. Përzgjedhja realizohet me procedura transparente.<br><br>***Evidenca:***<br><br>*Evidenca* 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë<br>*Evidenca* 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë<br>*Evidenca* 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 3.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj. | GVJ në takimin me stafin akademik dhe studentet si dhe dokumentat e vena në dispozicion, u informua dhe konstatoi se para çdo viti akademik, në afatet e përcaktuara nga MASR organizohen "ditët e informimit të maturantëve" në gjimnazet kryesore të qarkut të Korçës dhe qarqet fqinje të cilat përbëjnë burimin kryesor të studentëve që ndjekin studimet në këtë fakultet. UK harton dhe publikon përpara çdo viti kriteret e veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, duke u bazuar në vendimet e Senatit Akademik në mbështetje të kritereve kombëtare, të propozuara nga njësitë bazë. Programi i studimit bachelor në "Infermieri e përgjithshme" ofrohet vetëm në gjuhën shqipe, kështu që kuota për studentët e huaj nuk ofrohen.<br><br>*GVJ sugjeron që të krijohet mundësia si fillim për të dhënë lëndë apo mudule në gjuhë të huaj.*<br><br>**Evidenca:**<br><br>*Evidenca* 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë<br>*Evidenca* 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë<br>*Evidenca* 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore<br>Shkencore e FSHNH<br>*Evidenca* 2.3; Rregullore e njësisë bazë "Departamenti i Infermierisë";<br>*Evidenca* 2.5.; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri e Përgjithshme" 2022-2023, 2023-2024, 2024-2025<br>Takim me studentët<br>*Takim me drejtuesit e Njësisë Bazë, Njësisë Kryesore* |
| **Kriteri 4.** Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | GVJ konstatoi se UK ka një rregullore të veçantë për transferimin e studentëve nga programe të ngjashme dhe ndjekjen e programeve të dyta studimi. Kështu që studentët kanë mundësi të informohen në lidhje me transferimin apo ndjekjen e fakulteteve të dyta.<br><br>***Evidenca:***<br>*Evidenca* 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë<br>*Evidenca* 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë<br>*Evidenca* 4.10; Material promovues broshura për promovimin<br>*Evidenca* 4.11; Jeta studentore dhe veprimtaria e QKA<br>*Takim me studentët* |

| | *Takim me drejtuesit e Njësisë Bazë, Njësisë Kryesore* |
|---|---|
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit. | GVJ konstatoi se UK merret seriozisht me informimin e publikut duke organizuar orët e hapura në UK për maturantët. Gjithashtu ofron informacion me anë fletëpalosjeve, faqes zyrtare ëeb, rrjeteve sociale, etj., olimpidat me nxënës të shkollave të mesme që janë zhvilluar nga FSHNH dhe Laboratori i Dijes me pjesëmarrjen aktive të studentëve të Programit të Studimit "Infermieri e Përgjithshme" të cilat kanë luajtur një rol të rëndësishëm në promovimin e programit të studimit "Infermier i Përgjithshëm".<br><br>***Evidenca:***<br><br>*Evidenca* 4.8; Webfaqja e UK https://unkorce.edu.al/<br>*Evidenca* 4.9; Webfaqja e FSHNH https://unkorce.edu.al/fakulteti-i-shkencave-natyrore-dhe-shkencave-humane |
| **Kriteri 6.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara. | Politikat që ndjek UK, bazuar në atë çfarë evidentuam në RVB nuk përbëjnë diskriminim për studentët me përkatësi të ndryshme, dhe në këtë mënyrë sigurohet barazia për të gjithë kandidatët me aftësi të veçanta. ***Por GVJ konstatoi se FSHNT me infrastrukturën që ka, nuk është e përshtatshme për t'u aksesuar nga ana e studentëve me aftësi të kufizuar.***<br><br>***Evidenca:***<br><br>*Evidenca* 3.19; "Propozim për kuotat & kriteret e pranimit të studentëve".<br>*Evidenca* 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë<br>*Evidenca* 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë |
| **Kriteri 7.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. | UK i ofron mundësi studentëve që vijnë nga trojet apo shtetas të huaj për të ndjekur studimet. Nërpërmjet faqes Ëeb të UK, fletë palosjeve, reklamave televizive, Zyrës së karrierës dhe këshillimit, ofron informacion për mënyrën e ndjekjes së procedurave për regjistrim. Megjithatë nuk u konstatua pjesëmarrja e këtij kontigjenti në këtë universitet.<br><br>***Evidenca:***<br><br>*Evidenca* 3.19; "Propozim për kuotat & kriteret e pranimit të |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | studentëve".<br>*Evidenca* 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë<br>*Evidenca* 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë<br>*Evidenca* 2.5; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri e Përgjithshme" 2022-2023, 2023-2024, 2024-2025 | | | |
| **Kriteri 8.** Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. | GVJ konstatoi se UK në politikat e saj ofron mbështetje financiare për studentët me rezultate të larta, si edhe ka politika mbështetëse për shtetas në nevojë duke i mbështetuar ata nga ana ekonomike.<br><br>***Evidenca:***<br>*Evidenca* 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë<br>*Evidenca* 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë<br>*Evidenca* 4.7; Njoftimi për përfitimin e bursave | | | |
| **Konkluzione** | *UK dhe FSHNH, ndjek dhe zbaton politika dhe proçedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit Bachelor në Infermieri të Përgjithshme, bazuar në aktet ligjore.*<br>*UK, ndjek politikë mbështetëse për studentët e shtresave në nevojë duke i ndihmuar ekonomikisht si edhe për dhe studentët me nevoja dhe statuse të veçanta ofron lehtësira financiare.*<br>*<u>GVJ sugjeron</u> që të krijohet mundësia si fillim për të dhënë lëndë apo mudule në gjuhë të huaj.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| | |
|---|---|
| **Standardi V.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në | GVJ, referuar dokumentacionit të dorëzuar, rregullores së programit të studimit, faqes zyrtare të ëeb si dhe takimit me përfaqësues të tij, konkludon se i gjithë informacioni i plotë dhe |

| | |
|---|---|
| lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | i hollësishëm gjendet në rregulloren mësimore të programit të studimit dhe aktet e tjera rregullatore.<br><br>Gjithashtu u konstatua se studentët informoheshin nga zyra e informimit dhe orientimit të studentëve në FSHNH, përgjegjësi i programit të studimit në lidhje me rregulloret e shkollës, rregulloren e programit, kushtet e frekuentimit, format e kontrollit, pikëzimet, etj.<br><br>*GVJ sugjeron që* Zyra e Këshillimit të Karrierës duhet të jetë më pranë studentëve duke punuar akoma edhe më shumë në këtë drejtim për informimin e studentëve në mënyrë që ata ta kenë fokusin te kjo zyrë për cfarëdolloj informacioni.<br><br>***Evidenca:***<br><br>*Evidenca* 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë<br>*Evidenca* 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë<br>*Evidenca* 2.5; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri e Përgjithshme" 2022-2023, 2023-2024, 2024-2025<br>- *Takim me të gjitha nivelet e përfaqësuesve të institucionit*<br>- *Takim me studentët dhe pedagogët* |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. | GVJ konstatoi se UK disponon rregullore në lidhje me transferimet dhe programet e dyta të studimit ku studentët marrin informacion në lidhje me procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Në pikën 14 të Rregullores së Programit të studimit, përcaktohet mundësia e transferimit të studimeve, ndërkohë që nuk kemi një specifikim të procedurës së transferimit, ndërsa neni 33 i Rregullores së Brendshme të FSHNH përcakton kushtet e ndjekjes së një programi të dytë studimi.<br><br>***Evidenca:***<br><br>*Evidenca* 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë<br>*Evidenca* 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH<br>*Evidenca* 2.5; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri e Përgjithshme" . |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje | GVJ konstatoi nga RVB dhe nga takimi që pati me studentet se studentët informohen mbi kriteret dhe procedurat e vlerësimit të |

| | |
|---|---|
| me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | dijeve e aftësive në programin e studimit nëpërmjet rregullores së fakultetit, departamentit dhe programit të studimit, syllabuseve të lëndëve të publikuara dhe prezantimit të pedagogut përkatës në orën e parë të mësimit, si edhe nëpërmjet sistemit Pitagora. Informimi i studentëve lidhur me vlerësimin e dijeve bëhet nëpërmjet sistemit Pitagora ku çdo student merr informacion në llogarinë e vet në momenin që pedagogu vendos vlerësimin. Studentët informuan GVJ se në çdo javë të parë te semestrit informohen dhe diskutojnë me pedagogët e lëndëve mbi procedurën e vlerësimit të tyre për cdo lëndë duke u njohur edhe me syllabusin e lëndës.<br><br>***Evidenca:***<br><br>*Evidenca* 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë<br>*Evidenca* 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH<br>*Evidenca* 2.5. Rregullorja e programit të studimit "Infermieri e Përgjithshme"<br>*Evidenca* 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset).<br>*Evidenca* 1.6; Manual i sistemit elektronik pitagora; |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. | GVJ konstatoi se diplomimi i studentëve të Ciklit të Parë të studimeve në "Bachelor në Infermieri të Përgjithshme" bëhet me provim të përgjithshëm përfundimtar, për studentët me mesatare të ponderuar nën 7 (në fundt të semestrit të pestë), dhe me temë diplome për ata me mesatare të ponderuar mbi 7. Në fillim të vitit të tretë të studimit çdo titullar lënde harton një grup temash studimi, të cilat i paraqet tek Përgjegjësi i Departamentit. Përzgjedhja e temës bëhet nga studenti në bashkëpunim me pedagogun udhëheqës. Përgjegjësi i Departamentit, bazuar edhe mbi preferencat e studentëve përcakton listën e studentëve, me temat përfundimtare si dhe pedagogët udhëheqës. Kështu nëpërmjet Zyres se Sekretarise se Departamentit informohen studentët rreth organizimit të provimeve të formimit. Në këtë mënyrë departamenti siguron të gjitha kushtet për informimin e sqarimin e studentëve për të finalizuar me sukses këtë proces.<br><br>*<u>GVJ rekomandon</u> që rregullorja e programit të studimit për pikën e diplomimit të zgjerohet dhe të jetë më orientuese për* |

<table>
<tr><td></td><td colspan="4">studentët.<br><br>Evidenca:<br><br>Evidenca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë<br>Evidenca 2.5. Rregullorja e programit të studimit “Infermieri e Përgjithshme”<br>Evidenca 2.8; Programet lëndore të programit të studimit (syllabuset)<br>Evidenca 2.18.2; Model testimi clean score<br>Evidenca 2.18.3; Manuali i hartimit të temës së diplomës</td></tr>
<tr><td>Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.</td><td colspan="4">GVJ konstatoi se UK përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, informojnë të gjithë të interesuarit, në lidhje me programin e studimit “Infermieri e Përgjithshme”, në disa forma, si fletëpalosje informuese, postera, publikime në faqen ëeb të UK, në rrjetet sociale, etj. Në ditët e informimit të maturantëve organizohen takime të hapura informuese në shkollat e mesme të Qarkut të Korçës.<br><br>Evidenca:<br><br>Evidenca 4.11; Jeta studentore dhe veprimtaria e QKA<br>Evidenca 4.10; Material promovues broshura për promovimin<br>Evidenca 4.8; Webfaqja e UK https://unkorce.edu.al/<br>Evidenca 4.9; Webfaqja e FSHNH<br>https://unkorce.edu.al/fakulteti-i-shkencave-natyrore-dhe-shkencave-humane-3/</td></tr>
<tr><td>Konkluzione</td><td colspan="4">Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin, procedurave të vlerësimit të dijeve, kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, UK informon publikun për programet e studimit që ofron duke organizuar takime të hapura me të interesuarit dhe studentët e ardhshëm mbi programin e studimit, fletë palosjeve informuese, informacionit në faqen e webit të universitetit.</td></tr>
<tr><td>Shkalla e përmbushjes së</td><td>Nuk</td><td>Përmbushet</td><td>Përmbushet</td><td>Përmbushet</td></tr>
</table>

| standardit | përmbushet | pjesërisht | kryesisht | plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi V.3**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit. | GVJ në bazë të dokumentave referuese, planet mësimore, rregullore, statutit, takimit me drejtues te institucionit, sekretarine mësimore, studentët konstaton se, UK vendos në dispozicion të studentëve informacionin e nevojshëm rreth strukturës, organizimit të programit mësimor dhe kohëzgjatjes së programit të studimit. Informacionin studentët e marrin nëpërmjet takimeve me stafin akademik që i pret në institucion në momentin që interesohen për programet e studimit, nëpërmjet kontakteve me Zyrën e Informacionit dhe Orientimit të studentëve, si edhe nëpërmjet sekretarisë mësimore të Departamentit të Infermierisë.<br><br>***Evidenca:***<br><br>*Takimi me studentët; stafin akademik; sekretarinë mësimore;* |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | GVJ bazuar në takimin me drejtues të institucionit, takimin me stafin akademik, sekretarinë mësimore si dhe takimin me studentët mendon se: UK informon studentët në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit Bachelor në "Infermieri e Përgjithshme". Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për kohëzgjatjen e programit të studimeve edhe nëpërmjet ëeb-it. Po ashtu në orën e parë studentët marrin informacion të detajuar nga pedagogët e lëndëve për syllabusin përkatës ku shprehen qartë: kreditet, kodi lëndor, raporti leksion/ seminar/ laborator/ praktik, temat, literaturë bazë dhe literaturën e rekomanduar, format e kontrollit dhe vlerësimit, detyrimet për lëndën (projekte, detyra kursi), niveli i |

| | |
|---|---|
| | detyrueshëm i frekuentimit të lëndës etj. Gjithashtu, studentët marrin informacion për lëndët dhe modulet që duhet të frekuentojnë gjatë një viti akademik në llogarinë e tyre, në sekretarinë elektronike dhe sistemin Pitagora.<br><br>***Evidenca:***<br><br>*Evidenca* 7.; Plani mësimor i programit të studimit<br>*Evidenca* 2.5; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri e Përgjithshme"<br>*Evidenca* 1.6; Manual i sistemit elektronik pitagora;<br>*Evidenca* 3.14; Udhërrëfyesi i studentëve (prezantimi me vitet e para) |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. | UK vë në dispozicion Qendrën e Karrierës për studentët në lidhje me orientimin apo mundësitë e punësimit. Kjo zyrë së bashku me departamentin, janë përgjegjëse për cdo informim për të cilin ka nevojë studenti.<br><br>***Evidenca:***<br><br>*Evidenca* 2.20; Jeta studentore dhe veprimtaritë e QKA<br>*Evidenca* 4.8; Webfaqja e UK https://unkorce.edu.al/<br>*Evidenca* 2.16; Gjurmimi i ecurisë së punësimit (alumni) dhe UISH |
| **Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | GVJ gjatë vlerësimit të dokumentacionit dhe takimit me studentët evidentoi që studentët informohen hollësisht dhe gjëresisht për infrastrukturën dhe organizimin e programit të studimit, duke filluar nga organizimi i syllabuseve, orari i mësimit, aktivitet jashtë kurrikulare, logjistikën, laboratorët, modalitet e organizimit të praktikave profesionale dhe strukturat ndihmëse. Praktika profesionale ofrohet sipas marrëveshjeve, në spital.<br><br>***Evidenca:***<br><br>*Evidenca* 3.14; Udhërrëfyesi i studentëve (prezantimi me vitet e para)<br>*Evidenca* 2.20; Jeta studentore dhe veprimtaritë e QKA<br>*Evidenca* 4.8; Webfaqja e UK https://unkorce.edu.al/<br>*Evidenca* 2.8; Programet lëndore të programit të studimit |

| | |
|---|---|
| | (syllabuset)<br>*Takim me studentët* |
| **Kriteri 5.** Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë. | GVJ konstatoi se UK informon studentët nëpërmjet platformës të brendshme elektronike PITAGORA që ndodhet në faqen zyrtare web të UK.<br><br>***Evidenca:***<br>*Evidenca 1.6; Manual i sistemit elektronik pitagora;*<br>*Evidenca 1.6.1; Marrëveshja me RASH për sistemin elektronik Pitagora;* |
| **Konkluzione** | *UK dhe programi i studimit i siguron infrastrukturën e nevojshme studentëve për marrjen e informacionit të hollësishëm lidhur me organizimin e programit të studimit, duke filluar nga organizimi i syllabuseve, orari i mësimit, aktivitet jashtë kurrikulare, logjistikën, laboratorët, modalitet e organizimit të praktikave profesionale, literaturën e nevojshme dhe strukturat ndihmëse. Institucioni mundëson përfshirjen e studenteve në një sërë aktivitete informuese.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.4**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit. | Bazuar në informacionin në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, GVJ konstatoi se UK mban dhe disponon statistika vjetore mbi numrin e studentëve të regjistruar dhe diplomuar sipas programeve dhe cikleve të studimit. Sekretaria mësimore mbante informacion në lidhje me studentët e regjistruar duke ju referuar udhëzimeve të MAS dhe QSHA, në formë fizike dhe elektronike.<br><br>***Evidenca:*** |

<table>
<tr><td></td><td>Evidenca 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë<br>Evidenca 1.6; Manual i sistemit elektronik pitagora;<br>Evidenca 1.10; Rregullore e sektorit të studimeve dhe sektorit të TIK</td></tr>
<tr><td>Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</td><td>Gjatë vizitës në UK, GVJ konstatoi se regjistrat e sekretarisë mësimore (themeltar, i arritjeve akademike dhe ai i dhënies së diplomave) janë të formatuar dhe të përditësuar sipas standardeve ligjore në fuqi. Pranë sekretarisë depozitohen edhe dokumentacioni i përgatitur nga personeli akademik lidhur me frekuentimin e studentëve dhe procesverbalet e vlerësimeve sipas lëndëve. Të dhënat për regjistrimin e studentëve në këtë program studimi për 3 vitet e fundit akademike paraqiten si vijon:
<table>
<tr><th>Viti akademik</th><th>Të regjistruar</th><th>Transferime</th><th>Totali</th></tr>
<tr><td>2021-2022</td><td>75 studentë</td><td>2 studentë</td><td>77 studentë</td></tr>
<tr><td>2022-2023</td><td>76 studentë</td><td>3 studentë</td><td>79 studentë</td></tr>
<tr><td>2023-2024</td><td>71 studentë</td><td>3 studentë</td><td>74 studentë</td></tr>
</table>
<br>Takim me sekretarinë mësimore.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</td><td>Bazuar në informacionin e RVB dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se ruajtja dhe menaxhimi i të dhënave statistikore të studentëve realizohet në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi dhe kërkesat e statutit dhe rregulloreve të UK. Në sekretarinë mësimore ndodhej i gjithe dokumentacioni i duhur për arritjet e studentëve në bazë të moduleve dhe cikleve akademike. I gjithë informacioni ruhej në formë fizike po ashtu dhe në formë elektronike të një sistemi të brendshëm të sigurt dhe të verifikueshëm nga persona të autorizuar.<br><br>Evidenca:<br>Evidenca 1.6; Manuali i sistemit elektronik pitagora;<br>Evidenca 1.9; Rregullore për mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale.</td></tr>
<tr><td>Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë</td><td>Njësia e Auditimit të Brendshëm është strukturë e posacme e cila mbikqyr, vlerëson dhe garanton autonominë e institucionit. Kjo njësi n.p.m. një plani vjetor pune të miratuar nga titullari i</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. | institucionit ushtron kontrolle periodike pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit). Sekretaria Mësimore e FSHNH është strukturë ndihmëse akademike me karakter administrativ, në nivel institucioni e cila zhvillon veprimtarinë në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Nga vizita që patëm në zyrat e sekretarisë, GVJ konstatoi se regjistrat ishin të përpiluar në mënyrë korrekte pa ndërhyrje apo korrigjime.<br><br>**Evidenca:**<br><br>*Evidenca 1.10; Rregullore e sektorit të studimeve dhe sektorit të TIK*<br>*Evidenca 1.6; Manuali i sistemit elektronik pitagora;*<br>*Evidenca 1.16; Manuali i cilësisë UK;* |
| **Kriteri 5.** Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. | Referuar RVB-së, institucioni përpilon një raport vjetor gjithëpërfshirës të të gjitha njësive dhe programeve që ofrojnë, ku mes të tjerash analizohet cilësia e studentëve në hyrje dhe në dalje. Raporti i UISH tregohen edhe rezultatet mjaft pozitive që këta studentë kanë në provimin e shtetit, ku kalueshmëria është mbi 85%.<br><br>**Evidenca:**<br><br>*Evidenca* 2.4.1; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare.<br>*Evidenca* 2.13.1; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, FSHNH për vitin akademik.<br>*Evidenca* 2.17.1; Analiza e punës mësimore-shkencore Departamenti Infermierisë, për vitin akademik.<br>*Evidenca* 3.6; Raporti vjetor i NJSBC FSHNH.<br>*Evidenca* 3.7; Raporti Institucional i vlerësimit të brendshëm UK (relacion Gjurmimi i ecurisë së punësimit (alumni) dhe UISH. |
| **Konkluzione** | *Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. Njësia bazë ku realizohet* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *programi i studimit harton raporte analitike, periodike/analiza vjetore mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, kalueshmërinë, frekuentimin dhe diplomimin si dhe punësimit të tyre.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| | |
|---|---|
| **Standardi V.5**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. | Bazuar në informacionin e paraqitur në RVB dhe në informacionin e marrë në takimet gjatë vizitës në institucion, rezulton se UK bazuar në Rregulloren e UK si dhe Statutin e UK u mundëson studentëve përfaqësimin në organet vendimmarrëse si në:<br>- Senatin Akademik;<br>- Grupet e RBV;<br>- Këshillin studentor në nivel njësie kryesore dhe institucioni<br>- NJSBC;<br>- Komisionin e Kurrikulave;<br><br>***Evidenca:***<br>*Evidenca* 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë<br>*Evidenca* 2.5; Rregullorja e programit të studimit "Infermieri e Përgjithshme"<br>2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH<br>- 2.3; Rregullore e njësisë bazë "Departamenti i Infermierisë" |
| **Kriteri 2.** Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e | GVJ konstaton se aktualisht FSHNH përfshin studentët në jetën akademike të institucionit. GVJ konstaton se UK përdor sistemin |

| | |
|---|---|
| studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | e pyetësorëve me studentët për vlerësimin e stafit akademik dhe lëndëve sipas programeve dhe cikleve të studimit që ata ndjekin. Ajo që bie në sy është përfshirja shumë e ulët e studentëve në plotësimin e pyetësorëve. Përpunimi i të dhënave të pyetsorëve realizohet nga zyra e NJSBC dhe përfundon me hartimin e Raportit të Analizës dhe Vlerësimit të Pyetësorëve (vlerësim me %), i cili u komunikohet organeve drejtuese, individualisht secilit prej pedagogëve, dhe më pas përgjegjësit të njësisë bazë për të analizuar rezultatet dhe marrjen e masave përkatëse. Gjithashtu Departamenti i Infermierisë mirëpret sugjerimet, vërejtjet dhe rekomandimet e studentëve në çdo kohë, nëpërmjet anëtarëve të këshillave studentorë dhe koordinatorit të programit të studimit.<br><br>*GVJ sygjeron që institucioni te gjej metodat e duhura për përfshirjen e sa më shumë studentëve në plotësimin e pyetësorëve.*<br><br>***Evidenca:***<br><br>*Evidenca* 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë<br>*Evidenca* 1.17; Rregullorja e Këshillit studentor<br>*Evidenca* 1.18; Rregullorja për organizimin e zgjedhjeve për organet dhe autoritetet drejtuese;<br>*Evidenca* 3.8.1; Pyetësori i NJSBC pas sezonit në bashkëpunim me Këshillin Studentor<br>*Evidenca* 3.8.2; Relacion i të dhënave nga pyetësoret me studentët |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj. | GVJ konstatoi përfshirjen e studentëve në procese akademike me pjesëmarrje në NJSBC, komisionin e kurrikulave, kërkimin shkencor, GVB, gjë e cila garanton dëgjimin e zërit të studentëve në vendimmarrje. Njësia kryesore dhe ajo bazë, përgjegjës për këtë program studimi marrin në konsideratë mendimin dhe opinionin e studentëve (vërejtjet, sugjerimet, komentet) nëpërmjet anëtarëve të këshillave studentorë, si dhe nëpërmjet kordinatorit të programit, në lidhje me procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Ndërkohë zyra e NJSBC-së përpunon të dhënat e pyetësorëve, të cilët janë të ndarë vec për stafin akademik dhe vec për lëndët që zhvillohen në këtë program. Ky feedback i jep mundësi reflektimi pedagut të lëndës për problematika që mund të hasen, por edhe më gjerë pasi |

| | |
|---|---|
| | Përgjegjësi i Departamentit mund të kalojë për diskutim në mbledhje departamenti problematikat e ngritura duke marrë vendime përkatëse në hartim, rishikim dhe përmirësim programi.<br><br>*GVJ sygjeron që të sigurohet pjesëmarrje masive e studentëve më plotësimin e pyetësorëve.*<br><br>***Evidenca:***<br><br>*Evidenca* 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë<br>*Evidenca* 1.5; Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional<br>*Evidenca* 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH<br>*Evidenca* 3.8.1; Pyetësori i NJSBC pas sezonit në bashkëpunim me Këshillin Studentor<br>*Evidenca* 3.8.2; Relacion i të dhënave nga pyetësoret me studentët<br>*Evidenca* 3.8.3; Shembull vlerësimi të performancës së stafit akademik<br>*Evidenca* 3.7; Raporti Institucional i vlerësimit të brendshëm UK (relacion)<br>*Evidenca 3.6 Raporti vjetor i NJSBC , FSHNH* |
| **Kriteri 4.** Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | Në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit sanksionohet dhe përcaktohet procedura e vlerësimit të ankesës së studentit për rezultatin e provimit. Procedura dokumentohet qartë në RVB. Në takim me GVJ, studentët shprehen të kënaqur me mënyrën e organizimit të provimeve dhe me mundësitë që ata kanë për ankimim rezultati dhe rishikim të tezës së provimit. Spipas studentëve, por edhe stafit, korrigjimi me Clean Score është mjaft efikas. Nga takimi me stafin akademik dhe studentët u vërejt se fryma në institucion është tepër pozitive.<br><br>***Evidenca:***<br><br>*Evidenca* 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë<br>*Evidenca* 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore<br>Kërkimore Shkencore e FSHNH<br>*Evidenca* 2.3; Rregullore e njësisë bazë "Departamenti i |

| | |
|---|---|
| | Infermierisë";<br>*Evidenca* 1.6; Manual i sistemit elektronik pitagora;<br>*Evidenca* 2.18.2 Model testimi clean score |
| **Konkluzione** | *-Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë, Statutin e Universitetit dhe Rregulloret e FSHNF, garantohet e drejta e studentëve ose përfaqësuesve të tyre për pjesëmarrje në organet vendim marrëse dhe këshilluese të UK*<br><br>*-Përfshirja e studentëve në vendimmarrje dhe vlerësim të procesit akademik realizohet përmes përfaqësuesve të tyre në organet e zgjedhura (NJSBC, komisioni i kërkimit shkencor, GVB), por dhe përmes tërheqjes dhe vlerësimit të opinionit të tyre në raport me mësimdhënien, praktikën profesionale, përfshirjen në projekte e grupe studimore. Studentët kanë qenë pjesëmarrës dhe në hartimin e RVB.*<br><br>*-Në rregulloren e departamentit dhe rregulloren e programit të studimit sanksionohet dhe përcaktohet procedura e vlerësimit të ankesës së studentit për rezultatin e provimit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.6**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. | UK ka në organigramë dhe Qendrën e Karrierës e cila asiston studentët dhe realizon informimin e tyre që nga momenti i regjistrimit e deri në diplomim. Studentët gjithashtu informohen edhe nga faqja e webit.<br><br>*GVJ sygjeron që punonjësit e kësaj Qëndre të përpiqen të informojnë më shumë studentët rreth shërbimeve që ofrojnë.*<br><br>***Evidenca:***<br><br>*Evidenca* 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë<br>*Evidenca* 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH |

| | |
|---|---|
| | *Evidenca* 2.20; Jeta studentore dhe veprimtaritë e QKA<br>*Evidenca* 4.8; Webfaqja e UK https://unkorce.edu.al/<br>*Evidenca* 4.9; Ëebfaqja e FSHNH<br>https://unkorce.edu.al/fakulteti-i-shkencave-natyrore-dhe-shkencave-humane-3<br>*Takim me stafin e Qendrës së Karrierës, Standarteve dhe e Sigurimit të Cilësisë* |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | Nga kontakti i GVJ me studentët, konstatoi se ata shpreheshin pozitivisht për aksesin në informacion, për disponibilitetin e sekretarisë për asistimin në aspekte të procesit mësimor, për pjesmarrjen në aktivitete shkencore, promovuese dhe trajnuese bashkë me pedagogët. Koordinatori i programit të studimit, luan një rol të rëndësishëm në informimin dhe përditësimin e studentëve lidhur me zhvillimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të këtij programi studimi. Njësia përgjegjëse për këtë program studimi administron rrjetet sociale për të krijuar një kontakt më të afërt dhe miqësor me studentët, duke ofruar në këtë mënyrë informacion dhe këshilla që lidhen me programin e studimit.<br><br>***Evidenca:***<br><br>*Takimi me studentët* |
| **Kriteri 3.** Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | Nga takimi i GVJ me studentët u konstatua se Qëndra e Këshillimit të Karrierës është pjesë përbërëse e strukturës organizative të UK, e cila funksionon në mënyrë të vazhdueshme nëpërmjet promovimit të programeve, informimit dhe orientimit në lidhje me procesin mësimor, shërben si urë lidhëse midis punëdhënësve dhe studentëve, duke mbajtur leksione të hapura, trajnime dhe duke përfshirë studentët në panairet e punës. Studentët referuan se ishin të kënaqur nga QKA.<br><br>***Evidenca:***<br><br>*Evidenca* 1.5; Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional<br>*Evidenca* 4.8; Webfaqja e UK https://unkorce.edu.al/<br>*Evidenca* 4.9; Ëebfaqja e FSHNH<br>https://unkorce.edu.al/fakulteti-i-shkencave-natyrore-dhe- |

| | |
|---|---|
| | shkencave-humane-3/<br>*Evidenca* 2.20; Jeta studentore dhe veprimtaritë e QKA<br>*Evidenca* 2.16; Gjurmimi i ecurisë së punësimit (alumni) dhe UISH<br>*Takimi me studentët* |
| **Kriteri 4.** Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse. | GVJ konstatoi nga dokumentet dhe nga takimi me ish studentë se zyra e karrierës realizonin aktiviteti si: Këshillim individual i karrierës, Organizimi i tryezave të rrumbullakta, seminare, konferenca, panairet e punës, etj. Në këtë formë UK ndjek studentët pas diplomimit dhe monitoron shkallën e punësimit.<br><br>***Evidenca:***<br><br>*Evidenca* 2.20; Jeta studentore dhe veprimtaritë e QKA<br>*Evidenca* 2.16; Gjurmimi i ecurisë së punësimit (alumni) dhe UISH<br>*Takim me studentë dhe ish-studentë* |
| **Konkluzione** | *-UK dhe FSHNH kanë proçedura dhe njësi të posaçme në shërbim të informimit të studentëve në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të IAL-ve. Në funksion të informimit të studentëve janë struktura të posacme si (Qëndra e Karrierës dhe ALUMNI, Sekretaria mësimore, Drejtoria e Standarteve dhe e Sigurimit të Cilësisë, Zyra e IT).*<br><br>*-Institucioni ka vënë në shërbim të studentëve Qëndrën e Karrierës, që realizon informimin e studentëve dhe të gjitha shërbimet që nga momenti i rregjistrimit deri në diplomim.*<br><br>*-Qëndra e Karrierës asiston në gjurmimin e studentëve pas diplomimit. Ajo mban lidhje me studentët e diplomuar nëpërmjet adresave të tyre personale të emailit dhe ka krijuar një data-bazë të të dhënave të cilat përditësohen çdo vit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT BACHELOR

| **Standardi VI.1**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. | Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë, dhe në Planin Strategjik të Zhvillimit të Universitetit 2022-2027, UK ka hartuar udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve. GVJ në takimin me drejtuesit e institucionit, stafin, studentët, NJSBC, referencat e vëna në dispozicion, mendon se, UK, e ka të ngritur dhe funksional, Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe nëpërmjet NJSBC-së, siguron zbatimin e një strategjie institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. NJSBC, funksionon plotësisht në formën e një njësie të përhershme në strukturën organizative të institucionit dhe veprimtaria e tij bazohet dhe zbatohet sipas një rregulloreje të miratuar institucionale. Kjo njësi bën të mundur vlerësimin e vazhdueshëm dhe periodik të stafit në lidhje me veprimtarinë mësimore dhe kërkimore shkencore nëpërmjët pyetësorëve që ju bëhen studentëve mbi aktivitetin mësimor, aktivitetin shkencor, infrastrukturën e institucionit, komunkimin me sekretarinë, administratën etj.<br><br>***Evidenca:***<br><br>*Evidenca* 1.1 Statuti i Universitetit F. S. Noli Korçë<br>*Evidenca* 1.2; Rregullorja e Universitetit F. S. Noli Korçë<br>*Evidenca* 1.3; Plani Strategjik i zhvillimit të Universitetit F. S. Noli 2022-2027 |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë | Referuar informacionit të paraqitur në RVB dhe vizitës në institucion, GVJ konstaton se NJSBC pranë UK mbështetur në rregulloren për këtë njësi, synon përmirësimin e rezultateve dhe rritjen e pritshmërive në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, për të përmbushur standartet e cilësisë të përcaktuar nga |

| | |
|---|---|
| periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmësakademik. | UK, në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të lartë. Përmirësimi i cilësisë realizohet nëpërmjet: kontrollit të brendshëm dhe vlerësimit të jashtëm. Mekanizmat kryesorë që përdoren janë:<br>Pyetsori i studentëve;<br>Formular i perfomancës akademike;<br>Monitorimi i vazhdueshëm i procesit mësimor nga përgjegjësi i departamentit;<br>Rezultatet i vihen në dispozicion departamentit, dekanit, rektorit, me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e cilësisë, por edhe vënia në pah e sygjerimeve të studentëve.<br><br>***Evidenca:***<br>*Evidenca* 1.5; Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional<br>*Evidenca* 3.6; Raporti vjetor i NJSBC FSHNH<br>*Evidenca* 3.7; Raporti Institucional i vlerësimit të brendshëm UK (relacion)<br>*Evidenca* 3.8.1; Pyetësori i NJSBC pas sezonit në bashkëpunim me Këshillin Studentor<br>*Evidenca* 3.8.2; Relacion i të dhënave nga pyetësoret me studentët<br>*Evidenca* 3.8.3; Shembull vlerësimi të performancës së stafit akademik |
| **Kriteri 3.** Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimimeve. | UK ka përfshirë studentët në NJSBC, GVB dhe Senat akademik ku ata kanë mundësi të japin mendimin e tyre në lidhje me vlerësimin periodik të formave të mësimdhënies, vlerësimit të dijeve dhe trajtimin e ankimeve. Ndërkohë mbështetur në rregulloren e UK studentët përfshihen rregullisht në vlerësimin e stafit akademik dhe programit të studimit nëpërmjet plotësimit të formularëve që shpërndan NJSBC, për cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik dhe përmbajtjen e lëndës, duke dhënë vlerësimin dhe komentet për përmirësimin e këtij program studimi, si në funksion të mësimdhënies, ashtu edhe të kurrikulës. Studentët kontribuojnë në cilësinë e programit të studimit, edhe nëpërmjet angazhimit në Këshillat studentorë, të cilët mbajnë lidhje të ngushtë me Institucionin, Departamentin dhe Fakultetin.<br><br>***Evidenca:*** |

| | |
|---|---|
| | *Evidenca* 1.5; Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional<br>*Evidenca* 3.6; Raporti vjetor i NJSBC FSHNH<br>*Evidenca* 3.7; Raporti Institucional i vlerësimit të brendshëm UK (relacion)<br>*Evidenca* 3.8.1; Pyetësori i NJSBC pas sezonit në bashkëpunim me Këshillin Studentor<br>*Evidenca* 3.8.2; Relacion i të dhënave nga pyetësoret me studentët<br>*Evidenca* 3.8.3; Shembull vlerësimi të performancës së stafit akademik<br>*Evidenca* 3.10; Lista e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë (NJSBC) |
| **Kriteri 4.** Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. | Sic u theksua më lart pranë UK funksionon NJSBC, e cila në zbatim të ligjit dhe akteve nënligjore zhvillon pyetësorin e studentëve. Në fund të çdo semestri kjo strukturë shpërndan pyetësorin studentor për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi. Institucioni harton raportin në fund të çdo viti akademik, i cili publikohet në faqen zyrtare të Universitetit, me qëllim rritjen e transparencës ndaj të gjithë aktorëve të përfshirë nga institucioni.<br><br>***Evidenca:***<br><br>*Evidenca* 1.5; Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional<br>*Evidenca* 3.6; Raporti vjetor i NJSBC FSHNH<br>*Evidenca* 3.7; Raporti Institucional i vlerësimit të brendshëm UK (relacion)<br>*Evidenca* 3.8.1; Pyetësori i NJSBC pas sezonit në bashkëpunim me Këshillin Studentor<br>*Evidenca* 3.8.2; Relacion i të dhënave nga pyetësoret me studentët<br>*Evidenca* 3.8.3; Shembull vlerësimi të performancës së stafit akademik<br>*Evidenca* 3.10; Lista e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë (NJSBC) |
| **Kriteri 5.** Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për | Referuar vizitës në Institucion, në takimin me stafin akademik të këtij program studimi GVJ konstatoi gadishmërinë e Institucionit për mbështetje për stafin akademik, si në funksion të realizimit të një procesi mësimor cilësor (kryesisht në infrastrukturë), ashtu edhe në funksion të kualifikimit shkencor (nxitja për pjesëmarrje në konferenca shkencore brenda dhe jashtë vendit, nxitja dhe mbështetja financiare për të botuar artikuj në revista me faktor të |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | lartë impakti- Scopus, monografi dhe botime të ngjashmë shkencore). Për këtë të fundit, stafi i Departamentit të Infermierisë njëzëri kërkuan mbështetje për një kualifikim shkencor sa më të mirë.<br><br>***Evidenca:***<br>*Evidenca* 2.4. Raporti i analizes vjetore të veprimtarisë mësimore, kerkimorë dhe financiare i UK<br>*Evidenca* 2.13. Analiza e punes mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH.<br>*Evidenca* 2.17. Analiza e punës mësimore-shkencore DEPARTAMENTI INFERMIERISË ,për vitin akademik<br>*Takim me drejtuesin e Nësisë Kryesore, drejtuesin e Njësisë Bazë, stafin akademik.* | | | |
| **Konkluzione** | *UK ka ngritur dhe ka funksional sistemin e sigurimit të cilësisë dhe monitoron e vlerëson përmes njësive të posacme në mënyrë periodike programet e studimit. Ky sektor në zbatim të ligjit të Arsimit të Lartë dhe akteve nënligjore, shpërndan në fund të çdo semestri pyetësorët për matjen performancës dhe cilësinë e mësimdhënies.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore | Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë 80/2015 dhe Kodi i Cilësisë në Arsimin e Lartë (VKM 531/11.09.2018), UK ka ndërtuar politika dhe procedura si dhe ka ngritur struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Politikat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë janë sanksionuar në statutin e UK dhe në rregulloren e institucionit. Gjatë guidës në institucion GVJ u informua se në mënyrë të vazhdueshme, realizohet një pyetësor anonim me studentët, |

| | |
|---|---|
| institucionale. | me disa rubrika për mësimdhënien, programin, korrektësinë e stafit, ky vlerësim menaxhohet nga, Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.<br><br>***Evidenca:***<br>*Evidenca* 1.3; Plani Strategjik i zhvillimit të Universitetit F. S. Noli 2022-2027<br>*Evidenca* 1.16; Manuali i cilësisë UK;<br>*Evidenca* 1.5; Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional<br>*Vizita në institucion* |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. | Në UK sistemi i brendshëm i sigurimit të cilësisë realizohet nëpërmjet Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional (DKVI). Brenda kësa drejtorie funksionon NJSBC, e cila ka përfaqësues nga çdo njësi kryesore, nga Drejtoria e Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional (DKVI),organizatat studentore dhe një ekspert të jashtëm.<br>Kjo strukturë përbëhet nga 5 anëtarë, ku njëri është student. UK ka monitorim të përvitshëm nga Ministria e Arsimit dhe Sporteve për plotësimin e standardeve, gjë që siguron funksionimin e kontrollit të cilësisë.<br><br>***Evidenca:***<br>*Evidenca* 1.1; Statuti Universitetit F. S. Noli Korçë<br>*Evidenca* 1.16; Manuali i cilësisë UK;<br>*Evidenca* 1.5; Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional |
| **Kriteri 3.** Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e | Bazuar në dokumentacionin e paraqitur, RVB, dhe në vizitën në institucion, GVJ konstatoi se Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në UK realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit në bashkëpunim me ASCAL. Një nga këto instrumenta është Sondazhi Kombëtar i Studentëve i organizuar nga ASCAL. Konkretisht, UK ka plotësuar standartet institucionale dhe është akredituar me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr. 02, datë 27.01.2023, për 4 vite.<br><br>***Evidenca:***<br>Shtojca 1.1 Statuti i Universitetit Fan S. Noli |

| | |
|---|---|
| studimit. | Shtojca 1.2 Rregullorja e Uniko.<br>Shtojca 1.3 Plani strategjik i zhvillimit të Uniko<br>Evidenca 1.16; Manuali i cilësisë UK;<br>*Evidenca* 2.1.1; çertifikatë dhe vendim akreditimi institucional i UK<br>*Evidenca* 2.17. Analiza e punës mësimore-shkencore departamenti infermierisë<br>*Evidenca* 2.4.1 Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare të UK. |
| **Kriteri 4.** Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira ne programin e studimit. | GVJ konstatoi se UK ka një komunikim të mirë nga poshtë lart dhe anasjelltas. Gjithashtu me anë të kontrollit të cilësisë dhe raportimit të tyre, UK arrin të promivojë arritjet më të mira. NJSBC përpunon të dhënat duke llogaritur tregues sasior dhe cilësor në lidhje me cilësinë e procesit mësimor në këtë institucion. Raportet e përgatitur iu dërgohen të gjithë strukturave sipas përcaktimeve në rregulloren e kësaj njësie. Strukturat drejtuese dhe në vecanti Departamenti i Infermierisë përgjegjës për këtë program studimi, marrin vendimet përkatëse në funksion të përmirësimit të cilësisë dhe mbarëvajtjes së programit studimor.<br><br>***Evidenca:***<br><br>*Evidenca* 1.16; Manuali i cilësisë UK;<br>*Evidenca* 1.5; Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional<br>*Evidenca* 2.17. Analiza e punës mësimore-shkencore departamenti infermierisë<br>*Evidenca* 2.4.1 Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare të UK.<br>*Evidenca* 3.8.3 Shembull i vlerësimit të performancës së stafit akademik |
| **Konkluzione** | *Bazuar në Ligjin për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë, institucioni ka ndërtuar politika dhe procedura si dhe ka ngritur struktura për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Politikat dhe procedurat për sigurimin e cilësisë janë sanksionuar në statutin e UK dhe në rregulloren e institucionit.*<br><br>*Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë funksionon si një strukturë autonome dhe e përhershme pranë institucionit dhe* |

| | |
|---|---|
| | *funksionon me plan pune vjetor dhe ushtron një seri aktivitetesh bazuar në regulloren NJSBC.*<br><br>*GVJ rekomandon që NJSBC të zhvillojë fushata informuese tek studentët lidhur me rolin e saj dhe të jetë sa më pranë studentëve.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | **Nuk përmbushet** | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.3**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të parë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit. | Të gjitha gjetjet e vlerësimit vjetor janë pjesë e raportit vjetor të NJSBC. GVJ konstatoi se UK kryen një vlerësim të brendshëm vjetor që përfshin gjithë programet, njësitë kryesore/bazë dhe ndihmëse që e paraqet në një raport vjetor të Universitetit i cili gjithashtu dërgohet në MAS. UK bashkëpunon dhe me Institutin për Cilësi në Asrim i cili si një aktor i jashtëm realizon performancën e institucionit.<br><br>GVJ konstatoi, Informacion nga UISH, se kalueshmëria e studentëve të diplomuar infermierë ishte rreth 85%. Provimi i UISH është një indikator i fuqishëm për të matur performancën e objektivave të arritura nga programi i studimit.<br><br>*GVJ rekomandon rritjen e eficencës në analizimin e informacionit dhe të dhënave, në përpilimin e rekomandimeve më të detajuara dhe një plani pune me adresim konkret të problematikave.*<br><br>***Evidenca:***<br><br>*Evidenca* 1.5; Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional<br>*Evidenca* 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH<br>*Evidenca* 2.12.1; Praktika e plotë për miratimin e ndryshimeve |

| | |
|---|---|
| | të propozuara ë kurrikulën e programit<br>*Evidenca* 2.12.2; Procedura e ndryshimeve në planin mësimor (rishikimi i kurrikulës).<br>*Evidenca* 2.14 Gjurmimi i ecurisë së punësimit, Alumni, dhe UISH |
| **Kriteri 2.** Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët. | Duke iu referuar informacionit të paraqitur në RVB, dokumentacionit shoqërues dhe informacionit të marrë gjatë vizitës në institucion, rezulton se në mbledhjet e departamentit në fund të çdo viti mësimor analizohet ecuria dhe mbarëvajtja e gjithë procesit mësimor, si dhe problematikat e evidentuara nga pyetësorët e studentëve, pyetësorët për stafin akademik dhe joakademik si dhe formularët e vetvlerësimit. Ky informacion përfshihet në raportin e analizës vjetore të veprimtarisë së departamentit që u komunikohet strukturave të UK sipas parashikimeve të kuadrit rregullator përkatës. Në fund bëhet një analizë mbi gjetjet dhe shprehen mundësitë e përmirësimit dhe rekomandohen plan masat.<br><br>***Evidenca:***<br><br>*Evidenca* 2.4; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK<br>*Evidenca* 2.13.; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH<br>*Evidenca* 2.17.; Analiza e punës mësimore-shkencore Departamenti i Infermierisë, për vitin akademik<br>*Evidenca* 3.6; Raporti vjetor i NJSBC FSHNH<br>*Evidenca* 3.7; Raporti Institucional i vlerësimit të brendshëm UK (relacion |
| **Kriteri 3.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në | GVJ konstatoi se UK përdor metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin e cilësisë dhe mbarëvajtjen e programit. Diskutimet e hapura të stafit akademik me studentët në lidhje me procesin mësimor, cilësinë e mësimdhënies, të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësimeve të provimeve apo detyrave të kurseve, etj, janë metoda e drejtpërdrejtë që UK përdor të sigurar vlerësimin e cilësisë. Gjithashtu dhe informacioni i marrë nga UISH.<br><br>***Evidenca:***<br><br>*Evidenca* 4.2; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë |

| | |
|---|---|
| auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera. | mësimore, kërkimore dhe financiare i UK<br>*Evidenca* 2.13.1; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH për vitin akademik<br>*Evidenca* 1.16; Manuali i cilësisë UK;<br>*Evidenca* 3.7; Raporti Institucional i vlerësimit të brendshëm UK (relacion)<br>*Evidenca* 4.8; Webfaqja e UK https://unkorce.edu.al/<br>*Evidenca* 4.9; Webfaqja e FSHNH https://unkorce.edu.al/fakulteti-i-shkencave-natyrore-dhe-shkencave-humane-3 |
| **Kriteri 4.** Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program. | UK në kuadër të vlerësimit të cilësisë për programet e studimit përdor mekanizimat e mëposhtëm kryesorë:<br>- Sondazhe nëpërmjet pyetësorëve të studentëve;<br>- Raportet e stafit akademik gjatë vitit shkollor dhe Informacioni nga UISH në lidhje me rezultatet në provimin e licencës.<br><br>***Evidenca:***<br>*Evidenca* 3.7; Raporti Institucional i vlerësimit të brendshëm UK (relacion)<br>*Evidenca* 3.6; Raporti Vjetor i NJSBC FSHNH<br>*Evidenca* 1.16; Manuali i cilësisë UK; |
| **Konkluzione** | *-UK përdor mekanizma e procese formale të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikqyrjen e herë pas hershme të programit të studimit.*<br>*-Disa nga instrumentat e përdorur janë pyetsorët e studentëve për procesin e mësimdhënies, si dhe analizat periodike të punës në nivel departamenti. Vlerësimi i performancës së personelit akademik dhe ndihmës akademik* |
| | *-Në procedurat e realizuara në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, rezultatet e proceseve të anketimit të studentëve paraqiten në Raportin vjetor të institucionit dhe në raportin* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *vjetor të NJSBC.*<br>*-Një formë tjetër është edhe raporti nga UISH.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| | |
|---|---|
| **Standardi VI.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. | GVJ evidentoi se se në përbërje të NJSBC janë 7 anëtarë, 4 përfaqësues të përsonelit akademik të njësive kryesore, një përfaqësues i ektorit të Kurrikulës, Vlerësimit Institucional dhe Alumni, një përaqësues i Drejtorisë Ekonomike dhe një përfaqësues i studentëve. Në këtë mënyrë garantohet se politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshijnë aktorë të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Struktura më aktive në këtë proces është NJSBC, e cila bashkëpunon ngushtë me të gjithë strukturat e tjera dhe vecanërisht me njësinë bazë, për përmirësimin e rezultateve dhe rritjen e pritshmërive në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, në përputhje më standardet e cilësisë se UK, si dhe në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë. Strukturat e Sigurimit të Cilësisë kanë për detyrë të garantojnë politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë. Studentët janë të përfshirë si në hartimin e RVB-së, ashtu edhe për vlerësim të jashtëm pranë ASCAL, sikurse janë të përfaqësuar në Senat, në NJSBC.<br><br>***Evidenca:***<br>*Evidenca:* 1.16; Manuali i cilësisë UK;<br>*Evidenca* 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH.<br>*Evidenca* 1.5; Rregullorja e Drejtorisë së Kurrikulës dhe Vlerësimit Institucional |
| **Kriteri 2.** Institucioni | GVJ u informua nëpërmjet takimit që zhvilloi me stafin dhe |

| | |
|---|---|
| përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave. | studentët, për faktin e përshirjes së studentëve në vlerësimin periodik institucional nëpërmjet anketimeve, edhe pse përqindja e tyre ishte shumë e ulët. Kështu Rregullorja e FSHNH dhe e Departamentit të Infermierisë përcakton qartësisht detyrat konkrete për pozicionet individuale dhe njësitë në raport me sigurimin e cilësisë. GVJ konstatoi se të gjithë aktorët e përfshirë në proces ishin bashkëpunues dhe të koordinuar për të realizuar një proces sa më korrekt me vetëbesim për punën dhe kapacitetet e tyre. Studentët u shprehën entuziastë për programin e studimit. Ata referuan se janë të përfshirë në vetëvlerësim përmes pyetësorëve, edhe pse numri i studentëve të përshirë ishte shumë i ulët, propozimeve të këshillit studentor si dhe përmes përfaqësuesve të tyre në GVB.<br><br>*GVJ sygjeron rritjen e numrit të studentën në plotësimin e anketimit për shka të përqindjes shume të ulët që rezultoi nga dokumentacionet përkatëse.*<br><br>***Evidenca:***<br><br>*Evidenca* 2.4.; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK<br>*Evidenca* 1.3; Plani Strategjik i zhvillimit të Universitetit F. S. Noli 2022-2027<br>*Evidenca* 2.13; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH<br>*Evidenca* 2.17; Analiza e punës mësimore-shkencore Departamenti Infermierisë,<br>*Evidenca* 3.6 Raporti vjetor i NJSBC FSHNH |
| **Kriteri 3.** Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve e programit të studimit. | GVJ, gjatë vizitës në institucion dhe bisedave të zhvilluara, me drejtues, stafin akademik, dhe jo vetëm, si edhe me studentët, konstaton dhe mund të pohojmë një gjithëpërfshirje në procesin e veprimtarisë së NJSBC të pedagogëve, stafit administrativ, të cilët organizohen në mbledhje të vazhdueshme mujore të Departamentit si hallka e parë e shprehjes së nevojave për përmirësime apo ndryshime në programet e studimit. GVJ konstatoi se në përbërje të NJSBC ka përfaqësues të njësisë kryesore, njësisë bazë, anëtarë të personelit akademik dhe përfaqësuesin e studentëve. |

| | |
|---|---|
| | ***Evidenca:***<br><br>*Evidenca* 2.4.; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK<br>*Evidenca* 2.13; Analiza e punës mësimore dhe kërkimore-shkencore, e FSHNH<br>*Evidenca* 2.17; Analiza e punës mësimore-shkencore Departamenti Infermierisë<br>3.8.1; Pyetësori i NJSBC pas sezonit në bashkëpunim me Këshillin Studentor<br>3.8.2; Relacion i të dhënave nga pyetësoret me studentët<br>3.8.3; Shembull vlerësimi të performancës së stafit akademik<br>3.10; Lista e njësisë së sigurimit të brendshëm të cilësisë (NJSBC)<br>*Takim me Drejtuesin e Njësisë Kryesore dhe Bazë;*<br>*Takim me stafin akademik*<br>*Takim me studentët* |
| **Kriteri 4.** Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. | GVJ mendon se UK është i angazhuar në respektimin e integritetit akademik dhe në shmangien e çdo diskriminimi apo pabarazie të të gjithë palëve në këtë proces vlerësimi. Përzgjedhje e aktorëve të brendshëm në proceset periodike të vlerësimit bëhet nga personeli akademik ku merren parasysh disa kritere të përfshirjes si, performanca akademike, integriteti, kompetencat profesionale; mundësitë për grumbullimin e informacionit dhe përpunimin e tij me qëllim realizimin e vlerësimeve të ndryshme. Instrumenti kryesor i vlerësimit të programit të studimit, pyetsori, është realizuar në kushte të plota anonimiteti. Nuk janë referuar ankesa nga personeli apo studentët për diskriminim apo pabarazi. Në procesin e vlerësimit respektohet integriteti akademik dhe shmanget cdo lloj forme diskriminimi apo pabarazie kundrejt stafit akademik apo studenteve.<br><br>***Evidenca:***<br><br>*Evidenca 6.4*<br><br>Shtojca 1.1 Statuti i Universitetit Fan S. Noli<br>Shtojca 1.2 Rregullorja e Uniko.<br>*Evidenca* 1.19; Rregullore e Këshillit të Etikës UK |
| **Kriteri 5.** Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe | Qëllimi i NJSBC është arritja e objektivave strategjike në përputhje me vizionin dhe misionin e institucionit. NJSBC |

| | |
|---|---|
| sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj. | funksionon me bazë Rregulloren për Sigurimin e Cilësise; legjislacionit në fuqi, si dhe rregulloreve të brendshme të UK dhe Statutit të UK. Përveç vlerësimit të brendshëm periodik të programit, element tjetër i sigurimit të cilësisë është dhe vlerësimi i jashtëm i cili koordinohet nga ASCAL dhe shërben për sigurimin të cilësisë, në lidhje me programin e studimit. Ky vlerësim kryhet nëpërmjet hartimit të raporteve të vlerësimit të brendshëm, dhe më pas nga GVJ me anë të RVJ, pasqyrohet gjendja aktuale dhe jepen rekomandime me qëllim përmirësim të përmbushjes së standardeve të cilësisë. GVJ konstatoi se detyrat dhe roli i anëtarëve të NJSBC përcaktohen në rregulloren e funksionimit të NJSBC. Për një vlerësim më objektiv të programit të studimit dhe gjetjen e instrumentave më të mirë për përmirësim dhe përshtatje me tregun e punës, NJSBC organizon takime në nivel institucional e deri në nivel programi me pale të interesuara si punëdhënës të tregut publik apo privat dhe studentë Alumni.<br><br>***Evidenca:***<br>*Evidenca* 2.10; Marrëveshjet e bashkëpunimit në mbështetje të praktikave klinike dhe profesionale;<br>*Evidenca* 2.10; Marrëveshjet e bashkëpunimit në mbështetje të praktikave klinike dhe profesionale.<br>*Evidenca* 3.11; Studim tregu për programin e studimit<br>*Evidenca* 4.8; Webfaqja e UK https://unkorce.edu.al/<br>*(Takim me stafin akademik)*<br>*(Takim me studentët)* |
| **Konkluzione** | *-Bazuar në statutin, rregulloren dhe planin strategjik të zhvillimit të Universitetit F.S.Noli, institucioni ka hartuar procedura dhe politika për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë.*<br><br>*Prania e studenteve si anëtarë krijon mundësinë e bashkëveprimit të studentëve me studentët për të përfituar ndjesinë e tyre dhe për të bërë efektiv kontributin e tyre në sigurimin e cilësisë së programit të studimit.*<br><br>*GVJ rekomandon përfshirjen në rregullore të NJSBC edhe të aktoreve të jashtëm me qëllim përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.*<br><br>*-NJSBC funksionon në nivel institucioni dhe koordinon* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | *sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në të gjithë UK.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

| **Standardi VI.5**<br><br>**Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi i ekspertëve** |
| **Kriteri 1.** Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. | GVJ konstatoi se aktiviteti, programi, rregullore të ndryshme të funksionimit të UK janë të aksesueshëm nga stafi akademik, ndihmës-akademik dhe studentët. Gjithashtu çdo informacion në lidhje me politikat dhe praktikat që lidhen me sigurimin e Cilësisë në UK janë transparente dhe publike për të gjithë palët e interesuara dhe shfaqen në faqen zyrtare web të UK.<br><br>**Evidenca:**<br>*Evidenca 4.8 Webfaqja e UK https://unkorce.edu.al/* |
| **Kriteri 2.** Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale. | GVJ nga kontakti me përfaqësues të institucionit dhe shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar prej UK konstaton se institucioni respekton lirinë dhe etikën akademike dhe po ashtu të dhënat personale. UK ka të miratuara rregullore të funksionimit të prgrameve si dhe për ruajtjen e të dhënave ku përcaktohet detyrimi për mbrojtjen e të dhënave. Në faqen ëeb publikohen të gjitha politikat dhe praktikat e sigurimit të cilësisë të cilat janë të akesueshme për të gjithë.<br><br>**Evidencat:**<br>*1.2 Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë*<br>*1.9 Rregullore për mbrojtjen, ruajtjen dhe përpunimin e të dhënave personale* |
| **Kriteri 3.** Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe | GVJ bazuar në evidencat dhe në RVB evidentoi se Departamenti i Infermierisë, FSHNH dhe UK, vlerësojnë në mënyrë periodike rezultatet e veprimtarive mësimore dhe kërkimore – shkencore. Raportet e hartuara për këtë qëllim |

| | |
|---|---|
| synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. | evidentojnë arritjet në procesin mësimor dhe atë kërkimor gjatë një viti akademik, si dhe problematikat që shfaqen. Kështu në fund të çdo viti akademik publikohet raporti vjetor i cili i përcillet senatit akademik, por nuk kemi një evidencë të qartë rreth planit të masave që për përmirësimin e mangësive që evidentohen.<br><br>*GVJ rekomandon hartimin e një plani masash për rritjen e cilësisë.*<br><br>**Evidencat:**<br>*Evidenca 1.2; Rregullorja Universitetit F. S. Noli Korçë*<br>*Evidenca 2.2; Rregullore e Organizimit & Veprimtarisë Mësimore Kërkimore Shkencore e FSHNH*<br>*Evidenca 2.3; Rregullore e njësisë bazë "Departamenti i Infermierisë";* |
| **Kriteri 4.** Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit. | GVJ konstatoi se UK për të siguruar monitorimin dhe vlerësimin e cilësisë së programit të studimit, mbledh Senatin Akademik të UK për të monitoruar implementimin e përmirësimit të procesit mësimor, ku hartohet dhe një raprot vjetor. Në këtë raport shqyrtohen problematikat dhe veprimet që duhen të ndërmerren për të siguruar përmirësimin, por sikurse e kemi thënë edhe më sipër nuk kemi një evidencë të një plani masash për rritjen e cilësisë.<br><br>***Evidencat:***<br>*Evidenca* 2.4.; Raporti i analizës vjetore të veprimtarisë mësimore, kërkimore dhe financiare i UK<br>*Evidenca:* 3.6; Raporti vjetor i NJSBC FSHNH |
| **Kriteri 5.** Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. | Nga takimi në institucion na u komunikua që Dekanati zhvillon takime periodike me Këshillin Studentor të cilat kanë për qëllim informimin dhe marrjen e opinionit të studentëve. Organizimi i pyetësorë tek studentët janë një mekanizëm shumë i mirë për të marrë sa më shumë informacion, por nga konstatimet rezultoi se numri i studentëve të përfshirë në plotësimin e pyetësorëve ishte jashtzakonisht i ulët. |
| **Konkluzione** | *-Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e* |

| | |
|---|---|
| | *studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit në faqen zyrtare on line të universitetit*<br><br>*-Rezultatet e vlerësimit të brendshëm, raportohen prane rektoratit dhe dekanateve te fakulteteve lidhur me pikat e forta dhe dobësite e tyre. GVJ thekson se raportimet e kryera nga IAL janë raporte përshkruese dhe analitike. Por këto raporte nuk shoqërohen me plane masash apo adresim problematike të cilat synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI** | Nuk përmbushet | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në "Infermieri e Përgjithshme", ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë "Universiteti Fan S.Noli", Korçë.**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Numri i stafit akademik ne vite është i qëndrueshëm dhe i gjithë personeli akademik kane grada akademike dhe disa jane ne proces.
2. Stafi mbikqyrës i praktikës profesionale i raportuar nga Institucioni, bazuar dhe ne Statutin e UNIKO, janë staf i spitalit te Korces dhe kjo është një pikë e fortë për këtë program studimi.
3. Pjesa dërrmuese e studentëve që kanë përfunduar këtë program studimi janë të punësuar.
4. Nga takimi me studentët dhe stafin akademik u evidentua se një pjesë e vetë stafit akademik shërben si treg pune, duke punësuar ish studentët e tyre apo i kanë referuar tek kolegët e tyre për punësim në klinikat private.

**Pika të dobëta**

1. Në përgjithësi struktura e stafit ka disa luhatje të vogëla në numrin PAE dhe PAK. (Standardi I.1/ Kriteri 4)
2. Godina e Infermierisë ka nevojë për mirëmbajtje, ashtu sikurse dhe mbulimi me internet i çdo ambienti të UK. (Standardi IV.2/ Kriteri 2)
3. GVJ konstantoi se FSHNT me infrastrukturën që ka, nuk është e përshtatshme për t'u aksesuar nga ana e studentëve me aftësi të kufizuar. (Standardi V /Kriteri 4)
4. Ajo që bie në sy është përfshirja shumë e ulët e studentëve në plotësimin e pyetësorëve. (Standardi V.5/ Kriteri 2)
5. Në fund të çdo viti akademik publikohet raporti vjetor i cili i përcillet senatit akademik, por nuk ka një evidencë të plotë rreth planit të masave për përmirësimin e mangësive që evidentohen. (Standardi VI.5/ Kriteri 3)

**Rekomandime**

1. Rekomandohet të ketë më shumë ndërveprim mes studentëve dhe pedagogëve në rritjen e efektivitetit në zbatimin e metodologjisë së punimit shkencor. (Standardi III.5 /Kriteri 4)
2. GVJ sugjeron që publikimet në faqen WEB të bëhen edhe në gjuhën angleze. (Standardi /IV.4 Kriteri 6)
3. GVJ sugjeron që të krijohet mundësia si fillim për të dhënë lëndë apo module në gjuhë të huaja. (Standardi V.1/ Kriteri 3)

4. GVJ sugjeron që Zyra e Këshillimit të Karrierës duhet të jetë më pranë studentëve duke punuar akoma dhe më shumë në këtë drejtim. (Standardi V.2 /Kriteri 1)
5. GVJ sugjeron që institucioni të gjejë metodat e duhura për përfshirjen e sa më shumë studentëve në plotësimin e pyetësorëve. (Standardi V.5 /Kriteri 2)
6. GVJ sugjeron që punonjësit e Qëndrës së Karrierës të përpiqen të informojnë më shumë studentët rreth shërbimeve që ofrojnë. (Standardi V.6 /Kriteri 1)
7. GVJ rekomandon rritjen e efiçencës në analizimin e informacionit dhe të dhënave, në përpilimin e rekomandimeve më të detajuara dhe një plani pune me adresim konkret të problematikave. (Standardi VI.3 /Kriteri 1)
8. GVJ rekomandon hartimin e një plani masash për rritjen e cilësisë. (Standardi VI.5 /Kriteri 3)

**Evaluation's conclusions for the second cycle study program Bachelor in "General Nursing" provided by the Higher Education Institution "University of Fan. S. Noli", Korçë.**

**Strengths and affirmations**

1. The number of academic staff over the years is stable and all academic staff have academic degrees and some are in the process.

2. The supervisory staff of professional practice reported by the Institution, based on the UNIKO Statute, are staff of the Korca hospital and this is a strong point for this study program.

3. The vast majority of students who have completed this study program are employed.

4. From the meeting with students and academic staff, it was evident that part of the academic staff itself serves as a labor market, by employing their former students or referring them to their colleagues for employment in private clinics.

**Weaknesses**

1. In general, the staff structure has some small fluctuations in the number of PAE and PAK. (Standard I.1/ Criterion 4)

2. The Nursing Building needs maintenance, as does the internet coverage of every environment of the University. (Standard IV.2 /Criterion 2)

3.The GVJ found that the FSHNT, with its existing infrastructure, is not suitable for access by students with disabilities. (Standard V /Criterion 4)

4. What is striking is the very low involvement of students in completing the questionnaires. (Standard V.5/ Criterion 2)

5. At the end of each academic year, an annual report is published which is forwarded to the academic senate, but there is no complete evidence about the plan of measures to improve the deficiencies that are identified. (Standard VI.5 /Criterion 3)

**Recommendation**

1. It is recommended that there be more interaction between students and lecturers in increasing the effectiveness in implementing the methodology of scientific work. (Standard III.5 /Criterion 4)

2. GVJ suggests that publications on the WEB page be made in English as well. (Standard IV.4 /Criterion 6)

3. GVJ suggests that the opportunity be created as a start to teach courses or modules in foreign languages. (Standard V.1 /Criterion 3)

4. GVJ suggests that the Career Counseling Office should be closer to students by working even harder in this direction. (Standard V.2 /Criterion 1)

5. GVJ suggests that the institution find the right methods to include as many students as possible in completing the questionnaires. (Standard V.5 /Criterion 2)

6. GVJ suggests that the Career Center employees try to inform students more about the services they offer. (Standard V.6 /Criterion 1)

7. The GVJ recommends increasing efficiency in analyzing information and data, in compiling more detailed recommendations and a work plan with concrete addressing of the issues. (Standard VI.3 /Criterion 1)

8. The GVJ recommends drafting a plan of measures to increase quality.
(StandardVI.5/Criterion3)

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|---|---|---|---|
| | Nuk përmbushen | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË | | | | X |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | X |
| VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | | X |